

## Një tjetër poemë e panjohur e vitit 1785, kushtuar Ali Pashë Tepelenës, shkruar nga një autor shqiptar anonim



Me Ilirian Zhupën,  
sa shumë jetë  
midis...

Nga Luan Rama

(fq. 6)

### SHËNIME PËR LIBRAT

Natyra folklorike dhe  
religjioze në romanin  
“Përmbytja” të autorit  
Granit Zela

Nga Anxhela Pashaj

(fq. 5)

Përsjatje rreth vëllimit poetik  
“Camera obscura” të Stefan Çapalikut

Procesi krijues si  
“camera obscura”

Nga Marsela Neni

(fq. 8)

Jente Posthuma, “Çfarë do të doja  
të mos e mendoja”

Kur kujtimet bëhen  
plagë dhe shërim – Jente  
Posthuma

Nga Xhoina Salaj

(fq. 18)

NJË MUR PËR POEZINË  
DHE NJË POEZI  
PËR MURIN...

Nga Eda Zhiti


(fq. 16)

NË PREVEZË  
TE SAFET DINO, VAJZËN  
E VETME TË ALI DINOS

Nga Enver Kushi

(fq. 10)

Nga Prof. Dr. Irakli Koçollari



## “Shkaba” – romani polisemantik i Kadaresë

Nga Sadedin Mezuraj

Në historinë e letërsisë ndodh rrallë që idetë më turbulluese- ato që prekin psiken e njeriut, të mos shfaqen në veprat monumentale epike, por të gjenden në libra minimalistë në dukje, por që mbajnë brenda vetes peshën e një universi të tërë. Kështu më duket *Shkaba* e Kadaresë- një roman i thukët, i mbarsur me tensione të fshehta dhe shtresa kuptimore, një narrativë e shkurtër, por e ngjeshur në përmbajtje me simbolikë, alegori, ngarkesë filozofike dhe estetike trazuese.

Romani *Shkaba* përfaqëson një nga veprat më polisemantike dhe simbolikisht më të ngarkuara të letërsisë moderne shqiptare.

(fq. 7)


Djali i fshehur pas  
soneteve të  
Shekspirit dhe Oscar  
Wilde mes tyre

Nga Orin Maxhari

(fq. 21)

Gruaja e tretë  
e Bulgakovit.  
Fati i Elenës,  
asaj që ishte  
“Margarita”

(fq. 22)



### BIBLIOTEKË

Alda Merini

(fq. 11)

*Kjo zemra ime*

Përktheu Roland Gjoza

Banana Yoshimoto

(fq. 12)

*Hija e dritës së hënës*

Përktheu: Ledia Dushi

Nuri Plaku

(fq. 13)

*Muzika e ujërave*

*kthehet në dritë*

Joanna Kalinowska

(fq. 14)

*Toka e mirësisë*

Përktheu Dashamir Malo

Rei F. Hodo

(fq. 17)

*Kënga e Qefalonisë*

Erlind Sulko

(fq. 19)

*Dija dhe banimi në gjuhë*

Arben Meksi

(fq. 24)

*Karikatura e së shtunës*

Copa nate që  
ushqejnë demonët

Ese nga Fatbardh Amursi

(fq. 15)

Miti i Orfeut dhe Euridikës:  
nga Virgjili tek Ovidi, te  
Rilke e te Cvetaeva

Nga Zija Vukaj

(fq. 20)

## FILLESAT E NDRYSHIMEVE RRËNJËSORE NË PASHALLËKUN E ALI PASHËS

Pra gati tridhjetë vitesh, kur lexoja veprën e historianit skocez Finlay, mbi historinë e Greqisë, disa nga pohimet e tij, që lidheshin me klimën që Ali Pasha krijoi për zhvillimin e kulturës, arsimit dhe krijimtarisë letrare, më ishin dukur disi të zmadhuara për të mos thënë aso kohe gati, gati të pabesueshme.

Kjo ishte e natyrshme të ndodhte sepse dyzet apo tridhjetë vite më parë, ende nuk ishin bërë prezente dhe nuk i njihnim konkretisht reformat e tij të thella dhe kurajoze në këta lëmi, nuk njihnim radhën e intelektualëve të përndritur që ai mbështeti e që dhanë kontribute të veçanta në arsim, kulturë, letërsinë dhe përhapjen e dijeve në tërësi. Sigurisht, atëherë ende nuk njihnim dokumentet e pafund të "Arkivit të Ali Pashës", as shumë nga veprat e plota në prozë dhe poezi të shkruara nga autorë të rëndësishëm shqiptarë fare pak të njohur apo të panjohur, e pse jo anonimë gjer atëherë.

Kërkimet e dekadave të fundit kanë nxjerrë në dritë një produkt mjaft të rëndësishëm dhe të begatë kulturor, krijime me vlera unike të autorëve shqiptarë të asaj kohe, vepra unike në prozë dhe poezi (poema), të cilat do të duhet të ndryshojnë vlerësimet dhe standardet e njohura gjer më tani të historisë së letërsisë tonë, autorët dhe krijimtarinë në tërësi.

Por, ajo që bën edhe më shumë përshtypje është fakti se ende ne vazhdojmë të shtiem në dorë gjetje të reja me mjaft vlerë në fushën e letrave në tërësi dhe të krijimit poetic në veçanti të atyre dekadave.

## REFORMAT TË THELLA TRANSFORMUESE

Duke folur për revolucionin për pavarësinë e Greqisë dhe rolin e rëndësishëm që luajtën shqiptarët dhe Ali Pasha në të, Finlay deklaronte: "Nuk do të mund të kuptohej kurrësi Revolucionin grek për pavarësi pa rolin e rëndësishëm të shqiptarëve në të. Ai revolucion është i lidhur ngushtësisht me shqiptarët dhe vetë Ali Pashën."<sup>(1)</sup>

E duke shkuar më tej për Pashain e Janinës, jetën, karrierën dhe kontributet e tij në transformimet e rëndësishme që ai solli në jetën e shqiptarëve, grekëve dhe të rajonit në tërësi, diplomatë dhe politikanë, gazetarë dhe ushtarakë, piktorë dhe shkrimtarë përshkruajnë me hollësi reformat e rëndësishme që ai ndërmori në fushën e: - transformimeve institucionale; - në politikën e brendshme dhe të jashtme; - kontaktet dhe marrëdhëniet intensive dhe shumëplanëshe diplomatike që ai vendosi me fuqitë më të mëdha të Europës, etj. Dokumentacioni arkivor që tepelenasi protokolloi dhe arkivoi na bën me dije gjithashtu për reformat e thella në sistemin e drejtësisë. Bashkë me to një tjetër ndërmarrje e

# NJË TJETËR POEMË E PANJOHUR E VITIT 1785 KUSHTUAR ALI PASHËS shkruar nga një autor shqiptar anonim *Nga Prof. Dr. Irakli Koçollari*

guximshme dhe e rëndësishme e tij ishte ngritja dhe zgjerimi i fuqisë së tij ushtarake; - futja e teknologjisë dhe armëve të reja të luftimit; - organizimi i një flote luftarake të panjohur më parë.<sup>(2)</sup>

Nën synimet për shkëputje dhe mëvetësi ai ngriti një sistem të tërë fortifikimesh, fortesash dhe kalash, sikundër ajo e Tepelenës, e Porto Palermos, e Butrintit; e Litharicës në Janinë; e Prevezës, zgjerimi dhe konsolidimi i kështjellës së Gjirrokastërës, etj., të cilat edhe sot e kësaj dite janë ndër të paktat Objekte të Trashëgimisë tonë Kulturore me

vlerë. Ai i kushtoi rëndësi të veçantë zgjerimit të linjave urbane dhe nën këto vizione hapi rrugë të reja, ndërtoi ura që edhe sot i qëndrojnë erozionit të kohëve, ndërtoi sisteme drenazhimi për tharje moçalesh, etj.<sup>(3)</sup>

Aliu tërhoqi dhe përfshiu nën kontratë të rregullta ligjore rreth 30 inxhinierë, xhenjerë dhe arkitektë të huaj, milanezë, napolitanë, vjenetzë, bavarezë, britanikë, francezë, etj., për të realizuar transformimet e rëndësishme urbane. U ngritën objekte kulti, xhami, kisha, manastire, me subvensionet e tij. U ndërtuan saraje (pallate) dhe qendra banimi nën



projekte dhe studime bashkëkohore.<sup>(4)</sup>

"Nën administrimin e tij, Janina ishte zhvilluar jashtëzakonisht dhe kishte vendosur marrëdhënie me qendrat më të rëndësishme tregtare të Italisë - Milanon, Triesten, Ankonën, Napolin dhe Gjenovën; të Gjermanisë - Laipsigun; Rusisë - Moskën, Odesën; me Bukureshtin, Sofjen, me Vjenën, etj.<sup>(5)</sup>

## INVESTIMET NË DIJE, KULTURË DHE ARSIM

Por, krahas ndërmarrjeve dhe reformave kurajoze me karakter politik, administrative, ushtarak, policor, institucional, urban, etj., Ali Pasha krijoi kushte dhe mbështeti njerëzit e dijes për t'i hapur rrugë arsimit dhe kulturës dhe mirëpritur stuhitë e iluminizmit që kishin pushtuar pothuaj tërë kontinentin European.

"Ai kishte krijuar dhe mbështetur në Janinë një klasë të pasur e cila e kishte bërë këtë qytet një qendër të vërtetë të kulturës helenike. Ai çeli shkolla tërë lulëzim e gjallëri, njëra nga të cilat drejtohej nga Psalidha, ndërsa tjetra nga familja Zosimeja... Mjekët nga këto anë, që kishin studiuar jashtë, shkëlqenin mes tregtarëve dhe intelektualëve, të cilët njihnin mjaft mirë literaturën italiane, gjermane, angleze dhe atë franceze..."<sup>(6)</sup> Boppe, A.

Mes tyre mund të renditen J. Saqelariu, J. Koleti (Kryeministri i ardhshëm i Greqisë), J. Villarai, A. Psalidha, Ll. Vaja, V. Meksi, J. Vithkuqari, S. Postenani, K. Duka, etj.<sup>(7)</sup>

Nga kjo shtresë intelektualësh dhe të tjerë, shkroi një numër tekesh shkollorë me karakter laik dhe fetar, sikundër tekstet e para të fizikës, matematikës, astronomisë, gjeografisë, letërsisë, etj.<sup>(8)</sup> U shkruan fjalorët e parë dygjuhësh greqisht-shqip, frëngjisht-greqisht, italisht-greqisht, latinisht-greqisht, vllahisht-bullgarisht-shqip, etj.

Në dy gjimnazet që u hapën me mbështetjen e Ali Pashës në Janinë, ai i Bolonos dhe Zosimeja u rritën dhe arsimuan gjeneratë e para të të rinjve, të cilët i hapën rrugë zhvillimit dhe prosperitetit kulturor.

"Fëmijët e shqiptarëve myslimanë,

na bën me dije Finlay mund ti shohësh në të njëjtën paradhomë duke lexuar Kuranin me një Osmanli të shkolluar, ndërkohë që në dhomën tjetër një djalosh kristjan i së njëjtës moshë mund ta shikosh duke mësuar shkrim greqisht me një prift grek.”<sup>(9)</sup>

Kolegjet, bibliotekat dhe shkollat morën një hov dhe lulëzim të panjohur më parë. Ato u mbështetën financiarisht prej Ali Pashës dhe ishin të pavarura. Në shkollat e Janinës nuk mësohej vetëm teologji por edhe fizikë, kimi, matematikë...”<sup>(10)</sup>

Për herë të parë në vitet e pushtetit të Ali Pashës u bë e mundur përkthimi i librave të shenjtë, sikundër i “Dhjatës së Re” në gjuhën shqipe nga Vangjel Meksi. <sup>(11)</sup> Nën investimet e tij u ndërtua Medreseja në qytetin e Janinës, shkolla e Oficerëve dhe salla e madhe e ushtrimit të kavalerisë, të cilat gjenden edhe sot në atë qytet. Ai ndërtoi bibliotekën e parë me rreth 3 000 ekzemplarë librash, brenda kalasë së Janinës. Ngriti një kopsht zoologjik me kafshë të sjella nga Afrika; antilopa, zebra, luanë etj. <sup>(12)</sup>

KRIJIMTARI E BEGATË LETRARE

Sigurisht e tërë ajo infrastrukturë, mbështetje financiare dhe politike i dha kurajë dhe shtysë të madhe kulturës në tërësi, në tërë hapësirat e Pashallëkut sa me të drejtë europianët vlerësonin se ato kohë “Nën qeverisjen e Ali Pashës Janina ishte bërë kryeqyteti kulturor i tërë kombit grek dhe atij shqiptar.” <sup>(13)</sup>

Aq domethënëse ishin transformimet që ai ndërmoi, sa edhe armiku më i betuar i Ali Pashës, konsulli francez, Fransua Pouqueville, ishte detyruar të pohonte se: “Veprimtaria e Ali Pashës ishte civilizuese. Ai solli ndryshime në ekonomi, drejtësi, sistemin bujqësor, hapi rrugë të reja, realizoi transformime ... dhe duhet të them se ai në asnjë rast nuk u shfaq dhe nuk ishte demagog”. <sup>(14)</sup>

Në këtë klimë edhe tek shqiptarët lindën dhe vegjetuan një numër jo i vogël krijuesish, cilët sollën një inventar të begatë krijimesh letrare. Finlay bën me dije se ato kohë “u shkruan një numër i madh krijimesh poetike, nga mjaft autorë shqiptarë, të cilat qarkullonin dorë më dorë, në gjuhën greke apo në shqip me alfabetin grek...”

Sigurisht, në fillim të viteve ’85 ku lexoja këto pohime të skocezit të njohur, fjalët e tij për mua ishin të pabesueshme!!! Por, kur nga kërkimet intensive dhe këmbëngulëse, nëpër arkiva, gjetëm dorëshkrimet e poemës “Alipashaida” të Haxhi Shehretit dhe kur pjesë-pjesë numri i tyre u rrit gjer gati dhjetë mijë vargje, mosbesimi filloi të lëkundet dhe të rrënohej tërësisht. <sup>(15)</sup>

NJË VEND QË LIND POETË DHE POEZI

Ndërkohë të tjera gjetje me vlerë filluan të shtojnë inventarin e



krijuesve shqiptarë dhe krijimeve të panjohura gjermë tani, nga viti në vit. Në “Arkivin e Ali Pashës” gjetëm pjesë të një poeme të panjohur të shkruar nga një shqiptar anonim, nga Vunoi. Vargjet e pakta të gjetura

të kësaj poeme na bëjnë me dije për identifikimin dhe ndëshkimin e një prifti grek, i cili kishte shkruar një poezi me titull “Qikllopi”, që ironizonte dhe qesëndiste Ali Pashën. <sup>(16)</sup>

Një tjetër fragment i gjatë i një

poeme, i shkruar nga djali i tretë i Ali Pashës, (Sali Pasha) gjendet në botimin francez të vitit 1824, nën titullin “Këngë Popullore të Greqisë Moderne”. Poema është shkruar në vitin 1820 dhe ofron ngjarje me interes historik për Ali Pashën dhe ngjarjet më të rëndësishme të pashallëkut të Janinës. “Kjo poemë, shkruan studiuesi dhe folkloristi i njohur francez Fauriel, i shekullit të XIX, - përbën një ngjarje historike mjaft kureshtare, pasi atë e ka shkruar një nga djemtë e Ali Pashës, - Sali Pasha”. <sup>(17)</sup>

Në shënimet personale të Konsullit anglez, pranë pashallëkut të Janinës, William Martin Leak, i cili qëndroi në këto anë nga viti 1805 gjer më 1810, gjetëm një njoftim me interes i cili na flet “për një shqiptar nga Parga, i cili ka shkruar një libër, (1808) për historinë e krahinës së Çamërisë dhe Sulit...”. Këtë libër me mjaft interes, pasi e kemi gjetur, jemi në procesin e përgatitjes për botim. <sup>(18)</sup>

Në këtë rast nuk do të zgjatemi me krijimtarinë mjaft të begatë popullore, folklorin, i cili mori dimensione mjaft intensive në raport me tërë periudhat e mëparshme, në epokën e Ali Pashës. Nuk do të flasim as për krijues të tjerë të talentuar, të kësaj kohe, sikundër Hasan Zyko Kamberi, etj. Nuk do të qëndrojmë dot të flasim as për pasurinë e “Divanit shqiptar” për të cilën ka shkruar me aq kompetencë dhe mjeshtëri e ndjera Genciana Egro. Sigurisht do të gjejmë një kohë tjetër për të folur për shumë të reja me vlerë rreth subjekteve të mësipërme.



**NJË POEMË E PANJOHUR  
DEDIKUAR ALI PASHËS  
SHKRUAR MË 1795!**

Duke iu referuar subjektit qendror të këtij shkrimi do të donim të bënim me dije se - para pak ditësh, në një takim me mikun dhe kolegun tim, Akademikun Pëllumb Xhufi, pasi këmbuem me njëri tjetrin, disa punime që kemi ende nëpër duar, ai më dha me bujarinë e tij, një tufë fotokopjesh, të një poemthi të shkruar në greqishten mesjetare. Fillimisht, në vështrim të parë të krijohej mendimi se mund të ishte një fragment apo kapitull nga poema “Alipashaida” e Haxhi Shehretit. E themi këtë sepse fragmente të shkrimeve të tij panumërt kemi gjetur herë pas here.

Por, mbasi i pashë me kujdes vargjet e poemës, konstatova, se fjalori i përdorur në to, nuk i takonte atij fondi gjuhësor dhe as vokabularit, të Haxhi Shehretit. Pra, në të nuk gjenim atë leksik që gjendet në korrespondencën apo krijimet poetike të Shehretit.<sup>(19)</sup>

Një konstatim i dytë ishte - se vargjet e kësaj poeme nuk ruanin atë standard në metrikë që kanë vargjet e Shehretit. Ky i fundit respekton në tërë krijimtarinë e tij poetike, me rigorozitet, gjashtëmbëdhjetë rrokshin. Ndërsa Autori anonim i poemës që kemi në duar ka shkruar vargjet e tij në metrikën e trembëdhjetë rrokshit.<sup>(20)</sup>

Së treti; - Nëse do t'i referohemi një shënimi të shkurtër të neohelenistit Legrand për poemën, e cila ishte shkruar në hyrje të poemës, si dhe një poezie tjetër që ishte bashkangjitur në fund të poemës, mësuam se edhe francezi ruan të njëjtën mendim për autorin e saj. Legrandi shprehej se “autori anonim është padyshim një shqiptar,” dhe sa sipër ai e mbështet duke iu referuar “fjalëve shqip që gjenden, aty këtu, nëpër tekstin e vargjeve të shkruar në greqisht.”<sup>(21)</sup>

Së katërti; - Ishte e kuptueshme që atë fundshekullit (XVIII) shqipja nuk shkruhej, ndaj sikundër bëjnë me dije mjaft studiues, historianë dhe dokumentacioni i “Arkivit të Ali Pashës”, me iniciativën e tepelenasit për herë të parë në historinë e Greqisë moderne, ishte Ali Pasha që e institucionalizoi greqishten, si gjuhë zyrtare e strukturave të pashallëkut të tij. Në këto rrethana nëpunësit dhe mjaft të rinj filluan të mësojnë dhe shkruajnë në këtë gjuhë. Mes të iluminuarve të kohës qenë edhe një numër jo i vogël intelektualësh shqiptarë që filluan të shkruajnë dhe krijojnë duke përdorur si instrument komunikimi greqishten. Një rast tipik është edhe vetë Autori anonim i kësaj poeme.

Së pesti - vetë Legrandi na jep edhe një detaj tjetër, për të ritheksuar bindjen e tij Autori i poemës është një shqiptar. Kështu, ai ka shtuar edhe shënimin e fundit përmes të cilit këmbëngul: “Nuk përjashtohet që autori i poemës të jetë ndonjë vargëzues (poet) ... një kolegj i denjë dhe imitues i shqiptarit Haxhi Shehreti.”<sup>(22)</sup>

## IRAKLI KOÇOLLARI



## “ALIPASHAIDA”

KRONIKË E NJË LINDJE TË PËRGJAKUR

Onufri

### DY FJALË PËR POEMËN “GJENEALOGJIA E ALI PASHËS”

**Q**ë në vështrim të vargjeve të para të poemës krijohet menjëherë bindja se autori veçsa njeh artin e vargëzimit, të krijimit poetik, ai ka edhe një kulturë të përgjithshme përtej kufijve të teknikës së thjeshtë së këtij lloji arti. Duket qartë, nga çfarë shpreh herë pas here në vargjet e poemës se ai njeh historinë e lashtë, kulturën e trashëguar nga antikiteti, mitologjinë dhe personazhet e saj, etj. Ai e fillon poemën e tij në këtë mënyrë:

*O muzë Kaliopi, e vargut  
perëndeshë*

*Helikonit ku banon lavdia je mënteshë*

*Me të nëntë nimfat eja pranë më trego  
Historinë që do rrëfejmë lutem na  
drejto*

*Originën e Aliut, tërë trimëritë  
Rrugëtimet që përshkoi natë e ditë*

.....

Në vazhdim Autori fillon dhe rrëfen me hollësi originën e të

parëve të pashait tepelenas dhe e nis këtë gjenealogji prej vitit njëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy, kohë në të cilën ai pretendon se shfaqet një prej pararendësve të fisit të Ali Pashës.

Mandej Autori flet për prindërit e pashait, fëmijërinë e tij, rrethanat që e lanë atë jetim dhe kohët e vështira e të dhimbshme që kaloi ai dhe nëna e tij Hankua. Duke shkruar me tej ne historinë e vargëzuar për gjenealogjinë e Ali Pashës, Autori anonim, flet për rininë e tepelenasit, lidhjet e tij të mëvona me Kurt Pashën e Beratit, intrigat e thurura për të vrrarë djaloshin tepelenas, rrethanat që mundësuan shpëtimin e tij, etj.

Vargjet e poemthit shtrijnë kronologjinë e ngjarjeve të tyre gjer në kohën që Ali Pasha i shpëtoj kurtheve të Kurt Pashës dhe mandej me rrugën e ngjitjes së tij drejt pushtetit.

Nuk e dimë ende, madje nuk mund të themi kurrsesi me bindje, nëse kjo është poema e plotë e hartuar nga poeti anonim, apo ky është vetëm kapitulli i parë i një poeme më të gjatë, më të plotë për jetën dhe veprat e Ali Pashës. Nuk përjashtohet të jetë kjo e dyta! Megjithatë janë kohët ato që do pohojnë apo rrëzojnë pretendim in tonë.

Nisur nga fakti se Autori anonim flet me respekt dhe ndoshta edhe me një lloj droje për Pashain e Janinës dhe familjen e tij, lë të nënkuptohet se në kohën kur është shkruar poemthi, Pashai tepelenas duhet të ketë pasur pushtet dhe autoritet, faktorë këto që do të impononin jo vetëm respekt por edhe frikë dhe drojë prej autoritarizmit të pushtetit, në radhët e banorëve të pashallëkut, aq më tepër tek ata intelektualë që merrnin guximin të shkruanin për Pashain, në një sistem të monarkive absolute mesjetare. Në këto rrethana, gjykojmë që Autori ka shkruar “Gjenealogjinë” jo më parë, se tepelenasi të merrte pushtetin, por mbasi ai kishte marrë fronin e Pashait dhe bashkë me të aureolën e rëndë dhe kërcënuese të monarkut lindor. Pra ai duhet ta ketë shkruar atë ndoshta aty, rreth vitit 1785.

Në çdo rrethanë “Poema” është një tjetër pasuri që i vjen fondit të traditës së krijimtarisë poetike shqiptare në një kohë dhe shekull kur ende nuk kemi të tilla në inventarin e pasurive tona krijuese në poezinë e gjatë, poemën.



*“Isha ndër ethe, trupin e kisha në zjarrmi, kurse lokja thoshte me zë të lartë se do të shpëtoja, sepse, që të jetoja, bashkë me time më herën e parë më kishin larë në një tepsi bakri, më kishin çuar te përroi në luginë të futur në djep dhe kishin marrë me vete edhe gjyshin, nana dhe lokja kishin qëndruar në njërën anë të përroit dhe gjyshi në anën tjetër, “Si t’ia vëmë emrin?”, kishte pyetur lokja; “Luan” i qe përgjigjur gjyshi nga ana tjetër e përroit. “E gëzoftë!”*

Në gjindjen e madhe të shkrimtarisë është shtuar edhe një roman nga Granit Zela me titullin “Përmbytja”. Ky roman nuk është rrekja e parë e Zelës për të shkruar një shkrim autorial në gjininë e prozës së gjatë, e cila kërkon një përqëndrim dhe thurje të hollësishme për të krijuar pëlhurën magjike letrare.

Romani “Përmbytja” përmes titullit të tij e lidh lexuesin me të shkuarën e mjegullt biblike, rënien e madhe të njerëzimit, kohën kur raca gjysmë njerëzore nuk ishte e denjë për të vazhduar qënësinë e saj në Tokën e Krijuesit. Kjo lidhje e hamendësuar dhe fillestare e lexuesit shkrumbohet disi, pasi në roman motivi biblik thuhet nuk është i pranishëm. Është një rrëfim gati autobiografik, i cili vendos në qendër qytetin personazh, Atjelindën, atë të renë dhe të vjetrën, njerëzit e saj me gjithë besëtytënitë e tyre, të shkuarën dhe të tashmen si dhe Luanin, rrëfimtarin, i cili e nis kallëzimin e tij duke e nisur me fëmijërinë dhe para lindjen e tij. Luani, emrin siç na rrëfen, ia ka ngjitur i gjyshi me pritsshmërinë e madhe se do të jehonte forcën te ai, pritët me gaz të madh mes familjarëve të tij. Si për ironi ai rritet për të mos qenë asgjë nga ato që të afërmit e tij prisnin.

*“Kisha zbuluar se dimrat në fshatin tim të lindjes ishin shumë të ftohtë për mua. Sëmuresha shpejt dimrave, isha i pari në fis që sëmurej, isha, si të thuash, lajmëtar i ardhjes së të ftohtit.”*

Siç edhe vetë rrëfimtari e pohon, ai është një fëmijë shëndetlig për të cilin nuk dyshohet asnjëherë (prej gjyshe së tij) se nuk mund t’i mbijetojë jetës së vështirë, megjithëse ashtu përmes fjalëve të personazheve të tjerë (mëmës së tij) kumtohet se e vetmja mënyrë e të mbijetuarit për të është të ushqyerit të mendjes së tij, edukimi, shkollimi.

Ky fëmijë i dobët me gjithë çuditë që na rrëfen për veten e tij (në roman na tregohet për vizionet e tij për të ardhmen e njerëzve të Atjelindës), rritet me bindjen se duhet të shkruajë historinë e rënies së Atjelindës, qytetit të tij. Rënia e Atjelindës është e gjatë dhe shenjat paralajmëruese të tatëpjetës së saj janë të shumta; vetëvrasje, përmbytje, njerëz të huaj me mashtrime dhe gënjeshtra nëpër buzët e tyre që paralizojnë qytetin, të rinj dhe të reja të destinuar për t’u humbur, ndërtimi i Atjelindës së re, i kështjellave burgje dhe qindra halucinacioneve të tjera njerëzore.

Krahas qytetit personazh, Atjelindës, në roman ka edhe disa personazhe (apo fise) me emra të krijuar simbas natyrës apo funksionit të tyre në rrëfim, nga të cilët shënojmë: Shpirtmarrësi, Grafologu, Etnologu, Shenjti, Mallkimtari, Të Përhënurit, Valëlumët, Fushëshkretët etj, madje disa prej këtyre personazheve kanë kapituj të veçantë ku rrëfëhet mbi mundimet e tyre në Atjelindë.

Në Atjelindë ndodh gjithçka dhe asgjë. Një vend i izoluar, ka banorët e saj në pamundësi të përjetimit të ndonjë ndodhie sajojnë thashetheme, ngjarje, nisin dhe jetojnë me besëtytënitë apo edhe të shkuarën. Këto besime, besëtytëni të tyre, me të cilat merret gjatë rrëfimtari ynë janë po ashtu një nga copëzat e tharmit të letërsisë gojore dhe folklorit shqiptarë. Në roman enden figura folklorike, ngjarje, çudira të cilat na i kanë rrëfyer qysh në djep herë për të na frikësuar, herë për të na argëtuar e herë të tjera për të na përkundur

# Natyra folklorike dhe religjioze në romanin “Përmbytja” të autorit Granit Zela

Nga Anxhela Pashaj

në gjumë. Është një roman i përmbytur me fije folklorike, të cilat shumë-shumë mund të mos jenë të shkruara kund tjetër dhe prej këndeje mund të rigjenden për të eksploruar lëmin e gjerë të folklorit shqiptarë dhe pse jo për të rikrijuar rrëfime të reja me struktura dhe kompozita moderne.

*“A isha gjallë apo kisha vdekur? I kujt ishte ai zë që kujtonte se isha në gjumë të thellë e nisi të tregonte histori për një vajzë me hënë e yll në ballë, për zana që flinin në lëndinë, njerëz që shihnin në ëndërr sendet, kafshët e njerëzit e humbur, për një njeri që martohej me breshkën, për tri vëllezër me tri yje dhe me nga një shishe në bark, për lotët e një vajze që shndërrohesin në trëndafila, për një ujk që hante një burrë natën e martesës, për djalin e drejtë dhe dy vëllezër, për ilačin e gjumit dhe ilačin e përjetësisë, për një dervish që shkonte kaluar në shpinën e një zogu, për një nuse që i dilnin tri gjarpërinj prej goje, për mbretin e bilbilave, për një shami që ngjallte të vdekurit, për një njeri që rrihet varrin e një të vdekuri, për një dervish që u ndrronte*

*vendin kodrave, për një nuse që u dëbuan në mal që ta hanin egërsirat, për një njeri që nuk e zinte kurrë gjumi, për një tjetër që ishte edhe i vdekur edhe i gjallë. Për një mal që ua lëshonte gjethet lisave përtokë, për një dervish që i fshinte sytë një fëmije me shami dhe i shëndosheshin...”*

Është interesante se të gjitha prurjet folklorike vendosen përkrah njëra-tjetrës në disa paragrafë të vetëm duke ndjekur një ritëm të vrullshëm, i cili të krijon idenë e një lumi, madje gjithë romani duket se lidhet nga një lumë nëntokësor që premtion shpërthim të befshëm dhe përmbytjen e madhe.

Mes gjithë besimeve dhe besëtytënive shqiptare si mësyshi, yshtjet, magjitë në këtë roman gjarpëron edhe figura e gjarpërit, i cili duket qysh në faqet e para të tij dhe e ndjek rrëfimin deri në modernitet. Ai është simbol i vazhdimësisë (pjellorisë), por edhe i mbrojtjes.

*“Nga dritarja e saj, në manin përballë, më vonë do të shihja të shtrirë gjerë e gjatë*

*një gjarpër. Ai sipas lokes sime, ishte rojtar i shtëpisë.”*

...  
*“Për të mos më marrë mësysh, ajo i tha që njërën kokë gjarpëri, që ime më e kishte fshehur në gjinj, të ma vinte mua në gjoks.”*

Në roman ndërthuren prurjet, përmendjet folklorike (copëza legjendash të vjetra, krijesa të njohura në folklor) me magjinë, zakonet, misticizmin e religjionit, sektit bektashi. Bektazhizmi në letërsinë shqipe në disa autorë shqiptarë ka gjetur vendin për t’u shfaqur dhe zbuluar disa copëza të filozofisë së tij. Kujtojmë Naim Frashërin, i cili jo vetëm shkruajti për heronjtë e rënë në Qerbela, por mësimet e dervishëve dhe baballarëve i bëri pjesë të poetikës së tij (ndër to Panteizmi - Zoti është kudo). Në shkrimet më të kristalizuara të Frashërit, (jo “Qerbelaja” në këtë rast) bektazhizmi është më së shumti një mistikë, një filozofi fetare, ndërsa në romanin e Zelës, “Përmbytja”, njihemi me një anë tjetër, anën praktike të sektit bektashi. Pjesë e këtij sekti, krahas filozofisë sufiste, perfeksionit, arritjes shpirtërore është e njohur edhe një anë tjetër që lidhet me fuqinë mistike të baballarëve dhe dervishëve, (në roman përmenden shehlerët) të cilët performojnë rite të papërshkruara kund, për të ndryshuar rrjedhën e ndodhive të së ardhmes a për të mbushur honet bosh të jetëve njerëzore.

*“Lokja thoshte se në lindjen time e kishte ndihmuar edhe sheh Dauti, që kishte një teqe për të cilën kishte dhënë prova.”*

...  
*“Sheh Dauti kishte dhënë prova si sheh i fortë. Ai kishte ndalur zhurmën e Drinit të Zi, kurse shehlerët e tjerë kishin shterur ujin e puseve ose e kishin ngjitur përpjetë, derisa ishte derdhë në grykë si krua.”*

Pikërisht kjo mistikë, mistika bektashie gjen vend në romanin “Përmbytja”, e cila duket ta ketë lidhur pas jetës Luanin dhe nuk e lejon këputjen e këtij filli. Gjyshja e tij është e përpiktë në realizimin e porosive të klerikut bektashi (sheh Dauti) duke dëshmuar besimin e palëkundur, por edhe marrëdhënien e varësisë që ka krijuar ndaj misticizmit fetar, madje jo vetëm ndaj tij, por edhe ndaj magjsë.


Po aq interesante dhe çuditshme është vetënjohja e Luanit se nuk do të vdes, se ora e tij nuk ka ardhur ende dhe se ai ka për detyrë të shkruajë historinë e rënies së Atjelindës. Tingëllon si një thurje e fatit prej hyjëve e prej të cilit nuk mund të shpëtosh dot..., njëjtë si Edipi që vrapoi së koti prej fatit të tij. Fati gjithmonë të gjen.

Nga ana tjetër rrëfimtari ka gjetur vend për ta nxjerrë rrëfimin e vet nga aura e magjisë dhe mistikes për ta futur në atë të realitetit, ku sillen në vëmendje copëza nga burgu. Përmes inicialeve rrëfimtari bën pjesë të kallëzimit të tij M.V, Z. Ç dhe V. Zh që supozohet të jenë piktori Maks Velo dhe shkrimtarët Visar Zhiti e Zija Çela, që të tre mbajnë shtyllat e Atjelindës së re, asaj reale.

Po ashtu rrëfimtari bën pjesë të historisë së Atjelindës ardhjen e shqiptarëve të Kosovës në Atjelindë duke shkruajtur si për çudinë, pavetëdijen e atjelindasve ashtu edhe për përumbjen dhe dëshpërimin e të ardhurve. Kjo “dyndje” bëhet edhe fundi i Atjelindës.

Po ç’është rënia e Atjelindës? Më shumë është një fillim për një tjetër Atjelindë, të lirë, të hapur ndaj mundësive, njohjeve të reja, ngjarjeve të vërteta. Ndoshta rënia e saj është një ironi, sikurse ka disa në këtë roman ku vlen të përmenden mënyra se si ditët nën diktaturë dukeshin për një fëmijë të pafajshëm dhe se si deliruan të rriturit në vendosjen e emrave të fëmijëve të tyre në liri.

Ama, faji nuk është i Atjelindës, asnjëherë nuk është faji i qytetit, por i njerëzve që jetojnë në të. Ishin atjelindasit që i jepnin formë jetës së tyre në Atjelindë sikurse ndodh kudo. Dëshmitë tregojnë se disa përmbytje e kanë zanafillën nga hyu e disa nga njeriu.



Sa herë më ndodh që të jem në shoqëri me shkrimtarë apo artistë, koha nuk është më kohë. Më ngjan se bëhet erë e ikën vrikthi. Ose bëhet lumë. Lumë që rrëmbyshëm na merr mes zhaurimës së vet tëposhtë e na shpie në detin e paanë. Në detin ku dallgët e mallit na kalamendin e tallazojnë sipas trilleve të tyre.

Edhe me Ilirian Zhupën kështu më ngjau. Nuk mund të ndodhte ndryshe.

Kishim kohë pa u parë. Shumë kohë. Dhe u desh të flisnim për shumë ngjarje, për njerëz tanët e miq të përbashkët. Edhe për ata që kanë shkuar.

Iliriani shërben në Bari.

Është diplomat në Konsullatën e Shqipërisë në bregun më të afërm të vendit fqinj. Matanë detit.

Janë bërë shumë vite që prej kur poeti shërben në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Nuk e teproj asfare të them se është punëtor i mirë i diplomacisë në shërbim të vendit të vet. I tillë ka qenë gjithkund ku ka punuar. Për të është çështje edukate, çështje principi. Është edhe çështje trashëgimie.

Edhe Faik Konica ka qenë diplomat. Si ai edhe të tjerë më pas. Emra të ndryshëm, në kohë të ndryshme.

Vetëm marrëdhënia e poetit me mëmëdheun nuk ndryshon. Sepse nuk ndryshon as dashuria e poetit për mëmëdheun.

Poeti i madh helen, nobelisti Jorgos Seferis ka shërbyer si konsull i vendit të vet në Korçën tonë në vitet 1936-1937. Në kujtim dhe në nderim të tij, para do kohe u restaurua dhe u përrua ajo ndërtesë e bukur.

U vendos edhe busti i poetit konsull e diplomat. U bë shumë mirë. Sepse është një shenjë. Shenjë miqësie, shenjë kulture. Edhe respekti e nderimi.

Poeti ynë Ilirjan Zhupa ka qenë gjithashtu konsull i Shqipërisë në Janinë. Edhe në Selanik.

Poetët, shkrimtarët, artistët janë ambasadorët më të mirë të vendit të tyre nëpër botë. Kështu thonë shpesh ata që drejtojnë. Por, kur duhet të vendosin, “harrojnë”.

Jo shumë larg nga Korça, në Konicën matanë kufirit, shpirti i Faik Beut endet rrënojavë të braktisura të shtëpisë së vet.

Mbase pret që dikush nga ata që mburren se lexojnë çfarë ai ka shkruar në gjuhën e nënës dhe të babës, të mund të kujtohet e të vërë dorë. Nuk do të ishte keq të ringrihet mbi ato rrënoja edhe shtëpia e publicistit, shkrimtarit, botuesit dhe ambasadorit të Shqipërisë në SHBA. Shumë mirë do të qe që edhe një bust i tij të vendoset me vështrimin nga atdheu në oborrin e shtëpisë. Le të jenë shtëpia dhe busti aty në dheun e të parëve të vet një shenjë. Shenjë kujtese e nderimi.

“MOS MË PYET KU KAM QENË”

Ndërsa ecja përgjatë unazës së vjetër të Tiranës për të mbërritur në vendtakimin me Ilirianin Zhupën, më erdhi në mend “Mos më pyet ku kam qenë”.

Është libri i poezive të tij.

Më i miri. Dhe më përfaqësuesi. Aty poeti është në çdo fjalë e në çdo varg Iliriani i përjetimeve vullkanore. Sepse, edhe jeta ndanë vullkanesh e ka çuar e përplasur jo pak. Në një farë mënyre ka ecur mbi zjarre.

Qysh në moshën e hershme, kur botoi poezitë e para, bëhen pesëdhjetë vjet. “Kohë në të cilën e kam jetuar gjer në thelb edhe fjalën, edhe heshtjen, duke paguar e shpërblyer me tepri edhe për njërën, edhe për tjetrën”, thotë poeti.

Pa atë rrugëtim nuk do të ishte Iliriani që është. Nuk do të ishte as poeti që është. Edhe miku që është nuk do të ishte.

Kur më shkroi se ka ardhur në Tiranë e më lajmëroi të takohemi, u ndjeva mirë. U gëzova shumë. U gëzova për të. Ndjeva se Iliriani është mirë.

Ka kaluar kohë të vështira. I është dashur të luftojë gjatë me sëmundjet. Nuk iu ndanë. Sa dëbonte njërën, i avitej tjetra.

Ndaj, lajmi për t’u takuar, më shumë se sa kënaqësinë e ftesës për t’u parë sy më sy, më la të kuptoja se është shumë mirë edhe me shëndet. Kisha të drejtë.

U poqëm vllaznisht. Kështu më pëlqen ta shkruaj këtë fjalë. Më ngjan se thotë më shumë. E thotë edhe më ngrohtë, edhe më ëmbël se sa trajta e normës “vëllazërisht” përmbajtjen e vet. Në “vllaznisht”, sikur ka më shumë dashuri të vërtetë e më shumë njerzëri.

U përqaftim me mall. Përlotshëm, por dhe gazmendshëm.

“Mos më pyet ku kam qenë” me sa duket më erdhi si paralajmërim. Ilirjani nuk pëlqen të flasë për të shkuarën. Atë e ka lënë në libra. Ndaj edhe

# Me Ilirian Zhupën, sa shumë jetë midis...

*Nga Luan Rama*

unë nuk e pyeta. Nuk qe hiç nevoja. E qeshura në portretin e tij dhe mirësia më thanë gjithçka.

U ulëm në një nga lokalet e shumtë në rrugën e ambasadave. Dikush mund të thotë, epo me një diplomat, ku tjetër më mirë se në rrugën e ambasadave mund ta pinit kafenë?

Nuk qe kjo arsyeja. Qe zgjedhje e rastësishme. Dhe qëlluar me fat. Në kafenë ku u ulëm, gjetëm Koço Kostën. Shkrimtarin e kohës pakohë. Sepse edhe kur koha kishte “kohë”, Koço nuk ishte brenda saj. Ai gjithmonë ka patur kohën e vet. Si mendjen e vet. Ndaj Koço Kosta është gjithmonë i njëjti. Ai ka kaluar nëpër kohë, por koha nuk ka kaluar nëpër Koçon. Sfidant i përjetshëm. Kalorës i ëndërt i një letërsie ndryshe, qe me “Natën e Sofie Kondilit” na diellëzon një botë krejt tjetër, për të na marrë nga “Mëhalla e Pelës”, e për të na shpënë në yllësinë e vet të paanë. Atje është mbretëria e tij.

Pasi zumë vend në një kthinë të lokalit, me të ardhur kafeja, Iliriani më ngushëllon për babanë.

Nuk mundi të vinte atëkohë. Patëm folë gjatë në telefon. Por kafenë nuk e kishim pirë.

Siç e prisja, më pyet për Mersinin.

Kur bëheshin bashkë harroheshin me njëri-tjetrin. Im atë e donte. Dhe e respektonte shumë. Kënaqej kur bisedonin.

Edhe Iliriani po aq.

Sa qe gjallë babai e Iliriani larg, flisnin në telefon e pëmes kameras, e shihnin njëri-tjetrin. Përhëndeteshin.

Tani kanë mbetur kujtimet.

Për të mos e shtyrë më tej muhabetin në emocionet e shpjegueshme në kësi rastesh, e pyes për Valin, zonjën e tij, për djemtë, Lisin dhe Kristin.

Unë i mbaj mend që kur lindën. Ata tani janë bërë burra. Jetojnë e punojnë në Europë.

Edhe Ilirjani më pyet për të mitë. Fillimisht për mamane, pastaj për gjithë të tjerët.

Më shumë do të dijë për Tean.

Bashkë jemi shokë që prej vitit 1987. Njohjen na e pat mundësuar Preç Zogaj.

Punonin bashkë në gazetën “Zëri i Rinisë”.

Unë isha student në Shkodër. Iliriani ka qenë para meje. Në të njëjtën degë. Kemi patur të njëjtët pedagogë.

Me kohë u bëmë miq. Na miqësoi gazeta, dashuria për poezinë, ëndërra ime për t’u bërë gazetar. Edhe me Mero Bazen, Faruk Myrtajn “Zëri i Rinisë” na miqësoi. Edhe “Vullnetari”. Ishte gazetë që “Zëri i Rinisë” e botonte enkas për vullnetarët që ndërtonin hekurudhën Milot - Rrëshen - Klos. Nuk përtonim të shkonim.

Rendnim gjithë pasion, pa pyetur për vapën e korrikut dhe të gushtit. Merrnim edhe honorare. Nuk ishin pak për atë kohë. Por ne na gëzonte më shumë emri poshtë shkrimeve që mbushnin faqet e “Vullnetarit”.

Iliriani dhe Preçi qenë “porta” ku hynim pa trokitur.

Prej Ilirianit pastaj njoha Xhevon. Kështu e thërrasin miqtë e aferm poetin Xhevahir Spahiun. Dhe prej Xhevos, njoha Petro Markon.

Sa me fat e quaj veten që e kam parë nga afër, që i kam dhënë dorën dhe jam ulur pranë Petro Markos në Klubin e Gazetarëve. Mua më ngjante sikur takoja Heminguejin. Kanë qenë miq. Petro Marko është Hemingueji ynë.

Më vonë, miqësia me Ilirianin u bë edhe më e ngushtë.

U bë miqësi e shtëpisë. Vëllai i Ilirianit u martuar me motrën time. Në mes është nipi, mbesa. Janë edhe fëmijët e tyre. Kështu miqësitë jo vetëm forcohen, por edhe trashëgohen.

“TË GJITHË ECIN NË UDHË TË VET...”

Kështu shkruan Ilirjan Zhupa në një varg të poezisë “Miq të e mi shkojnë në udhë të vet”. Dhe pasi iu kushton nga një varg disa prej më të afërmeve prej tyre emër për emër, e mbyll poezinë me vargjet:

“Të gjithë ecin në udhë të vet, duke më harruar mua.

Pikërisht se e dinë që nuk mund t'i harroj, Pikërisht se e dinë që ende s'kam vdekur”.

Edhe Ilirian Zhupa ecën në udhë të vet. Udhë e tij është udhë e njeriut. Forca e tij është dashuria për njeriun. Ëndërra e tij është të “udhëtojmë në qiellin prej fjalësh”. Sepse “tema më e vjetër e ekzistencës do të jetë gjithmonë e re dhe e pazbuluar, sa kohë të fillojë dhe të mbarojë çdo qenie njerëzore. Ajo do të jetë një dëshmi prej fjalësh, jo prej sendesh”.

Për Ilirian Zhupën fjala është dëshmi. Është shenjë. E dëshmia është edhe amanet.

Kulti i fjalës është i vetmi kult të cilit i falet poeti. Ai e shenjtëron atë. Ndaj na thotë “shihini dhe prekinin fjalët... sepse ajo e mban gjallë shpirtin tonë edhe kur nuk jemi”.

I them që kam qenë në Çorraj, si për ta shtyrë bisedën tutje në Kurveleshin e Labërisë.

Iliriani ka shkruar një poezi shumë të bukur për Çorrajt, fshatin që poeti e quan “rrënjët e mia”. Poezia është ëndërra e tij për fshatin; naimiane, e bukur, e ndërë deri në asht. Siç janë të gjitha ëndërrat e poetëve. Siç janë të bukura dhe të pafajshme edhe ëndërrat e fëmijëve.

Në Çorraj prej kohësh s'kam qenë”, është



titulli i poezisë.

“Kam ikur prej kohësh nga Çorraj dhe kam frikë të vij...”, thotë poeti. E mandej vazhdon:

“Në rrëpirat e tua kam shtuar ca lëndina të vogla,

Plakave u kam lidhur nga një shami të re te kryet,

Shtëpitë e murrme t'i kam lyer me gëlqere të bardhë,

Fëmijëve motakë u kam treguar një përrallë.

U kam thënë djemve një sekret dashurie,

U kam dhënë një shteg nate për përqaftimet dhe puthjet,

U kam shtuar ujërat burimeve dhe pemëve frutat.

Vajzave u kam mësuar ca çapkënlleqe ngacmuese,

Për t'u bërë më shpejt të dashura dhe nuse.

U kam thënë pleqve ca fjalë të rralla,

Të harrojnë reumatizmin dhe therjen e eshtrave,

Të heqin dorë prej pleqërisë dhe ankesave.

Dhe pastaj pragjeve, dhe pastaj avllive, përrenjve, gurëve,

Shpendëve dhe qiejve...

Dhe përsëri s'kam ardhur edhe pse të shtova kaq gjëra

Nga frika mos je më i bukur se ëndrra”.

Babai i Ilirianit, Odisea, u lind në Çorraj. Unë e kam njohur. Dhe e mbaj mend mirë atë njeri fjalëmirë e zëbutë. E kam në sy. Kujtimi për të qe një prej arsyeve pse shkova në Çorraj.

Nuk më ka qëlluar qoftë edhe në një rast të vetëm të shkoj në Tepelenë e në gjithë fshatrat e asaj krahine apo të takoj tepelenase, kudo ku më është dashur të shkoj me punë, që të kem përmendur emrin e mësuesit Odise Zhupa, e të mos kem gjetur nderimin më të lartë për atë burrë, që mirësinë e rrezëllente në gjithë qenien e tij me një fisnikëri dhe kulturë, të cilën thjeshtësia e bënte monumentale, imponuese. Heshtja e tij mbartëte një solemnitë të veçantë. Sikur vinte nga legjendat. Mbase në atë heshtje që në fakt është ai “qielli prej fjalësh” është mbujtur e blatur shpirti poetik i Ilirian Zhupës.

Çorraj është fshat i bukur. Lartësia në malin mbi det e bën edhe më të bukur. Kundruall në shpatin përballë është Fterra. Edhe ai një fshat i përmendur i asaj krahine. Fshat me emër dhe me histori.

Edhe pse çorrajotët kanë ikur dhe pas kanë lënë vetëm drynët mbi portat e dashurisë dhe dhimbjes së tyre si amanetin e mallit dhe si gjurmën ku një ditë do të kthehen, prapë Çorraj është më i bukur se ëndërra e poetit.

Lapidari i Maro Kondit dhe i dëshmorëve të tjerë të fshatit, emërtimet e rrugëve si në qytet (përshembull “Rruga Gjithile”, “Rruga e Qafës” etj), ku nuk kalojnë më njerëz si më parë, janë shenjë.

Shenja mbetet. Shenja është amanet. Shenjë dhe amanet është edhe pllaka që përkujton pesë niviciotët dëshmorë të atdheut, të pushkatuar nga gjermanët në Çorraj më 19 qershor 1944.

Si e ka thënë poeti? “Dëshmi prej fjalësh. Jo prej sendesh”.

Edhe fjala është shenjë. Edhe fjala është amanet.

Koha iku si erë. Përhumbur kujtimesh, historish, njerëzish të gjallë e të vdekur, po na zinte mesnata. Kamarietë që po linin punën na kujtuan se kishte ardhur koha të ndaheshim.

-Por këtë herë, për pak kohë, tha Iliriani. Sepse shpejt do të kthehem. Dhe do të shkojmë në Çorraj. Do të shkojmë edhe në Valin e Martaneshit tënd.

Shenjat na thërrasin. Dhe kemi shumë për çfarë të flasim. Kemi ende shumë ç'të tregojmë.

Është gjithë ai qiell prej fjalësh nëpër të cilin duhet të udhëtojmë...



Portreti nga Ina Lajthia

## Pjesa e parë

Në historinë e letërsisë ndodh rrallë që idetë më turbulluese- ato që prekin psiken e njeriut, të mos shfaqen në veprat monumentale epike, por të gjenden në libra minimalistë në dukje, por që mbajnë brenda vetes peshën e një universi të tërë.

Kështu më duket *Shkaba* e Kadaresë- një roman i thukët, i mbarsur me tensione të fshehta dhe shtresa kuptimore, një narrativë e shkurtër, por e ngjeshur në përmbajtje me simbolikë, alegori, ngarkesë filozofike dhe estetikë trazuese.

Romani *Shkaba* përfaqëson një nga veprat më polisemantike dhe simbolikisht më të ngarkuara të letërsisë moderne shqiptare. Edhe në këtë roman, Kadare dëshmon ato tipare të stilit të tij, të një proze e cila, sipas studiuesve, shquhet si “proza e metaforës së madhe të absurdit ekzistencial, proza e parabolës, e analogjisë dhe alegorisë.”

## 1. Miti dhe rrëfimi alegorik

Studimet e thelluara letrare<sup>2</sup> tashmë kanë evidentuar se pjesa më e konsiderueshme e korpusit letrar të Kadaresë, i ka rrënjët të shtrira në “tokën” e miteve klasike, në legjendat, baladat dhe përrallat shqiptare, të cilat autori, përmes teknikës së rimodelimit dhe risemantizimit, i vendos në shërbim të strukturave narrative moderne, duke u dhënë atyre, përtej ngjyresave shqiptare, frymëmarrje dhe dimensione universale.

Kadare, me zellin e një mitologu racional, zhytet në kohët primordiale mitike për të zbuluar modelet arketipale, ato forca që burojnë nga nënvetëdija kolektive dhe që vënë në lëvizje pasionet njerëzore, mekanizmat shtypës të pushtetit dhe dëshirën e paepur të njeriut për të thyer kufijtë e së pamundurës.

Jo rastësisht Kadare ka shpërndarë në pëlhurën narrative të romanit *Shkaba* referenca të mitit të Prometeut, të Dedalit, mitin at vrasës të Edipit, mitin e Odiseut që del nga shpella e Ciklopit poshtë barkut të dashit, Shtyllat e Herkultit, alegorinë e shpellës së Platonit etj.

Rrëfimi thuret duke thirrur tekste të tjera: përrallën, fabulën, mitin dhe kjo na kujton atë që nënvizon R. Barthes dhe J. Kristeva, se pëlhuara tekstuale është një ind i thurur me dhjetëra citime dhe përfaqëson një rrjet me shtresa ndërtekstuale. Kjo teknikë ndërtekstualiteti i jep romanit një përmasë të dyfishtë: nga njëra anë aludon për një realitet shumë konkret (të Shqipërisë totalitare), por nga ana tjetër e ngre atë përvojë në nivel universal.

Narrativa e romanit *Shkaba* ngrihet si një hipotekst i ndërthurur mbi strukturën paratekstore të përrallës shqiptare “*Qerosi në botën e poshtme*”, skicë -idenë e të cilës Kadare e kishte paralajmëruar qysh në librin e tij *Ftesë në studio*<sup>3</sup>.

Përralla e Qerosit nuk është zgjedhur rastësisht. Ajo shërben si substrat i alegorisë politike, ku miti dekonstruktohet për të ndriçuar mekanizmat ndëshkues të shtetit totalitar dhe, në një rrafsh më të tërthortë, edhe liturgjinë kombëtariste të flijimit dhe të sacrifices.

Prej përrallës së Qerosit, Kadare ka ruajtuar konstruktin, duke e pasuruar atë me elementë arketipalë, sikurse janë: rënia e Maksit në botën e poshtme, përballja e tij me Hijen jungiane, udhëtimi simbolik i heroit, sakrifica dhe ringritja lart me ndihmën e shkabës magjike, dyluftimi me shpendin ndëshkues etj. Sipas Carl Jung, arketipët janë imazhe primordiale dhe struktura psikike universale të pavetëdijes kolektive që shprehen përmes simboleve, miteve, ëndrrave dhe veprave letrare apo artistike<sup>4</sup>.

Nën dritën e koncepteve teorike të Carl Jung, mundësohet leximi dhe interpretimi

## “SHKABA” –ROMANI POLISEMANTIK I KADARESË

Nga Sadedin Mezuraj

i romanit *Shkaba*, si një narrative shumëshitesore, si poetikë moderne e lirisë, e ndërtuar përmes arketipeve mitikë të udhëtimit në botën e poshtme (*katabaza*), ngritjes/fluturimit (*anabaza*) drejt botës së sipërme, dyluftimit dhe sakrificës së heroit të narrativës.

Përdorimi nga Kadare i arketipeve në romanin *Shkaba* nuk është rastësor; përmes tyre ai i jep romanit një dimension universal dhe mitik, që tejkalon realitetin shqiptar dhe bëhet metaforë e njeriut modern të shtypur nga sistemet politike totalitare.

E ngritur mbi këtë shtrat mitik, ku figurat arketipale zhvishen nga dimensionin i të shenjtës, struktura e romanit është pasuruar dhe shtresëzuar në përmbajtje dhe në rrafshin simbolik, semantik dhe filozofik. Romani *Shkaba* shquhet për një poetikë të pasur në të gjitha rrafshet dhe autori përmes rimodelimit të mitit, ka ndërtuar “një sistem strukturor dhe ligjërimor të sofistikuar dhe polifonik”<sup>5</sup>.

Përdorimi i gjuhës alegorike dhe onirike nuk është shmangie nga realiteti por një mënyrë më e thellë për ta shpjeguar atë. Siç thekson Northrop Frye (*Anatomy of Criticism*,

5 Jakllari, Adem: Studime Filologjike, 1-2, 2009, f. 153


1957), mitet dhe alegoritë janë struktura të pashmangshme të kuptimit në letërsi, përmes të cilave kultura përpunon traumat dhe përvojat kolektive.

Në romanin *Shkaba*, Kadare nuk e përmend drejtpërdrejt “komunizmin”, “shtetin”, “partinë”, apo aparatin ideologjik që mbikqyr, ndëshkon dhe shkatërron individin. Në vend që të përdorë një gjuhë të drejtpërdrejtë politike, Kadare i referohet strukturës së përrallës, fabulës dhe mitit, duke u mbështetur në një teknikë të përhershme të tij: të shprehë të pathënshmen përmes një forme të tërthortë, alegorike.

Kjo teknikë narrative e vendos *Shkabën* jo vetëm në vijimësi me veprat e tij të mëparshme, por edhe në dialog të thellë me traditën evropiane të absurdit dhe ekzistencializmit, përkrah me “Metamorfozën” e Kafkës dhe “Rënie” e Kamy-së.

Në veprën “*Mitologjitë*”, Roland Barthes e përkufizon mitin modern si “ligjërim i vjedhur”<sup>6</sup>, një formë gjuhësore e boshatisur nga përmbajtja fillestare dhe i mbushur me kuptim të ri.

6 Barthes, Roland: Mitologjitë, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2016, f. 266



Ndërkaq, duhet të theksojmë se në romanin *Shkaba*, narrativa strukturohet përmes një strategjie të dyfishtë: desakralizimi mitit, shkëputja e tij nga funksioni arkaik-ritual, duke e vendosur në një kornizë letrare moderne, si mjet alegorik, dhe nga ana tjetër, përmes natyralizmit iluziv- si teknikë mitologjizuese e rrëfimit, kufijtë mes reales dhe fantastikes sfumohen dhe mistifikohen, duke e futur lexuesin në një zonë të pasigurtë- a është ajo çfarë ndodh një akt real apo një halucinacion?

Kadare, përmes teknikës mitizuese, ndërton një rrëfim që shkon nga realja në onirike, nga imazhet e turbullta në iluzione dhe haluçinacione- të gjitha simptomat të çoroditjes së njeriut shqiptar të dënuar arbitrarisht nga shteti totalitar.

Kadare nuk është mitolog, as mitograf dhe as thjeshtë çmitizues, por një shkrimtar modern që përdor poetikën mitike në funksion të kritikës kulturore dhe politike *fictionale*, duke i dhënë historive narrative thellësi kuptimore dhe dimensione universale, simbolike dhe filozofike.

## 2. Struktura dhe simbolet

## 2.1 Rënia

Fabula e romanit fillon sipas modelit të përrallës: Maks, protagonistin, banor në kryeqytet dhe punonjës në Bankën Qendrore- një mbrëmje del nga shtëpia të blejë cigare dhe papritur, bie në një zgafelle nëntokësore, pasi shkel një dërrasë (të kalbur!) të lëvizshme në trotuar.

Nuk jepet asnjë shpjegim, asnjë arsye. Kjo rënie në ferrin nëntokësor nuk ka asnjë ndërlidhje me fajin, siç ndodh zakonisht në letërsinë morale ose religjioze. Nuk zhvillohet ndonjë gjyq dhe nuk ka asnjë dëshmi. Vetëm një rënie e zhveshur nga kuptimi – një zbritje që evokon absurditetin ekzistencial sipas modelit kamyan: njeriu hidhet në absurditet pa paralajmërim, pa faj, thjesht sepse ekziston.

Hyrja e romanit të befason me natyrshmërinë e përshkrimit të rënies së Maksit në zgafellën nëntokësore dhe, sikurse nënvizon Eric Faye<sup>7</sup>, ajo të kujton shndërrimin e Gregor Zamzës të Kafkës në kandërr. Kjo teknikë e vendos romanin *Shkaba* në një linjë me letërsinë evropiane të absurdit dhe të ankthit ekzistencial.


Rënia në zgafelle e Maksit është një rënie simbolike nga rendi i jetës normale, në një nën botë që nuk ndjek më logjikën e racionale. Ngërçi në të cilin gjendet personazhi është një metaforë për njeriun e zhveshur dhe të pafuqishëm, përballë një sistemi absurd, ku faji nuk ekziston si shkak, por si status ontologjik.

Për më tepër, zbritja nëntokësore e Maksit ka një rezonancë mitike që e lidh romanin *Shkaba* me rrëfimet orfike, me ferrin dantesk, me udhëtimet e lashta të heronjve në botën e nëndheshme. Por në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me një *katabazë heroike*, as me një udhëtim shpirtëror, por me një rënie si ndëshkim për asgjë – një shkëputje tragjike nga rendi simbolik dhe kuptimor.

“Ferri” i Kadaresë nuk është pas vdekja, por është një dimension paralel brenda vetë realitetit socialist, një refleks i kontrollit total, ku njeriu është i përndjekur jo pse ka

7 Faye, Eryc: Parathënia e romanit *Shkaba*-Onufri, Tiranë 2010, f.9

(Vijon në faqen 9)



1 Bullo, Jorgo: “Në vend të parathënies”, në *Shaban Sinani, “Për prozën e Kadaresë”, “Naimi”, 2009, f. 7-8.*

2 Isufaj, Viola: *Rikthimi i mitit në veprën e Ismail Kadaresë*, Onufri, 2013

3 Kadare, Ismail: *Ftesë në studio*, SHB Naim Frashëri, Tiranë, 1990, f.256-257

4 Jung, Carl (1969). *The Archetypes and the Collective Unconscious, Collected Works, Volume 9, Part 1.* Princeton University Press.

### Struktura e librit dhe titulli

Stefan Çapaliku është një autor mjaft prodhimtar në letrat shqipe. I shquar në zhanrin e gjatë të romanit dhe i freskët e me një penë të ndjeshme, detajiste e plot humor në tregimin e shkurtër, nuk më kish qëlluar ta njihja më parë përmes poezisë, përveçse në lexime të rastësishme në rrjetet virtuale, sepse në fakt poezia është si një gji i cili milet rrallë, në do të japë qumësht cilësor. Ndaj këtë vëllim poetik e lexova me ëndje, ngadalë dhe e mbajta gjatë nëpër duar.

Ajo çka më intrigoj që në fillim ishte titulli.

Se çka në titullin e kësaj vepre që më grish,- thoja me vete- si emri i dikujt që s'të vjen në gojë, imazhi i të cilit endet hijeve të kujtesës.

Quhet “Camera obscura”.

Regjisori brenda meje projekton një imazh: “një puthje” e befasishme mes dy të panjohurish në një dhomë të errët ku asnjëri nuk arrin ta shquajë tjetrin, e megjithatë diç ngelet pas në atë terr: një aromë, një prekje, një ndjesi e jashtëbotshme që të eksiton e të paralizon njëherazi, një tërheqje misterioze për të zbuluar atë që është më e vështira të zbulohet: kush jam unë, kush jemi ne.

Projeksioni i përjetimit më evokon çastin e zhytjes në pakohësi, çastin kur instikti më nxit të marr një stilograf e të nis të shkruaj, çastin kur nis të kuptoj atë që kam ndjerë. A është ky çast krijues dhoma e errët ku projektohen kokëposhtë imazhet e humbura në humnerën e harresës? Një fije drite i bën të zgjohet dhe kujtesa i ravijëzon në një formë unike. A s’ është ky imazh i projektuar rikrijimi i vetes, i botës, ndonjëherë dhe i tjetrit? A mund të krijohet pakohësia me lëndë iluzore, të ujshme, të rrjedhshme?

Çfarë mund të thuhet për një vepër letrare nisur vetëm nga titulli i saj?

Shpesh emri ka veç lidhje arbitrare me të shenjuarin, por evokimi shpesh është jehona që bën një zë që “thërret në mal”.

Ja! Mua më evokon yin dhe yang, më krijon imazhin në lëvizje të vetë procesit krijues, një kroki të tij. 69 poezitë në brendësi më shpien te krijimi i imazhit fotografik, por 69 poezi mund të shihen edhe si një akt erotik me vetë jetën. Në mos me çastin? Atë fluidin. Të pakapshmin. Atë çast që nuk pozon përpara syve të përjetimit, por vazhdimisht përpiket të të largohet, të arratiset, të flurohet. Po ty çfarë të evokon një titull?

Në këndvështrimin tim, titulli i përmbledhjes poetike është në fakt një metaforë e fuqishme që lidhet ngushtë me konceptimin arkitekturor të kësaj përmbledhjeje poetike dhe vetë procesin krijues. Termi “Camera obscura” është emërtim për një pajisje optike të lashtë, pararendëse e aparatit fotografik, ku një dritë që kalon përmes një vrime të vogël projekton një imazh të përmbysur në një sipërfaqe të brendshme të errët. Ky fenomen fizik shërben si simbol për mënyrën se si autori percepton dhe përpunon realitetin në poezinë e tij.

Libri përmban 69 poezi të organizuara në 10 cikle, një strukturë që mund të interpretohet si një seri “fotografish” poetike, secila duke kapur një aspekt të ndryshëm të jetës dhe ndjenjave njerëzore. Kjo ndarje në cikle i jep lexuesit mundësinë të përjetojë një udhëtim emocional dhe estetik përmes “imazheve” të ndryshme që autori ka “fotografuar” në mendjen dhe shpirtin e tij.

### Simbolika e “Camera Obscura” në kontekstin e librit

#### Perceptimi i përmbysur i realitetit

Ashtu si në “camera obscura”, ku imazhet shfaqen të përmbysura, edhe poezitë e Çapalikut ofrojnë një këndvështrim të ndryshëm, shpesh të përmbysur, mbi realitetin e përditshëm. Ai eksploron qytetin dhe jetën urbane përmes një lenteje që zbulon detaje të fshehura dhe interpretime të reja. Pra, nuk kemi të bëjmë thjesht me një reference teknike, por me një metaforë të thellë. Ai fton lexuesin të hyjë në “dhomën e errët” të mendjes së tij, ku imazhet e jetës përmbysen, përpunohen dhe shndërrohen

Përsjatje rreth vëllimit poetik “Camera obscura” të Stefan Çapalikut

# Procesi krijues si “camera obscura”

Nga Marsela Neni

në poezi që sfidojnë perceptimet tona të zakonshme.

#### Fiksimi i momenteve të përditshme

Ashtu si një aparat fotografik që kap momente të caktuara, poezitë në këtë përmbledhje janë përpjekje për të fiksuar çaste të veçanta të jetës urbane dhe emocioneve njerëzore. Autori përshkruan veten si një “kalimtar i vetmuar” që “lundron në ferrin urban” dhe zbulon qytetin në natyrshmërinë dhe origjinalitetin e tij. Në një intervistë të tij dhënë për “Albania Letteraria” Çapaliku pohon:

“Kam hartu një libër duke dashtë me i ngjasu atij kalimtarit të vetmuem që zbulon, përndjek, lundron në ferrin urban dhe që e zbulon qytetin si një peizazh vesesh epi-shore. E di se të fotografosh njerëzit do të thotë t'i dhunosh ata... prandaj personazhet e mia nuk i kam vu kurrë që të marrin pozë. Kështu kam fiksuar energjinë e pakontrollueme, dinamikat e lëvizjes dhe shpesh edhe situatat e tyre karikatureske.”

Paul Claudel thotë se poezia nuk është e përbërë nga shkronjat, por nga drita që mbetet në letër.

Drita e një poezie është të mbujturit me kuptim, të zgjimit të një emocioni, të arritjes së një gjendjeje frymëzimi. Ndaj që ta vlerësosh, siç e meriton, një poezi të Çapalikut, të duhet pak kohë për të perceptuar çfarë skutash shpirtërore ndriçoi një poezi e tillë tek ti si lexues i saj.

#### Miti dhe realiteti

Autori përdor mitin dhe realitetin për të ndërtuar një narrativë që sfidon perceptimet tradicionale.

Gjithashtu ai vetë nuk end veç vargje, ai fotografon, koreografin, regjison imazhe, ndjesi, pikëtakime botërash në bebëzat e syve të tij herë të trishtuar, herë nostalgjik, herë të frikësuar nga zbrazja, harrimi, moskuptimi, tëhuajëzimi. Kjo qasje postmoderne, kjo mënyrë unike e të parit të botës përmes përvojave personale është ajo që ndikon

si strukturën, por dhe temat e “Camera Obscura”.

#### Struktura ciklore

Siç e përmendëm më lart, “Camera Obscura” përbëhet nga 10 cikle poetike: 1. pasqyrat e të rrëfyerit; 2. reportazhe; 3. libri i shpisë; 4. e papërllyeme; 5. ditë kryepreme; 6. nostalgjitë e skamjes; 7. ndalim kalimi; 8. tabela e njerëzve të humbun; 9. në emën të nanës; 10. post scriptum. Ajo çka të bie menjëherë në sy në të gjithë librin është mospërdorimi i shkronjës së madhe. Autori na flet me “fjalë të vogla”, na do me “fjalë të vogla”. Edhe emrin e tij nuk do ta veçojë nga fotografia e madhe ku bëjnë pjesë gjithë njerëzit e kohës së tij, e qytetit të tij, sepse ai është një nga ata, ndaj dhe atë e shkruan me shkronja të vogla, si të jetë veç një emër i përgjithshëm. Numri i poezive në secilin cikël varion sipas ciklit, kurse poezia që emërton të gjithë përmbledhjen bën pjesë në ciklin e shtatë dhe ka formën e një poeme postmoderne të konceptuar në dhjetë pjesë.

Në këtë përsjatje do ndalem veç në disa poezi, aq sa besoj do mjaftonte për t'i dhënë lexuesit me eks një ekstrakt shijeje.

**Poezia “nji trup”**, poezia që hap librin, paraqet një eksplorim të ndërlikuar të marrëdhënies ndërmjet ndjeshmërisë, identitetit dhe trupit si mjet mbrojtës apo ekspozues. Kjo poezi është një shpërthim i heshtur i brendshëm, një kërkesë për siguri në një botë që prek, që gjykon. Me fjalë të thjeshta, por thellësi filozofike, poeti trajton nevojën e një njeriu për të krijuar një version të vetes që mund të përballojë një botë që shpesh është brutale ndaj ndjeshmërisë. Kjo është një kërkesë për mbijetesë në një realitet që nuk e duron brishtësinë. Subjekti lirik kërkon një trup “*prej fijesh të çeliktë inkadeshente që digjen*” –një formë e përkryer për të jetuar pa u thyer, pa u lënduar, pa u ekspozuar. Ai shpreh qartë pasigurinë e njeriut modern në përballje me botën, duke

e bërë këtë poezi një rrëfim universal për ndjeshmërinë dhe vetëmbrojtjen.

**Poezia “fjalët”** është një reflektim i thellë mbi raportin me gjuhën, fuqinë dhe pafuqinë e fjalëve, me një ton të errët, të dhimbshëm dhe filozofik. Poezia flet për shtypjen e së vërtetës, për dhimbjen e fjalëve të pazëshme që rrinë brenda nesh. Leximi i kësaj poezie të ndjek gjatë me mendimin: çfarë fjale nuk kemi thënë dot, e na djeg ende brenda?

Ëndrra si mjet për të shpalosur absurditetin, dhunën dhe groteskun e përditshmërisë njerëzore përdoret për të ndërtuar një rrëfim të fuqishëm në **poezinë “andrron”**. Përmes një gjuhe vizuale e ironike, ajo ndërtton një realitet të përmbysur që synon të provokojë ndërgjegjen. Poeti “andërron” një botë që përmbysat – jo nga dëshira për shkatërrim, por për të shkundur apatinë e përditshmërisë. Ëndrrat janë të forta, groteske, plot dhunë simbolike: *karrige që fluturojnë, xhama që thyhen, kasapë, rruspa që shembin farmaci*. Ato reflektojnë një realitet të shtrembëruar ku dhuna, absurdi dhe indiferenca janë bërë të zakonshme. Në fund, ai thotë se vetëm pas një ëndrre të *tillë “mund të zgjohet ma i mirë dhe falenderues”* – pra, ëndrra shërben si tronditje për t'i rikthyer ndjeshmërinë, vëmendjen dhe njerëzinë vetes.

“nuk i duroj dhomat pa orë muri  
më duket vetja i humbun  
pa kohë”  
(Poezia “pa orë” fq. 10)

Ndjesia e humbjes së vetvetes në realitetin bashkëkohor që rrjedh prej ankthit ekzistencial të mungesës e matjes konkrete të kohës jepet në këto vargje të **poeziës “pa orë”**. Ky meditim modern mbi përjetimin e kohës përmes vargjes që përshkruajnë çaste të përditshmërisë (të cilat nisin të bëhen të paqarta, duke krijuar poetikisht idenë e zhvendosjes së rutinës, *“ide të përplasme me dëshira / brenga me pamundësi,”*), paraqet idenë se kujtesa është e gënjeshhtë dhe e manipulueshme, por janë kujtimet, secili prej tyre ato që na bëjnë të harrohem për t'u rigjetur. Detaje të tjera të kësaj poezie janë vërtet interesante dhe brenda korpusit tematik të shpeshtrajtuar në forma të ndryshme në veprën e Çapalikut, atë të tranzicionit, por që në këtë poezi vjen përmes detajeve: *orë muri*- si simbol i përditshmërisë dhe i kontrollit të ritmit jetësor; *stacioni pa orë*- si simbolikë e një vendi tranzit, e një vendi të ngrirë në kohë; *alarmi*- si një aludim për presionin e kohës në shoqërinë moderne, ku çdo çast është i kontrolluar.

Pra, një poezi reflektuese, moderne, që flet me zë të heshtur për një krizë të përbashkët.

Poezinë **“dikush si unë”** e lexova si një përsiatje të fuqishme mbi individualitetin dhe përvojën njerëzore të përbashkët, që flet për dhimbjen, ankthin, krijimin dhe mbijetesën. Poezia shpreh ndjesinë se, sado unike të jetë përvoja e secilit, në thelb dhimbja, ankthi dhe kërkimi për kuptim janë të përbashkëta. Një poezi introspektive, filozofike dhe jashtëzakonisht njerëzore.

Një vend tjetër tranzit, kalimtar, për të cilat ndalet poeti të meditojë janë dhe dhomat e hoteleve. Këto hapësira të përkohshme të jetës ruajnë heshturazi histori personale, emocione dhe kujtime. Në to njeriu përballet me versione të ndryshme të vetvetes.

Dhomat e hoteleve simbolizojnë hapësira të përkohshme të jetës, por aty mund të ngjizen reflektime të forta: ato janë “vende ideale për vetëvrasje”, thotë poeti, një metaforë për momente të rënduara shpirtërisht, kur njeriu përballet me boshllëkun e vet e për ta shmangur dhimbjen e ndal kohën: *“kam pritë që të mos vinte ma e nesërma”, “kam qenë aty i papranishëm”*.

E thjeshtë në formë, por e thellë në ndjesi poezia **“dhomat e hoteleve”** flet me ndjeshmëri për kujtimet si pasqyra të vetes, flet për rritjen, ndryshimin, dhimbjen dhe dëshirën për kuptim në jetën e përditshme. Në shumicën e poezive të kësaj përmbledhjeje ironia është e heshtur, por ka raste kur ajo këlthet e kalon në sarkazëm të hidhur: *“kam lënë të paprekun hera herës botën*



*time sakate/ me sy drejt tavanit kam vizitu edenin tim” (fq. 16)*

Ndjenjën e një pezmi historik, ndjenjën e fajit ndaj shekullit të kaluar ndërthurur me nota të larta kritike e autokritike e gjejmë në poezinë **“në vizën e vogël”**. Kjo poezi është një reflektim i thellë filozofik dhe emocional mbi jetën njerëzore, historinë dhe përjetësinë e përmbledhur në një simbol të thjeshtë – viza që ndan datëlindjen nga data e vdekjes në një varr. Kritikën ndaj shekullit të ri, degjenerimin moral, social apo shpirtëror, kritika ndaj relativitetit (me shprehjen “relative qenkan gjithçka” poeti ironizon mënyrën si shoqëria moderne justifikon gjithçka, edhe dëshirat për të qenë hero apo viktimë), e bëjnë këtë poezi një testament poetik, një koncentrat jetësh, ku poetit i mjafton një vizë për të rikujtuar gjithçka që ndodhi, që nuk ndodhi, që do donte të ndodhte. Një poezi që fton për reflektim të thellë, jo vetëm mbi jetën personale, por edhe mbi mënyrën se si kolektivisht ndërtojmë një epokë. Nëse shohim vetëm plagët e kohës, do ndjejmë vetëm dhimbje, por po të kërkojmë me ngulm, do gjejmë ende dashuri, ndjeshmëri dhe hir edhe brenda një epoke të trazuar.

Po dua të ndahem me ty lexues të këtij shkrimi duke thënë dy fjalë për një poezi që e kam lexuar disa herë e në të gjitha rastet më ka prek e më ka bërë të lotoj. Është poezia **“krahni”** pjesë e ciklit të nëntë poetik “në emën të nanës”. Si edhe poezitë e tjera simotra të këtij cikli, edhe poezia “krahni” është një përzierje e bukur mes thjeshtësisë dhe ndjenjës së thellë, ku intimiteti i kujtesës bëhet prehe për shpirtin. Por kjo poezi është dhe një reflektim i dhembshëm mbi humbjen e nënës, thjeshtësinë e largimit dhe kujtesën që venitet me kohën, bashkë me sendet që humbin nga pakujdesia jonë për t’i ruajtur, për pendesën, fajin, nostalgjinë:

“dikush duhet t’i kish ruejtë sendet e saj unë ma së pari  
ç’ ishte ky moskujdes  
e tash kanë mbetë krejt pak  
nji bluzë sa me i marrë aromë  
disa çikërrima  
dhe nji krahën i vogël

nuk di pse  
po sa herë që du  
të bahem burrë  
krehe me të  
vetëm sa për të ndi  
gishtat e saj  
në kry”  
(poezia “krahni” fq.150)

Nuk di të them a të lexuan ty këto vargje, por për veten di me siguri të them se vargu “ç’ish ky moskujdes” ka për të më ndjekur gjatë, shumë gjatë.

#### Gjuha dhe stili

Përdorimi i gegënishtes e bën poezinë e Çapalikut më personale, më të gjallë dhe të afërt emocionalisht, madje shpesh disa fjalë, si për shembull fjala “androj”, më përçon një ndjesi të brendshme, intime, që nuk mund të ma sjellë aq thellësisht bukur fjala në standard.

Imazhet surrealistike ndërtuar prej detajeve të gjalla me fjalë të vogla të gjuhës së përditshme krijojnë shpesh figura të forta e të trazuara, si: “vallë rrethore qensh”, “kasapi me duer të përgjakuna”, që shërbejnë për ta tronditur lexuesin, apo si në rastin në fjalë dhe për ta vënë përballë realitetit të dhunshëm, të pandjeshëm.

Poeti përdor vargun e shkurtër e të lirë, pa një rimë klasike, çka e bën poezinë të ndjekë ritmin e brendshëm të ndjenjës. Përsëritja e vargjeve ose e disa koncepteve kyçe, që nëse do ndaleshim më gjatë, do të zbërthenin gjithë ngrehinën poetike të librit, imponojnë ritmin, rrjedhimisht algoritmin e përshfaqjeve tona si njerëz që lexohemi, kur lexojmë e kemi në dorë të bëhemi dëshmitar okularë të ekzistencës së përjetësisë edhe brenda një çasti, edhe brenda një shkrepjeje poetike.

(shtator 2025)



(Vijon nga faqja 7)

vepruar, por pse ekziston jashtë angazhimit ideologjik.” Faji ” i vetëm i Maksit ishte se ai në një mbledhje të kolektivit, ku u diskutua kundër shfaqjeve të huaja, ai nuk u prononcuar rreth çështjes. Pas këtij momenti, Maksi ishte një i dyshuar. Në sistemin totalitar, ndëshkimi ishte jo vetëm për ata që, sikurse thotë një nga personazhet e narrativës- *“flisnin tepër”*- por edhe për shkak të heshtjes.

Në shtetin totalitar, mosprononcimi ishte faj ideologjik.

#### 2.2 Arkitektura e zgafelles- hapësirë internimi dhe topografi e subkoshiençës

Zgafella nëntokësore, përmes metonimisë dhe teknikës së përngjasimit, i ka të gjitha shenjat e zonave të internimit dhe kampeve të dënimit në sistemin totalitar shqiptar- pra përmes saj ngrihet një aluzion i qartë për rënien e individëve nën represionin e diktaturës. Kadare e përdor mitin tradicional të Qerosit si alegori të vendeve të internimit në Shqipërinë totalitare, duke e risemantizuar dhe ngarkuar me tensione të reja narrative dhe psikologjike.

Megjithatë, zgafella nuk është vetëm hapsirë internimi por edhe një simbol i Hadesit modern –ku enden vetëm hije – shëmbëllime të atyre që nën represionin e shtetit totalitar, kanë humbur të drejtën për të qenë subjekte. Arkitektura e zgafelles është përshkruar nga autori me shenjat e një qyteze reale, ku çdo element ka një rol funksional dhe mbart një kuptim të caktuar.

Ironikisht, porsa përfundon në hapësirën nëntokësore, Maksi përballet Bar Liria. Frazja “Bar Liria” e vendosur brenda në zgafelle –zonë internimi në Shqipërinë totalitare- është një akt i pastër sarkazme, që ekspozon thelbin e diskursit totalitar. Përmes këtij shëmbëllimi të përmbysur, përcillet ideja se regjimi totalitar prodhonte një realitet diskursiv, ku fjalët nuk korrespondonin me përmbajtjen e tyre, se liria ishte një simulakrum e boshatisur nga treguesit referencialë dhe shërbente si dekor propagandistik me të cilin shteti totalitar maskonte represionin.

Në zgafelle, pra në Hadesin nëntokësor, ku enden hije dhe shpirta të heshtur, vetëm pak figura gjallojnë:

*Barmani* – syri –panoptikoni fukoian -që vëzhgon gjithçka që ndodh rreth rrotull Bar Liria dhe në provincën e internimit.

*Vajza me emrin anA*-një figurë halucinante, sendërgji e mendjes së traumatizuar të Maksit apo një shëmbëllim i përmbysur i *Ana-s*, së dashurës mbitolokësore. Ajo është bija e një ushtraku-të dy të rrëzuar në zgafellen nëntokësore. Ndërsa i ati nuk resht së dërguari letra instancave shtetërore mbitokësore për falje ose rehabilitim, ajo

–sikurse i shprehet Maksit- nuk aspiron të ngjitet lart. Sepse për t’u ngjitur lart-sipas saj- *duhet të japësh diçka*<sup>9</sup>-pra kërkohet një pakt, një kompromis me autoritetet represive.

Akomodimi brenda ferrit -sipas qasjes së saj-është më dinjitoz se sa të shesësh shpirtin tek “përbindëshi” totalitar.

*Roja i kopshtit zoologjik*-figurë groteske që ushqen dhe mirëmban shqiponjë e mbyllur në kafaz. Shqiponja-simboli i lirisë dhe krenarisë kombëtare-në kushtet e sistemit totalitar ka përfunduar e mbyllur në kafazin robërues, ku ushqehet me cofëtina dhe kutërbon erë e keqe.

*Inxhinier Deda*- përfqson një Dedalin modern, për të cilin hamendësohet se prodhon mjete fluturuese/balona, për t’u arratisur nga ajo humbëtirë e izolimit dhe robërisë. Ai është prototipi i njeriut të rrëzuar, tek i cili aspirata për liri nuk ka vdekur. Një shpikës fantazmë, por që ndez tek Maksi ëndrrën e fluturimit si akt rebelimi.

*I pa njohuri në pijetoren Zorra*-përmes të cilit autori përcjell kumtin filozofik se liria, para se të jetë një kërkim mjetesh të jashtme për të dalë nga ferri dhe për t’u ngjitur lart, është një udhëtim i brendshëm dhe një proces vetëdijësimi.

Në romanin *Shkaba*, zgafella – hapësira ku bie Maksi – nuk është thjesht një vend fizik, por edhe një *metonimi dhe topografi e subkoshiençës*, një zbritje në “nënvetëdijen” e subjektit, që mbart brenda vetes traumën, frikën, fajin dhe absurditetin e ekzistencës në një regjim të dhunshëm e të çoroditur. E gjithë ngjarja e rënies së Maksit nuk është e verifikueshme si realitet objektiv, por shpалoset si rrjedhë e subkoshiençës, si tronditje psikologjike dhe situatë absurde.

Nën optikën e koncepteve të C.G. Jung, zgafella në rrafshin psikologjik simbolizon Hijen- anën e errët dhe të pavetëdijëshme të personalitetit, ato aspekte të vetes që ne i mohojmë, i fshehim apo i shtypim<sup>10</sup>. Hija ka natyrë ambivalente-ajo mund të jetë burim i frikës, por edhe i energjisë krijuese.

Halucinacionet e Maksit, ankthi, erotizmi i turbullt, iluzionet, të folurit përcart, dyzimet e shëmbëllimeve, megjullimi kujtesës etj. janë teknika narrative për të shprehur tjetërsimin e personazhit dhe përfutur një klimë tronditjeje psiko-emocionale të individit nën represionin totalitar. Kadare ndërton një atmosferë që të kujton rrëfimin kafkian: Maksi bie në zgafelle, kaplohet nga makthi dhe nuk gjen shpjegim për dënimin e tij.

Zgafella nëntokësore funksionon si një hapsirë liminale, një vend kalimi dhe shndërrimi –nga jeta në ferr, nga lartë në poshtë, nga vetëdija në subkoshincën. Në romanin *Shkaba*, realiteti i përshkruar është

i dyfishtë: nga njëra anë kemi një botë reale, të njohshme, një qytezë me institucione si posta, hoteli, me bare dhe pijetore, kështjella dhe kopshti zoologjik – shenja të një realiteti të zakonshëm, të organizuar sipas strukturës së shoqërisë moderne.

Por brenda këtij realiteti, rrëfimi pëson një çarje: protagonist fillon të rrëshqasë drejt një përjetimi të çuditshëm, gjysmë fantastik, ku kufijtë mes reales dhe fantastikes treten. Rënia në zgafelle shënon edhe çarjen e rrjedhës lineare të kohës dhe kalimin në një hapësirë tjetër.

Koha në zgafellen nëntokësore rrjedh si kohë mitike, e pappërcaktuar dhe pa referenca kalendarike.

#### 2.3 Shkaba -vatra polisemike e narrativës

Umberto Eko pohon se *“titulli i një vepre është çelësi për interpretimin e saj”*<sup>11</sup>, duke nënvizuar funksionin paratekstual dhe semiotik të titullit, si udhërrëfyes drejt kuptimit të veprës. Në rastin e romanit *Shkaba*, titulli nuk është thjesht një çelës interpretimi, por vetë *vatra semiotike* e ngjeshur, ku përqendrohen shtresat më të thella kuptimore, simbolike, politike dhe filozofike të kësaj vepre *polisemantike*.

Figura e shkabës shpалoset si një simbol i shumnashëm: *shkaba mitike sakrale-ndërmjetëse mes jetës dhe vdekjes, shpendi-totem* në mitologjinë e shqiptarëve, shqiponja -simboli i lirisë dhe krenarisë në ikonografinë *tonë kombëtare, emblema e shtetit shqiptar, shkaba e narrativës -si shpend mishngrënës, me ngarkesë ambivalente, si shpëtimtare dhe ndëshkuese njëkohësisht etj.*

Autori ka shpërnadarë në pëllhurën tekstuale sinjifikues si *“shpendi totem”*, *“emblema e shtetit”*, *“shqiponja në kafaz”*, *“përgjakja e simbolit të shtetit”*, *“akt at vrasës si në antikitet”* etj. të cilët shërbejnë si çelësa për dekodimin e rrafsheve kuptimore dhe domethënieve që deduktohen përmes interpretimit nga receptuesit/lexuesit e romanit.

Në mitologjitë klasike, shqiponja është simbol i një fuqie hyjnore (Zeusi), por edhe i dënimit hyjnor (shqiponja që shqyen mëlcinë e Prometeut). E vendosur në qendër të rrëfimit si një entitet mitik, *shkaba* rri pezull në qiellin e ferrit dhe shfaqet si përbindëshi i përgjakshëm që ushqehet me të internuarit. Ndëshkimi prej shkabës nuk rrjedh nga ndonjë instancë hyjnore dhe nuk është as simbol i ndonjë faji metafizik, por thjeshtë një makineri politike që riprodhon dhunën, si akt i mirëmbajtjes të pushtetit.

Kjo e afron figurën e shkabës simbolikisht me “shtetin” në kuptimin filozofik që jep Michel Foucault: një regjim që trupëzon pushtetin, që shtrihet mbi trupin e individit, që e disiplinon dhe e kontrollon, por gjithmonë përmes justifikimit të një qëllimi më të lartë (rendit, progresit, ideologjisë, të ardhmes etj.)

Shkaba, që në simbolikën kombëtare shqiptare përfaqëson identitetin kombëtar, fuqinë, krenarinë dhe lirinë, në roman transformohet në një *figurë ambivalente*, në shpend *shpëtimtar* por edhe në *përbindësh* që ushqehet me trupin e individit, në emër të një ideali të mjegullt, që më tepër kërkon nënshtrim se sa kuptim. Kadare përdor këtë dyzim për ta shndërruar shkabën në një përbindësh të sistemit totalitar, ku simboli kombëtar është shndërruar në mjet kontrolli dhe torture. Në këtë mënyrë, miti kombëtar – shqiponja – zhvishet nga nderimi dhe shndërrohet në një makth.

Shkaba e narratives është një “përbindësh-roje”, që kontrollon kufirin mes jetës dhe vdekjes, shpresës dhe dëshpërimit. Si e tillë ajo përfqëason një figurë të përngjashme me qeniet mitike që ruajnë portat e botës së nëndheshme. Shqiponja transformohet në një figurë mitike, gati hyjnore, e cila ngrihet në rangun e një “autoriteti” që ka legjitimitetin të flijojë, të kërkojë mish njerëzor, njësoj si hyjnitë pagane apo figurat totemike të mitologji të lashta.

9 Po aty f.43

10 Jung, Carl: (1969) *The Archetypes and the Collective Unconscious*, Princenton University Press (USA)

11 Eko, Umberto: *Emri i trëndafilut*, SHB Elena Gjika, Tiranë, 1996, *pasthënia*, f.449

Nga Tirana u nisëm herët, akoma pa lindur dielli. Qielli ishte i pastër dhe aty-këtu shfaqej ndonjë yll i largët. E prisja me padurim rrugëtimin për në Prevezë, ndonëse kisha shkuar dy herë në këtë qytet, nga më të bukurit e Epirit. Vajtja për herë të tretë atje, do të ishte e veçantë: do shkonim për të takuar dhe intervistuar Safet Dinon, vajzën e vetme të Ali Dinos, ndoshta e fundmja e gjakut të atit të madh të Dinove të Prevezës, Abedin Pashë Dinos. Tahir Muhedini ishte ai që drejtonte makinën. Në krah të tij Kujtim Gjonaj, regjisor i filmit të ardhshëm për Dinot e Prevezës. Në ulësen pas, isha unë dhe Spartak Papadhimetri, një nga operatorët e Kinostudios, nga më të njohurit dhe të talentuarit e filmit shqiptar. Kujtim dhe Tak Papadhimetri kanë qenë në Paris, mos gaboje në prill të vitit 2017, ndërsa unë nuk shkova dot, se më vdiq nëna. Falë Luan Ramës, në Paris kanë xhiruar rrugët, shtëpinë e Dinove, ndoshta edhe studion e piktorit Abedin Dino (i riu). Atje kanë shkuar edhe në shtëpinë e Boris Dinos, ku i kanë marrë një intervistë. Sipas prologut të skenarit, shkruar nga Luan Rama, ku jam bashkautor, Boris Dino, kushëri i parë i Safet Dinos, në shtëpinë e tij në Paris, rrethuar nga foto, letra apo dokumente të ndryshme për Prevezën dhe Dinot, i telefonon Safetit. Ai është i emocionuar dhe rikthehet në qytetin e të parëve të tij. Nga Preveza i përgjigjet në telefon Safeti...

Në po shkojmë atje ku jeton ajo, Safeti, për të xhiruar këtë skenë, dhomën ku ajo ka koleksionin e pikturave dhe karikaturave të babait të saj Ali Dino, si dhe relikte të tjera të Dinove të Prevezës.

Si asnjëherë tjetër kam shumë emocione. Vështroj nga dritarja e makinës fushën e Myzeqesë, disi të përgjumur, tutje në horizont malin mistik të Tomorrit, që duket sikur shtrin hijen e tij ngado, kodra të buta, maja malesh, ku lëvizin copa mjegullash, tufa me dele, fshatarë, që vjelin prodhimet e vjeshtës. Është tetor, një nga muajt më të bukur, ku dielli, veçmas në Shqipëri, por edhe në Epir dhe Greqi, ka një dritë, sikur vjen nga qiej të tjerë, mijëra e mijëra vjeçarë. Është një ndriçim si prej kohërave homerike.

Akoma jemi në viset shqiptare, në jugun tonë, ku lugina e Drinos duket akoma e dremitur, sikur kërkon të zgjohet nga bubullimat e maleve në të dya anët e saj. Gjyrokastër. Edhe këtu, copa mjegullash po lënë qytetin, duke u ngjitur shpateve gri të malit.

Më vjen, si prej mjegullave, 2 shtator i vitit 1979. Atëherë isha mësues i letërsisë në gjimnazin e Rrogozhinës. Të dielave çohesha më herët dhe nxitoja të shkoja në një kioskë, që ishte në anë të kryqëzimit të rrugëve, që shkonin për në Jug dhe Juglindje të vendit. Ajo ishte një kinkaleri e vogël, ku mund të gjeje çdo gjë. Unë blija çdo të dielë gazetën “Drita”. I thashë mirëmëngjes xha Aqifit, i cili ma ktheu në të folurën e çamërishtes: “Çu dive djalë”. Aqif Ademi ishte nga Filati i Çamërisë, i njohur kudo, veçanërisht nga çamët e Rrogozhinës, për zgjuarsinë, maturinë dhe këshillat që u jepte. Ishte i shkurtër, me flokë të bardha, sy të zgjuar dhe zhirues. Ato vite Moikom Zeqo më kishte dhënë një fotografi të Hemingueit. Aqif Ademi çuditërisht në portret i ngjante Hemingueit... Mora gazetën “Drita” dhe nisa të shfletoj në trotuarin më tutje, ishte botuar shkrim i Ferit Hudhrit “Piktorë shqiptarë që kanë punuar jashtë atdheut”. E lexova në trotuar. Pastaj në shtëpi. U gëzova si fëmijë: Çamëria ime kishte personalitete si, Ali Dino, Arif Dino dhe Abedin Dino (i riu). Ferit Hudhri më kishte hapur një portë për të njohur Dinot e mëdhenj. Ja thashë këtë Kujtim Gjonajt, para se të arrinim në Kakavi. Ke shkruar për këtë fakt shumë të bukur, pyet Kujtimi. Jo, i përgjigjem. E ruaj akoma atë gazetë të 2 shtatorit 1979. Besoj se do të shkruaj për Ferit Hudhrin. Dhe pastaj shtova: “Luan Rama me librin “Dino-shtegtari i Portës Sublime”, më ka hapur disa porta”. Kujtimi tha se ishte nga librat më të mirë që kishte lexuar...

Pas veprimeve burokratike në Kakavi, kishim hyrë në tokën greke. Edhe këtu kishte shumë diell. Një diell i bukur vjeshtë të dytë.

Nuk e di se pse mendova për portat e librit të Luan Ramës “Dino-shtegtari i Portës Sublime”. Nuk është një portë, që Luani hap dhe ti futesh në një botë tjetër, të bukur, joshëse, aristokratike, ku ndjen aromat e Prevezës, pastaj të Stambollit, Adanasë, Athinës, prapë të Stambollit, Moskës, Parisit, Korfuzit, Zyrihut... Kur e lexon këtë libër, shkruar bukur dhe me shumë kulturë, të duket se Dinot e Prevezës, që nga ati i tyre i madh Abedin Pashë Dino dhe pasardhësit e tij, kanë diçka si

# NË PREVEZË TE SAFET DINO, VAJZËN E VETME TË ALI DINOS

*Nga Enver Kushi*

përtej tokësorës. Ata janë tokësorë si gjithë të tjerët, por vepra që kanë lënë, ka një rrezatim tjetër, diçka sikur vjen nga qiejt, diçka yllësore. T’u qasesh atyre, do të thotë sikur u qasesh hapësirave qiellore, me dritën e përhershme dhe energjinë kozmike, që nuk shuhet apo humbet kurrë. Luan Rama në librin e tij i është qasur me mjeshtëri botës kozmike edhe magnetike të Dinove.

Këto mendoja, duke parë malet në të dyja anët e rrugës, që të çon në Janinë. Tek-tuk duken shenjat e vjeshtës së dytë në shtatet me pyje të këtyre maleve. Tahir Muhedini ul xhamin e makinës. Brenda futen aromat e vjeshtës, disi të lagështa si erë myshku a gjethesh, që bien në tokën e qullur nga shirat...


Hymë në Janinë. Qyteti ka kohë që është zgjuar. Këtu aromat janë ndryshe, ashtu, si dhe erërat që vinë nga liqeni. Kujtimi sheh orën. Nuk do të qëndrojmë në Janinë për kafe, thotë ai. Nxitojmë, se na pret zonja nga Preveza. Sa më shumë i afrohem Prevezës, duket sikur edhe malet e luginës së lumit të Artës, ulin kokat e tyre. Lugina ja lë vendin kodrave të buta dhe një fushnaje me limona, portokalle dhe ullinj. Shumë ullinj, mbushur me kokrra të mëdha, që kanë nisur të piqen. Ndihen erërat dhe aromat e Prevezës dhe të Epirit, që vinë nga Gjiri i Ambrakisë dhe siç shkruan Elena Gjika, parfume që vinë nga luginat e lumenjve Kalama e Aheron. Ka edhe shumë diell, dritë vjeshtë të dytë, që duket shumë më e bollshme se në Janinë.

I lodhur, dielli ulet mbi çati, them me vete një varg të një poezie të Arif Dinos. Me siguri ky varg është shkruar larg këtyre brigjeve, sepse në viset e Epirit dhe Prevezës së Dinove, dielli nuk është asnjëherë i lodhur. Asnjëherë.

Kemi hyrë në Prevezë. Tahir Muhedini qëndron diku, anës rrugës që të çon në qendër të

qytetit. Me një letër në dorë, ka të shkruar vendin ku na pret Safeti dhe pyet një zotëri të moshuar. Tahiri e flet shumë mirë greqishten, si shumë paramithjotë. Zotëria i tregon me dorë se nga do shkojmë. Pas 200 a 300 metrave, qëndrojmë prapë. Preveziani tjetër që pyet Tahiri, është djalë i ri, i cili tregon edhe ai me dorë nga do shkojmë.

Qyteti ka lënë pas stinën e verës dhe duket i qetë. Duket që banorët e përkohshëm, pushuesit e shumtë, kanë ikur, duke lënë këtë diell dhe qiell të pazakontë vjeshte. Anës rrugëve që kalojmë, shoh si zverdhonë kokrrat e limonave, portokalleve dhe shumë ullinj. Në ballkone prevezianët kanë mbjellë vazo me lule të ndryshme. Nuk është vështirë të dalloj edhe vazo me borzilok, vasilukia, siç i thonë në Thesproti dhe manxuranë. Ja ku është, thotë befaz Muhedini. E shihni? Është ajo zonja me fustan, që mban diçka në duar. Ndalojmë. Tahir Muhedini e përqafton, pastaj me radhë edhe Kujtimi, unë dhe Papadhimetri. Muhedini i thotë të ulet në sediljen para. E ndihmoj që të ulet dhe pasi zë vend, buzëqesh duke më falënderuar në frëngjisht. Pastaj i flet greqisht Muhedinit, duke i treguar nga duhet të kalojmë. Tahiri e pyet për shëndetin. Jam mirë, thotë. Kthehem djathtas e më pas drejt. Futemi në një rrugicë e më pas në një hapësirë mes ca shtëpive jo shumë të larta. Zbresim nga makina. Safeti e para. E takojmë prapë dhe ajo thotë italisht se është e lumtur, që vini nga Shqipëria e se nuk ka qenë asnjëherë në Tiranë. Vështroj portretin e saj, vështrimin e butë dhe rrudhat e shumta në ballë, poshtë syve dhe në qafë. Na thotë në greqisht që të urdhërojmë në shtëpinë e saj. Ajo ecën para nesh. Pak e kërrusur. Një korridor. Dy dyer të mbyllura në të dyja anët dhe një derë e hapur përballë. Futemi një nga një. Përballë



një dritare e madhe. Në të djathtë një si banak i lartë. Oxhaku. Muret janë të mbushura me pikturat, karikaturat e Ali Dinos. Fotografi të vjetra bardhë e zi.

Zonja Safet na fton të ulemi rreth një tryeze të mbushur plot me ëmbëlsira, një kek dhe shishe me coca-cola, ujë dhe lëngje frutash. Përballë nesh është ulur një zonjë e re. Safeti thotë se është vajza e saj, që quhet... Unë nuk e mbaj mend emrin e saj. Ajo na përshëndet ftohtë, ndërsa Safeti na uron edhe një herë mirëseardhjen dhe na fton të marrim ëmbëlsira. Pastaj shton se është e gëzuar që kemi ardhur nga Tirana. Kujtimi na prezanton. Pastaj shton se në Paris kanë intervistuar Borisin dhe se po xhirojmë një film dokumentar për Dinot dhe zonja Safet do na flasë për Ali Dinon, koleksionin e tij. Ah, tha Kujtimi. Do ta nisim me një telefonatë nga Parisi dhe zonja Safet që flet me Borisin. Pastaj thotë se edhe Luan Rama e përshëndet nga Parisi. Zonja Safet dëgjon me vëmendje. Na fton prapë të marrim ëmbëlsira e se jemi të lodhur nga dhromi i gjatë. Kam folur me Luanin, shton. Vajza e Safetit thotë se nuk do ta lejojmë nënën të flasë. Nuk do ta lejojmë. Ne nuk merremi me politikë. Taku përkthen në gjuhën shqipe. Thuaji zonjës, se ne jemi artistë dhe se do bëjmë film dokumentar e se nuk merremi me politikë, vazhdoi Kujtimi. Është e pamundur ta bindim atë. Safeti hesht. Duket që e ndjen veten ngushtë dhe se është e pafuqishme ta kundërshtojë të bijën. Kujtimi i thotë Safetit që t’i telefonojë Borisit... Pas pak ajo flet frëngjisht me Borisin, që kërkon t’ia japë telefonin vajzës.

Borisi flet greqisht me të. Vajza nervozohet dhe ja mbyll telefonin. Të gjithë qëndrojmë si të ngrirë nga kjo e papritur. Të lutem a mund të filmojmë dhomën dhe pikturat, karikaturat apo disa portrete të Ali Dinos, them unë. Muhedini përkthen në greqisht. Vajza e Safetit flet prapë e nervozuar... Ngrihem në këmbë dhe vështroj me vëmendje tablotë e vëna në korniza dhe që mbulojnë muret e dhomës. Prej kohësh ëndërroja të shihja këtë koleksion të jashtëzakonshëm të një prej karikaturistëve dhe piktorëve më të njohur në Athinën e viteve ’30. Një foto bardhë e zi. Ali Dino i ri në Prevezë. Foto e gjyshit të tij. Edhe e babait Rasih Dino në një nga karikaturat a pikturat a burra çamë të Prevezës me veshje karakteristike. Alba Dino, këngëtarja e njohur e operës së Athinës, bashkëshortja e Ali Dinos dhe nëna e Safetit, me origjinë nga Triestja. Tablo të tjera. Edhe foto. Safeti me të atin, Ali Dinon në një foto bardhë e zi, kur ajo është fëmijë, që kanë dalë në Athinë. Një çertifikatë mirënjohje nga Bashkia e Prevezës për bashkëqytetarin e nderuar. Këtu, në këtë dhomë jo shumë të madhe, ndjej aromat e një kohe tjetër, Athinën e viteve ’30 dhe kontributin e Ali Dinos në kulturën e këtij qyteti, ku ai u bë kryetari i shoqatës “Bashkimi i Karikaturistëve” të Greqisë, si dhe një nga drejtuesit e shoqatës “Bashkimi i Arteve të bukura”.

Ulem në tavolinë. Safeti na fton prapë të hamë biskota. Ajo ruan fisnikërinë, mikpritjen e Dinove të famshëm të Prevezës. Edhe ngrohtësinë e njohur të prevezianëve. Ngrihem. Po një fotografi a mund të bëjmë, pyes unë vajzën e Safetit. Safeti pa pritur miratimin e vajzës, futet në mes tonë... E kam kujtim të paharruar këtë foto me Safet Dinon, pinjollen e fundit nga dera e madhe, më e njohura dhe më e lavdishmja e Abedin Pashë Dinos.

Dalim jashtë. Ndahemi duke e përqaftuar Safetin. Ajo buzëqesh dhe na uron udhë të mbarë. Qëndron te shkallët e shtëpisë, si e ngrirë, me dorën lart. Preveza mbetet pas me diellin e vjeshtës së dytë dhe me mikpritjen e Safet Dinos.



DHE PASTAJ BËNI DASHURI

Dhe pastaj bëni dashuri.  
Jo seks, vetëm dashuri.  
Me këtë dua të them puthje të ngadalta në gojë  
në qafë, në gjoks, në shpinë,  
kafshoni buzët, kryqëzoni duart.  
shihuni sy më sy.  
E kam fjalën për përqafime kaq intime  
sa të shndërroheni në një trup të vetëm,  
trupa që ngjishen dhe shpirtra që shtypen  
me ndjesi fërgëlluese,  
përkëdhelje me çjerrje e gërvishtje, rroba që  
flaken së bashku me frikën  
puthje si shenja ngazëllyese  
mbi mizerjen e jetës,  
që deri ato çaste ishin të gabuara.  
E kam fjalën për gishtërinjtë që shtypen në mish,  
duke krijuar yje,  
duke thithur aroma, zemra që rrahin në të  
njejtën kohë  
psherëtima që fluturojnë me të njëjtin ritëm,  
dhe buzëqeshjet,  
të singerta më në fund, pas një kohe kur  
s'ishin të singerta.  
Po, bëni dashuri dhe mos u turpëroni  
sepse dashuria është art dhe ju jeni kryevepra.

ATA SI UNË

Ata si unë japin ëndrra, edhe pse çmimi është shpërfillja  
Ata si unë dhurojnë shpirtin sepse shpirti fillikat është një pikë ujë në shkretëtirë  
Ata si unë të mbajnë dorën dhe të ndihmojnë të ngrihesh  
ndërkohë që vetë rrezikojnë të bien  
Ata si unë shikojnë përpara  
edhe pse zemra ka mbetur disa hapa mbrapa  
Ata si unë kërkojnë rrugën për të mbijetuar dhe kur e gjejnë atë  
përpiqen t'ua mesojnë atyre që kanë rënë  
Ata si unë kur bien në dashuri duhen përgjithmonë  
edhe kur ndalojnë së dashuruari kjo ndodh sepse  
pjesë të vogla të qenies së tyre dergjen të pafuqishme në duart e jetës  
Ata si unë kanë një ëndërr  
t'ju duan ashtu siç jeni  
dhe jo pse dikush ju do ndryshe  
Ata si unë udhëtojnë nëpër botë në kërkim të atyre vlerave  
Që në kohën tonë kanë dhënë shpirt në udhën ku shkojnë shpirtrat  
Ata si unë e pelqejnë ndryshimin  
por në një mënyrë të tillë që të lindin përsëri  
Ata si unë ulërijnë në heshtje  
sepse zërin e tyre nuk duhet ta dëshmojnë lotët  
Ata si unë janë qenie delikate që mund t'u thyet zemra shpejt  
dhe mund t'ju lënë të largoheni pa kërkuar kurrfarë shpjegimi  
Ata si unë japin dashuri të madhe, por si përgjigje nuk marrin veçse thërrime  
Ata si unë ushqehen me pak gjëra që për fat të keq arrijnë gjer te mbijetesa  
Ata si unë kalojnë pa bërë kurrfarë pershtypjeje  
por janë të vetmit që të duan vërtet  
Ata si unë janë qenie të tilla, që në vjeshtën e jetës suaj mund t'ju bëjnë të pendoheni për gjithçka që mund t'ju jepnin dhe ju nuk i deshët

MANTELI

Një mantel qëndroi kaq kohë në shtëpinë tonë  
ishte prej leshi të mirë  
fin, i krehur imët  
një mantel i veshur shumë herë  
për raste, një mijë herë i kthyer nga brenda  
nuk i ndahej fytyra e babait  
fytyra e tij e brengosur apo e gëzuar  
varur në një grep apo në një varëse në dollap  
mori duhmë prej ronitjes;  
përmes atij manteli të vjetër  
mësova sekretet e babait  
për ta ruajtur këtë jetë, në hije



ALDA MERINI  
Kjo zemra ime

Cikël me poezi  
Përktheu Roland Gjoza

NATË, NË QOFTË SE TI NUK VJEN SHPEJT

për E.C

Natë, në qoftë se ti nuk vjen shpejt  
s'ke kohë për të mbuluar ëndrrën  
sytë e mi janë fanarë dhe ti fryma që i vesh me avull  
ti fle në zemrën e grave  
oh, i vogli asfodel!  
po aq shpejt sa gishtërinjtë kanë për të gërvishtur cipën e akullit  
ti do të kthehesh- me një buqetë me lule  
të më bësh të lumtur  
i etur filxhani yt prej fildishi  
të etur testikujt e tu prej epshit  
dhe gjishtërinjtë e mbushur me kumbulla  
lulëzojnë në parfume të pafundme

KOHA E TANISHME

Unë shpesh përsëris në heshtje  
se ju duhet të më kujtoni  
edhe pak ditë para se të shkoj përfundimisht.  
Ajo që është e shkuar nuk ekziston më.  
E shkuara është burg  
I kujtesës  
me merr gjithë energjinë e të tanishmes,  
e shkuara është tym  
i atyre që s'kanë jetuar.  
Ajo që kam parë tani shpejt nuk do të thotë më asgjë.  
E shkuara dhe e ardhmja nuk janë realitete, por vetëm iluzione kalimtare.  
Dua të jem e lirë nga koha  
të jetoj të tanishmen, sepse kohë tjetër s'ka  
veç ky çast mahnitës!

MARTESË ROMANE

Ja, kjo do të jetë shtëpia jonë e re,  
jam sot këtu për ta parë;  
po ti kush je, o sarhosh i seksit dhe i pijes?  
Ti kush je?  
ta di prirjen, që ti e fsheh  
dhe atë pamje të pamëshirshme.

Shpirtin tim ngulmon të rrëmosh  
( jo të më njohësh, as të më ndihmosh  
por që të nxjerrësh të fshehtat më intime  
dhe të kenaqësh instinktet primitive.

Ti do që të më pushtosh trup e shpirt  
me mënyrat e tua të maskuara;  
të gjakosësh mishin tim me dhëmbë  
të sundosh mbi zjarrin e pasioneve të mia  
për të mbytur ndjenjën e vërtetë.

Si një shkëmb që ndan lumin  
vërshimin e tij të pandalshëm  
në mënyrën më mizore, do të më flakësh  
mua  
në krahët e një delte, plot dhembje

POETËT PUNOJNË NATËN

Poetët punojnë natën  
kur koha nuk i nxit të shpejtojnë  
dhe zhurma e turmës ka vdekur  
dhe ora s'të linçon me tik- tak.  
Poetët punojnë në errësirë  
si skifterët apo bilbilat e natës  
që këndojnë me aq ëmbëlsi  
sikur kanë frikë mos lëndojnë perëndinë.  
Por poetët, në heshtjen e tyre  
bëjnë zhurmë më të madhe  
se një kupolë e artë me yje

E ÇMENDUR, E ÇMENDUR, E ÇMENDUR  
NGA DASHURIA PËR TY

Të pres dhe çdo ditë  
vdes pak e nga pak  
ta kam harruar fytyrën.  
Më pyesin nëse brenga ime  
është më e madhe se mungesa jote;  
jo, është diçka më tepër;  
një shenjë e sigurtë e vdekjes  
nuk mund ta bëj dhuratë

KAM GJETUR MREKULLITË TEK TI

Kam gjetur mrekullitë tek ti  
mrekullitë e një dashurie krejt të re  
që më ra papritur si një predhë  
dhe ndieva kundërmimin e detit  
në një plazh të zakonshëm, te zbrazët,  
dhe humba në dashuri si në stuhi  
po zemrën e kisha fare të qetë  
e donte një iluzion, e shkreta

KJO ZEMRA IME

\* \* \*  
Nuk dua para  
dua vetëm ndjenja  
të mbushura me fjalë,  
fjalë të zgjedhura me mënçuri  
nga lule që iu thonë mendime  
nga trëndafila që iu thonë prani  
nga ëndrra që jetojnë në pemë  
nga këngë që i bëjnë statujat të vallëzojnë  
nga yje që iu mërmërisin dashnorëve në vesh  
dua poezinë  
magjinë që heq peshën e rëndë të fjalëve  
që trand me emocion dhe ngjyra dalldisëse

\* \* \*

Dashuri, mos më dëno për fatin tim  
mbaji hapur për mua të katër stinët  
lermë të bie  
e madhe dhe e ngrohtë  
të mos më zërë gjumi duke ngarë makinën  
jepu një fre të gjitha dëshirave  
të fle në jastëk të ëmbël  
ku zgjohen ambicie të vogla  
të dashurisë dhe te pasioneve universale  
merrmë gjithçka, por mos më plagos!

\* \* \*

Nuk mund të shkruaj në këtë çast, nuk mund  
të shkruaj për lulet, sepse  
e tëra jam kthyer në lule  
e tëra jam mbushur me limfë dhe kërcej

\* \* \*

Nuk mund t'i rezistosh dashurisë  
sepse duart duan të pushtojnë bukurinë  
jo të presin të hutuara vite të tërë në heshtje  
sepse dashuria është të jetosh dymijë ëndrra  
gjer te puthja sublime

MË MIRË TË ISHA ZOG

Për mua më mirë të isha zog  
me bark të bardhë e pupla të ngrohta  
por dikush do t'ma priste fytin  
nuk di përse, ndoshta pa shkak  
vetëm sa për të qeshur, ha, ha...  
Për mua më mirë të isha albatros  
të fluturoja mbi dete e oqeane  
por dikush do t'm'i priste krahët  
pa kërkuar falje, ashtu më kot  
po edhe e shtrirë përtokë, në agoni  
unë do të këndoja për ju  
këngët e mia të dashurisë

FLUTURA TË LIRA

Oh, gra të varfëra dhe të vetmuara  
të dhunuara nga ata  
që nuk ju njohën.  
Gra me duar  
në foshnjëri.  
Sekrete të ëmbla  
dashurish mbani mend  
me të cilat  
babëzia juaj natyrale  
nuk do të ngopej kurrë.  
Do të hani dhe pluhur  
do të përpiqeni të çmendeni  
por nuk do t'ia arrini,  
do ruani fillin e arsyes  
që do t'ju ndajë  
më dysh.  
Nga këto thellësi  
plagësh  
do të çliroheni  
flutura të lira.

Hitoshi dilte gjithmonë me një zile të vogël të lidhur në mbajtësen e kartës; nuk ndahej kurrë prej saj. Ishte një dhuratë e vogël që ia kisha bërë kur ende nuk ishim të dashuruar. Nuk kishte ndonjë kuptim të veçantë, megjithatë ai e mbajti me vete deri në fund. E njoha në vitin e dytë të gjimnazit; edhe pse ishte në një klasë tjetër, u bëmë miq sepse, ashtu si unë, edhe ai ishte pjesë e organizatorëve të ekskursionit të atij viti. Programi ishte i ndryshëm për çdo klasë, ndaj bashkë bëmë vetëm udhëtimin me tren. Kur zbritëm në stacion, ngaqë nuk donim të ndaheshim, ia shtrënguam dorën me shaka njëri-tjetrit. Pikërisht në atë çast më ra ndërmend që në xhepin e uniformës kisha një zile të vogël që kishte rënë nga qaforja e maces tonë. Ia zgjata duke i thënë: “Një dhuratë lamtumirë”. Ai qeshi dhe tha: “Ç’është kjo?” por megjithatë e mbështolli me shumë kujdes në një shami, sikur të ishte diçka me rëndësi. U befasona shumë: dukej si një gjest krejt i pazakontë për një djalë në moshën e tij. Sa e çuditshme, mendova, e bëri vallë se ia dhashë unë, apo thjesht nga edukata? Gjithsesi, gjesti më pëlqeu shumë. Ajo zile vuri në lëvizje ndjenjat tona. Na mbeti në mendje përgjatë gjithë udhëtimit. Sa herë që zilja tingëllonte, ai më kujtonte mua dhe çastet tona, ndërsa unë kaloja ditët duke menduar për të dhe për atë zilen që e shoqëronte nën një qiell të largët. Me t’u kthyer nisi një dashuri e madhe. Për katër vjet me radhë, zilja ishte gjithnjë me ne; në çdo orë e çdo çast. Ajo u bë dëshmitare e puthjes së parë, e zënkave të mëdha, e shiut, dëborës, kohës së mirë, natës së parë. Sa herë Hitoshi nxirrte mbajtësen e kartës, të cilën e përdorte edhe si portofol, dëgjonim atë tingull të mekur të argjenditë. Është një tingull që ende më rri në vesh; i ëmbël dhe i dhembshur. Po ta them hapur, mund të duket si sentimentalizëm vajzash, por po e them prapë: e dija. E kisha nuhatur. Ishte diçka që më trondiste thellë në shpirt.

Ngandonjëherë, edhe kur Hitoshi ndodhej aty përpara syve të mi, më dukej sikur nuk ishte. Edhe kur flija, shpesh ndjeja nevojën t’ia mbështesja veshin në kraharor, pa ditur pse. Herë-herë buzëqeshja e tij ishte aq e ndritshme, sa më verbonte. Kishte në të një lloj kthjelltësie. Pikërisht asaj kthjelltësie ia vishja atë ndjenjë brishtësie dhe ankthi që ai më përçonte. Do të ishte edhe më e dhimbshme, po ta kisha marrë si një parandjenjë... Në njëzet vitet e mia të jetës, nuk kisha përjetuar kurrë një tronditje si humbja e të dashurit. Vuajta aq shumë, sa ndjeva se isha shuar e tëra. Që nga ajo mbrëmje kur ai vdiq, shpirti im sikur u zhvendos në një dimension tjetër, nga i cili nuk mund të kthehej më në asnjë mënyrë. E kam të pamundur ta shoh botën me sytë e dikurshëm. Mendja më endet e paqëndrueshme, pa prehje, në një zbrazëti të turbullt. Sikur të kisha kaluar nëpër ato përvoja nga të cilat njeriu lutet të shpëtojë: aborti, prostitucioni, apo ndonjë sëmundje të rëndë. E di, ishim ende të rinj dhe ndoshta lidhja jonë nuk do të zgjaste tërë jetën, megjithatë kishim kapërcyer bashkë shumë sprova. E kishim parë dashurinë tonë të thellohej, duke u përballur me barrën e problemeve që i kishim hasur një e nga një. Kështu ndërtoam katër vite të jetës sonë. Tani mund të bërtas: *Çfarë Zoti je ti?! Unë e doja Hitoshin më shumë se vetë jetën time.*

\*\*\*

Dy muaj pas vdekjes së tij, çdo mëngjes mbështeteshja te kangjellat e urës mbi lumë dhe pija një çaj të ngrohtë. Kisha filluar të vrapoja në mëngjes herët, ngaqë nuk më zinte gjumi, dhe aty ndaloja për të pushuar para se të kthehesha. Gjumi i natës ishte gjëja që më trembte më shumë. Sepse ishte e tmerrshme tronditja kur hapja sytë. Çfarë frike më sillte ajo errësirë e thellë! Të gjitha ëndrrat më lidhnin me Hitoshin. Në atë gjumë të lehtë e të ankthshëm e gjeja dhe e humbisja Hitoshin pa pushim. E dija që ishin vetëm ëndrra, se në realitet nuk do ta takoja më. Prandaj bëja çmos që të mos

Së shpejti nga “Trishtil”

# BANANA YOSHIMOTO

## Hija e dritës së hënës

Përktheu: Ledia Dushi

zgjohesha. Sa herë, duke u përpëlitur, me djesë të ftohta, kam pritur agimin e akullt krejtësisht e dëshpëruar.

Përtej perdes nisi të zbardhë, dhe unë përplasesha në një kohë të zbehtë e të palëvizshme, aq të ftohtë dhe të trishtuar, saqë më merrte malli për ëndrrat e pak çasteve më parë. Qëndroja me sytë hapur në agimin e vetmuar, me dhimbjen që më kishin lënë ëndrrat. Zgjohesha gjithnjë në të njëjtën orë. E përjetova për herë të parë lodhjen nga gjumi i trazuar dhe frikën e asaj ore të vetmuar, kur, si në një delir të gjatë, prisja dritat e para të agimit.

Pikërisht atëherë vendosa të vrapoj. Bleva dy palë tuta të shtrenjta, atlete të mira, madje edhe një termus për pije. Të filloje diçka të re duke u nisur nga objektet, ishte mënyra më e gabuar, por duhet të shihja përpara. Me ardhjen e pranverës nisa të vrapoja çdo mëngjes. Shkoja deri te ura, kthehesha, laja peshqirin, lija gjithçka në tharëse, ndihmoja mamanë për mëngjesin. Pastaj flija pak. Jeta ime rridhte në këtë mënyrë. Në darkë dilja me shoqet, shihja filma, bëja gjithçka për t’i lënë vetes sa më pak kohë të lirë. Por ishte mundim i kotë. Gjithçka që në të vërtetë doja ishte një dhe vetëm një: të takoja Hitoshin përsëri. Por

duhej ta mbaja patjetër mendjen, trupin, duart në lëvizje. I mbushja mendjen vetes se, po të vazhdoja të këmbëngulja, dikur do të hapej një dritare. Kështu besoja. Nuk isha e sigurt, por besoja se do të arrija të mbahesha deri atëherë. Kur më kishte ngordhur qeni, kur më kishte ngordhur një zog i vogël që mbaja, kisha vepruar pak a shumë kështu. Por tani ky mekanizëm nuk funksiononte. Ditët kalonin monotone, gjithnjë e më të zbrazëta. Ia përsërisja vetes si në lutje: *Do t’ia dal. Do t’ia dal. Është vetëm çështje kohe.*

Lumi ku ndalesha çdo ditë ndan qytetin më dysh. Deri te ura e bardhë që lidh të dy brigjet duhen njëzet minuta. E doja atë vend. Aty unë dhe Hitoshi, që banonte matanë lumit, takoheshim gjithmonë, prandaj, edhe pas vdekjes së tij, vazhdova t’i rrija besnike. Rrija në një copë vend ku s’kishte kurrë njeri, pija ngadalë çajin e nxehtë dhe dëgjoja zhurmën e ujit. Argjinaturat e bardha humbnin tej, dhe qyteti fshihej në mjegullën e kaltëreme të agimit. Në atë ajër të pastër, të hidhur e të kristaltë, më dukej se isha më afër vdekjes. Jo për mazokizëm, thjesht, po të mos e përjetoja atë çast, nuk do të mund ta përballoja pjesën tjetër të ditës. Ai peizazh ishte bërë i domosdoshëm për mua.

Edhe atë mëngjes pashë një ëndërr dhe

u zgjova e trembur. Ishte ora pesë e gjysmë. Agimi premonte një ditë të kthjellët. Veshja rrobat e vrapit dhe dola. Ajri ishte i akullt dhe rrugët, të zbardhura e të mjegullta. Qielli blu i errët fillonte të merrte në lindje një nuancë të butë të kuqe. E detyroja veten të vrapoja. Ndonjëherë, kur më merrej fryma, dyshoja se mos vallë po i bëja keq vetes, por e largoja atë mendim; të paktën, kur të kthehesha, do të flija. Rrugët ishin aq të heshtura saqë më dukej sikur po humbisja vetëdijen. Zhurma e lumit po afrohej. Qielli ndryshonte çast pas çasti. Një ditë e bukur po lindte. Si zakonisht, kur arrita te ura, u mbështeta te kangjellat dhe hodha sytë nga qyteti që po tretej në dritën e kaltër. Lumi rridhte me një zhurmë të fuqishme, duke tërhequr çdo gjë me shkumën e tij të bardhë. Një erë e ftohtë më frynte në fytyrë, duke më tharë djesën. Në ajrin ende të ashpër të marsit shkëlqente qartë gjysmëhëna. Frymëmarrja më shndërrohej në avull të bardhë. Ndërsa vështroja lumin, derdha çajin në kapakun e shishes dhe isha gati ta pija. Në atë çast, një zë u dëgjua papritur pas shpinës sime.

“Çfarë çaji pi? Më lër ta provoj?”

U drodha. U trondita aq shumë sa më ra shishja në lumë. Në dorë mbeti vetëm kapaku plot me çaj të nxehtë. M’u përzien mendimet. U ktheva. Përpara meje qëndronte një vajzë duke buzëqeshur. Dukej pak më e madhe se unë, por nuk ia kuptoja dot moshën. Ndoshta rreth njëzet e pesë... Kishte flokë të shkurtër, sy të mëdhenj dhe vështrim të kthjellët. Veshur me një mantel të bardhë, sikur nuk e ndiente të ftohtin. S’e kisha ndier fare praninë e saj. Ndërkohë më tha përsëri me zë të çuditshëm e të ëmbël:

“Ndodhi si në atë përrallën e Grimëve. Apo të Ezopit? Përralla e qenit”.

“Në përrallë, - i thashë ftohtë, - qeni sheh hijen e vet në ujë dhe i bie kocka vetiu. Nuk ia hedh kush”.

“Kjo do të thotë se do të ta blej unë një termus të ri”, - tha ajo duke qeshur.

“Faleminderit...” - thashë dhe buzëqesha pa dëshirë. Ishte aq e qetë sa nuk më bëhej ta qortoja; m’u duk vërtet e parëndësishme. Jo, nuk dukej as e çmendur, as e dehur. Kishte sy tepër inteligjentë, dhe në fytyrë një thellësi të frikshme, sikur mbi të ishte derdhur gjithë gëzimi e trishtimi i botës. Për këtë, ndoshta, ajri rreth saj dukej se hapej si perde e padukshme. Mora një gllënjë të vogël çaji dhe ia zgjata pjesën tjetër.

“Merre... është çaj dardhe”.

“Ah, më pëlqen shumë!” - tha, duke rrëmbyer kapakun me gishtat e saj të hollë. - “Sapo kam ardhur. Vij nga goxha larg”.

“Për turizëm?” - e pyeta, duke menduar: Çfarë kërkon këtu?

“Këtu së shpejti do të ndodhë një shfaqje që shihet vetëm një herë në njëqind vjet”, - tha.

“Një shfaqje?”

“Po. Nëse janë kushtet e duhura”.

“Çfarë shfaqje?”

“Është sekret. Por do të ta them, në këmbim të çajit”, - qeshi dhe unë nuk pyeta më.

Mëngjesi po afrohej. Qielli po zbardhte ngadalë me një dritë të argjenditë. Mendova se duhet të kthehesha.

“Mirë, unë po shkoj”, - i thashë.

Ajo më shikoi drejt në sy me atë dritën e thellë.


“Unë quhem Urara. Po ti?”

“Satsuki”.

“Shihemi”, - tha dhe më përshëndeti me dorë. Edhe unë ia ktheva përshëndetjen. Çfarë njeriu i çuditshëm! Mendova se nuk kuptova asgjë nga ato që tha, por megjithatë kisha përshtypjen se nuk ishte një krijesë e zakonshme. Teksa vrapoja, më pushtuan dyshime të çuditshme. Për një çast u ktheva nga pas. Urara ishte akoma mbi urë, duke parë lumin, e kthyer në profil. Mbete e shtangur: nuk ishte më fytyra e vajzës së qeshur. Kishte marrë një shprehje solemne, të rëndë, kishte fytyrën e dikujt jashtë kësaj bote. Kur pa se isha ndalur, buzëqeshi sërish dhe ma bëri me dorë. E hutuar, ia ktheva dhe vazhdova vrapin. Ç’është vallë ajo vajzë? pyeta veten e turbulluar.

# BANANA

# YOSHIMOTO



# Kitchen

Roman

HIRI I UDHËVE TË DJEGURA

Kur linda unë, nëna më lidhi në djep  
Me një udhëz oborri, qendisur anash  
Me xhufka bari.

Kur fillova të ecja,  
Nëna m'i mbloodhi gjurmët e endura mbi  
pluhur  
I çoi tek plaka e moçme e fshatit  
Të më thurte çorape udhësh.

Kur vesha çorapet e reja,  
I dogja të gjitha udhët e botës  
E në hirin e tyre vizatova  
Një udhë zjarri.

Pastaj erdhi dita  
Kur hiri i udhëve të djegura  
U bë në zemrën time,  
Një udhëz e fshehtë, e fshehtë,  
Që më çon tek oborri.

POTKOI PREJ TYMI

Drutë e njoma të dimrit digjeshin në vatër  
Tymi ngjitej plogësht në tavan, i zi sterrë  
Pastaj, endej duke lodruar nëpër dhomë  
E qendronte si potkua varur mbi derë.

Sa herë nëna lyente në pranverë shtëpinë  
Mbi potkua binin dy pikëza të vogla gëlqere  
Teksa unë e vëzhgoja gjatë e me kureshtje  
Si një shenjzë që Zoti na dërgonte atëhere.

Dy pikëza gëlqere ndriçonin nëpër net  
Me një dritëz të dobët, të mekur  
Dhe mua nuk di pse më dukeshin shpesh  
Si sytë e një kali të vdekur.

KËMBANAT E GJAKUT BIEN NË  
ERRËSIRË

Ulem një çast mbi gurin e mëkatit  
E dëgjoj këmbanat e gjakut  
Që bien në errësirë.

Muzgu kundërmon aromë pendese  
Nga lulet e zeza të vetmisë  
Që çelin e vyshken vetvetiu  
Në mendimet e mia të bardha.

Ku është altari i dritës  
Të bëj një lutje besimi?

Gjithë jetën kam adhuruar altarët  
Në të gjithë tempujt e botës  
Por ardhka një ditë, kur njerëz si unë  
U bëkan viktimë e këmbanave të gjakut  
E gjithë besimi i rritur në vite  
U thërrmuaka  
Si një copëz e hollë xhami.

Ah! Mëkati im i gurëzuar,  
Sivëllai im me gjak Adami.

ARMIKU IM I PAFAJ

Armiku im i pafaj...

Faji yt jam unë, i pandriçuari  
Që kaloj para teje pa duartrokitur asnjëherë  
Madhështinë tënde të rreme  
Skalitur në vite.

Armiku im i pafaj  
Letër e bardhë  
Me njolla të zeza drite.

KAFE GURI PA MËKAT

Sa herë bëhet natë  
Një kukuvajkë zbret nga pema e gjakut  
E vajton mbi supet e statujës  
Fshehur nën hijen e yjeve.



NURI PLAKU

Muzika e ujërave  
kthehet në dritë

Cikël poetik

Unë e vështroj nga dritarja e kujtesës  
E mendoj për mëkatin e ringjalljes së rreme.

Kur hero i ishte në jetë  
E pija kafën në të njëjtin lokal me të  
Madje herë – herë, në një tavolinë pranë tij  
Por kurrë s'e kisha vënë re  
Atë lloj heroizmi  
Që do shpikëj një ditë  
Nga idhtarët e tij të besuar.

Kohët ndryshuan  
E rëndomta u bë heroike  
Heroi u bë statujë  
Dhe tashmë  
Mbi supet e tij  
Vjenë kukuvajka  
E vajton nëpër natë.

Unë e vështroj nga dritarja e kujtesës  
E i ofroj një kafe guri  
Pa mëkat.

MUZIKA E UJËRAVE  
KTHEHET NË DRITË

Kur muzgu fle  
Liqeni psherëtin  
Burgun e përjetshëm të brigjeve.

Kur muzgu zgjohet  
Mijëra valëza kreshpërohen  
E vallëzojnë me flladet  
Valsin e tyre magjik.

Ky është çasti  
Kur muzika e ujërave  
Kthehet në dritë.

VIJMË E IKIM

Prelud i kaltër qielli  
Shkruar me flatra pëllumbi.

Rekuiem guri  
Shkruar me flatra korbi.

Vijmë e ikim...  
Teksa mbrapa nesh  
Myshku i kaltër i mëkatit  
Vezullon barbarisht.

O harabel i vogël i oborrit  
Më shkruaj në ajër  
Një epitaf të trisht.

NGJASHMËRI ME TOKËN

Më rëndon në shpirt fizika e tokës...

Një grimcë dheu më ngjitet pas trupit  
Më bëhet nyjez në lëkurë  
Një re pluhuri më mbështillet rreth vetes  
Më bëhet rrudhë.

Unë eci e eci  
Sa më shumë gjurmë lë mbi të  
Aq më shumë i ngjaj asaj.

Vetëm ajri nuk lejon ngjashmëri  
Ajri është kujtesa ime e gjallë  
Se m'i ruan qeshjet e hovshme  
Madje me to është formuar edhe zemra e  
një ylli të largët  
Po drita nuk vjen deri tek unë  
Dhe unë, tani për tani  
S'kam për ta parë atë dritë  
Duke u bërë shkak për një tjetër udhë.

Më rëndon në shpirt fizika e tokës...  
Një grimcë dheu më bëhet nyjez  
Një re pluhuri më bëhet rrudhë.

QYTETI I ÇMENDUR

Kurrë nuk e besoja  
Se qyteti im do të çmendej një ditë  
E do thyente copë - copë  
Aritmetikën e shifrave.

Madje tinëz, pa u vënë re.

Dy jetë i bënë zero  
Dy vdekje i bënë tre.

KUJTESA E QESHJES

Ndes cigaren në një vetëtimë dimri  
E tymos bulevardin  
Të shijojë ditën e bruztë.

Qyteti po zbukurohet pandërprerë  
Njerëzit rrallohen dhe unë jam më i lirë  
Të lëviz çakërrqejf mes shirave  
E të gëzojë të mirat e kësaj bote  
Aq shumë të dëshiruara  
Nga një gjallesë e lagur si unë.

Vetëm se më mungon diçka  
E vogël..., pa rëndësi  
Për të cilën si për dreq  
Kujtohem shumë rrallë.

Kur kam qeshur për herë të fundit vallë?

UDHË E PASHTRUAR

Sa herë më futet ndonjë guralecë në këpucë  
Më kujtohet një borxh i vonuar.

Sa shumë gurë ka kjo dreq udhë...  
Udha ime e pashtuar!

GJAKU I TURBULLT I FJALËVE

Ma shpoi mespërmes heshtjen e trazuar  
Klithma e një shpendi nate.

Nga plaga e hapur  
Pikoi pikë, pikë  
Gjaku i turbullt i fjalëve.

IKJE NË SHPINË

Kishim kohë që iknim në shpinë  
Përditë nga pak, nga pak për ditë  
Ikja bëhej largësi  
Largësia bëhej ftohtësi  
Ftohtësia bëhej psherëtimë  
Psherëtimja bëhej vetmi...

Të kujtohet dita kur u nisëm?  
Se kush qau nga ne të dy  
Kur gjëmbi i dyshimit  
Gërvishi varakun e argjendit  
Mbi kurorën e brishtë të martesës  
Që aq shumë shkëlqente.

Pastaj lotët u gurëzuan  
Me fytyrën e një fëmije  
Që grindej  
Se s'donte të lindte.

O SHIRA, MË JEPNI NJË YLBER

Ajo iku me hënën e ngrënë të tetorit  
E nuk u kthye kurrë më,  
As në ëndrrat e netëve  
As në ëndrrat e ditëve  
Ndërsa lotët e mallit tim  
Bëhen rrëkajë, rrëkajë.

O shirat e butë të vjeshtës  
Më jepni një ylber  
Të mbështes kryet e lodhur  
Sa të shikojë  
Fytyrën e saj!

MURI

Këtu gjendet muri... egziston... përballë  
teje një dritare e mbyllur  
fotua në të djathtë është e nënës sate kur  
ishte e re  
me një buzëqeshje dhe vështrim prej dreri  
të trembur  
që i ngjan kështu kaq shumë buzëqeshja e  
bijës tonë

Janë lulet mbi pezul dhe staujëza e një elfi  
blerë në Irlandë.  
Ishte muaji ynë i mjaltit dhe çdo ditë më  
zgjonin puthjet  
zënë dorë për dorë jeta ngjante me një  
udhëtim të bukur

është afërmendsh që muri gjendet ...  
egziston si mua  
ngandonjëherë ti i mban syte atje pa  
arritur ta shohësh  
por unë kam një zemër që nuk ka pushuar  
kurrë së dashuri ty

mos u shtir në këtë farë feje, mos më  
shpërfill kështu  
vrije, këtë qetësi para së të jetë shumë  
vonë  
një qetësi që ka një fushë me forcë  
magnetike  
një rreze në shtirje që do të bënte të  
zbehej tingulli

e tërbuar ... ngre zërin ... bertas ... bërtas  
jam këtu përballë teje, si s'më dëgjon?  
Më vështro në sy, nuk më sheh më, i  
dashur,  
nuk më sheh më?  
ma jep pasionin... ma jep zemrërimin... ma  
jep xhelozinë  
më jep një shenjw reagimi , cfarëdo, veç  
më jep një  
unë bërtas, ti qëndron i heshtur  
me vështrim të pwrhumbur dhe buzë të  
qepura

qetësi  
jashtë dritares shiu u shtie frikën fijeve të  
barit  
kurorat e luleve fërgëllojnë ... një lot ...

mbyll sytë ... qetësi ... zhdukem  
mbetet vetëm muri i bardhë

UDHËTIMI I FUNDIT

Elefantët e plakur vdesin në vetmi  
duke u çapitur ngadalë shkojnë  
në udhëtimin e fundit,  
po, në këmbë, të vetëm  
sepse bota e tyre shembet  
ngjitemi dhe rrëzohemi duke rrëshqitur  
me rrjedhën  
ndonjëherë mjafton të thuash një fjalë  
– por nuk ka kthim -  
“urat kanë qënë të djegura dhe askush  
nuk është kthyer më”  
për çdo zgjedhje duhet të paguani  
kështu që merr me vete monedhën  
për udhëtimin e fundit

DUKE JETUAR

të jetuarit është e gjitha ajo çka më mbetet  
nga shpirti im prej fëmije  
zgjohem duke parë një tjetër diell  
në mengjes më përshëndet  
duke sjellë gjëra të reja që do t'i zbuloj në  
udhëtim  
unë fëmija tashmë e rritur  
do të jem gjithmonë ajo reja e ëndrrave  
eci pse bota rrotullohet  
dhe nëse ndalem një sekondë  
në anën tjetër të hënës  
ku nuk shihet asgjë  
eci sepse dua të shkoj përpara  
sepse të ecësh është lexim dhe shkrim  
me ec është të mësosh për jetën



JOANNA KALINOWSKA

Toka e mirësisë

Cikël me poezi | Solli në shqip Dashamir Malo

Joanna Kalinowska shprehet se ka lindur nën një yll endacak. Leida fëmijë (vajza e një oficeri ushtrie) shpesh lëvizte nga një vend në tjetrin. Këto ndryshime të vazhdueshme i kanë mësuar asajtw jetw e çlirwt dhe mundësinë për të takuar njerëz dhe njohur vende të reja.

Ajo kaloi shumë vite në Poloni. Njëzet vjet më parë u transferua në Itali.  
Ka shkruar poezi qysh në adoleshencë. Tre vëllimet e saj me poezi janë botuar këto vitet e fundit. Shkruan dhe boton në dy gjuhë, polonisht dhe italisht. Libri dygjuhësh “Dëgjimi i kaltër”, është shkruar në mënyrë që njerëzit që flasin gjuhë të ndryshme të shprehin të njëjtat ndjenja. Poezi të saj janë janë publikuar gjithashtu në antologji dhe revista të ndryshme. Poloninë dhe Italinë i konsideron si dy vendlindjet e saj.  
Ka themeluar “Shoqatën Miqtë Itali-Poloni”. Zyra e saj qendrore gjendet në Taranto, qyteti ku jeton dhe punon. Joanna është mësuese me profesion, por aktualisht punon si përkthyes dhe aktiviste në komunitetin polak. Është anëtare e Shoqatës së Përkthyesve Letrarë të Varshavës. Punon edhe për grupin letrar dhe kulturor italian “La Vallisa” si dhe bashkëpunon me revistën e këtij grupi. Ajo është promotore dhe organizatore e aktiviteteve të shumta kulturore dhe sociale.

është të kuptuarit e botës  
sepse ësndrrat gjenden në udhën që  
përshkon  
kur të kem udhëtuar aq mjaftueshëm  
sa për ta patur të mundur të ndalem  
do të kthehem  
do shoh që jam ajo vajza e rritur  
kam udhëtuar brenda gjërave  
brënda gjerave që vertiten rreth meje  
ja pse e di që ata si unë  
ata si ne, kanë një palë krahë  
që i mbartin gjithmonë sipër reve të  
realitetit  
dhe fluturojnë lirisht në atë skaj të qiellit  
ku ëndrrat bëhen të bukura  
dhe mund të preken

TOKA E MIRËSISË

Shtatë dete dhe shtatë male  
shtatë erëra mbi shtatë dete

do të doja të isha një hardhucë  
në verë të thekesha në diell  
qetësisht e veshur me smerald të verdhë  
sesa të isha një varkë e lëshuar në erë

ngjitem në majat e maleve  
për të parë rrugën  
çanta ime e shpinës është leckosur nga era  
për të arritur pikërisht atje

atje ku një diell reflektues  
vërtitet në qiellin e buzëqeshur  
ku gjithçka është e kthjellët  
dhe merr formën e duhur  
ku koha ka shkuar të flerë  
dhe ka vënë në gjumë të gjitha erërat  
prej nga kam ardhur dhe ku do të kthehem

në tokën e mirësisë  
ku në fillim ishte fjala  
GËZIMI I JETËS

Në rrugë kalojnë mjerëz  
secili bart me vete çantën e halleve  
asgjë nuk është e lehtë thonë  
thonë se jeta është e vështirë  
të gjithë janë të dhënë pas lekut  
nuk e shohin shkëlqimin e dritës së diellit  
që reflekton në vitrinat e dyqaneve  
nuk kuptojnë  
pse u buzëqesh kalimtarëve

ÇLIRIM

po, jeta është e vështirë  
dhe ti nuk je në vendin tim  
të mundje të më kuptoje

për një çast  
një dritare është hapur krejt  
për të të lejuar të fluturosh  
të gjitha këto vitet e tua  
të ndryrë brenda

sillem rrotull si flutur  
tretim në blu

nuk ka as të kaluar, as të ardhme

egzistoj vetëm unë  
gjithmonë e më afër yjeve  
pafundësisht e lirë  
e pakufizuar nga asnjë lloj forme  
fitoj krahë  
që të mund të të marr me vete

ME DUAJ, JAM NËNA JOTE

Nuk ka ndonjë fillim dhe asnjë fund  
nuk ka krijim apo shkatërrim të diçkaje,  
ka vetëm forma të ndryshme...  
sipër maleve, në qiell dhe në det  
rrjedh lumi i diellit

kemi falur një jetë plot me gënjeshtra  
plot me fitore boshe  
duke fluturuar shumë pranë flakës  
dhe tani kemi rënë në fatkeqësi

sipër nesh nata e errët dhe vetmia

duke këputur zinxhirët e frikës  
duke ndërruar mënyrën tonë të të parit të  
gjërave  
mund t'i ikim vuajtjes  
toka është e duruar  
e dhembshur dhe e falur

shpëtimi i fundit  
është të krithemi në thellësi të pyjeve  
dhe të thithim ritmin e rrjedhës të rrëkeve  
pëshpëritëse  
derisa gjithçka të bëhet e kristaltë

...për të gjetur shpejt atë që njerëzimi ka  
humbur  
në nxitim e sipër  
para se të mbrini në udhën që nuk ka më  
kthim prapa

të kesh besim tek Toka  
ajo të do, është nëna jote

\*\*\*

pothuaj nuk e kujtoj dot fare atë që kam  
ëndërruar  
kam vetëm mbresa të disa pyjeve  
hijet e reve sipër lëndinës, një pasqyrim  
dielli  
që në liqen lë një fashë të artë drite

uji kishte kundërmimin e halave të pishës

ishim akoma larg, të paditur  
si Eva me Adamin para mëkatimit

vështronim herë pas here njëri - tjetrin  
si dy brigje të një lumi, të ndarë  
e megjithatë më afër mes nesh

HARROJE

Harroje këtë ditë të verës  
befasuar dielli mbi qiellin e Krakovës  
shembëllyer në ditaret e trenit në lëvizje

ha –rro – je, ha –rro – je, ha –rro – je

harro çdo sekondë orë minutë  
ditë javë muaj vite

ha –rro – je, ha –rro – je, ha –rro – je

lotët tronditjet buzëqeshjet  
hapat e parë, rëniet, sukseset

ha –rro – ji, ha –rro – ji, ha –rro – ji

është bajate të thuash  
që shpata nxjerr në treg zemrën  
por s'është asgjë dhe nuk do të jetë njësoj

harroji madje edhe ëndrrat

brenda qivurit të të kuq  
të veshur nga brenda me material të kuq  
dhe të zi  
shkojnë shpresat, ngashërimet dhe  
kujtimet  
janë fishkur marrëzitë dhe asgjë  
s'mund të të sjellë në jetë

ndoshta një ditë do të buzëqesh përsëri  
Demetra me krahë të ulur

TANTRA

ke thënë  
do të mundja të shkruaja për ty një poezi  
të ketë në të nga të gjitha fjalët e dashurisë  
të pashkruara kurrë

por kjo nuk e zëvendëson flladin e pranverës dhe dritën që ke në sy

ne marrim frymë me të njejtin ritëm duke dhuruar dritën në çdo frymëmarrje dashuria jonë është kështu kaq e fortë që për shumë persona nuk ka sens e thelle, e pashpjegueshme vargane, bashkime të shenjta trup dhe shpirt forca jonë është art hyjnor bashkësi e vashdueshme me feminitet dhe mashkulli të gjitha fjalët e shprehura kur bëhen një

shiko, në fund gjithçka është hyjnore

\* \* \*

Zoti buzëqeshi duke krijuar një Tokë të bukur dhe ka qeshur djalli duke manipuluar zemrat e njerëzve dhe për këtë nuk dimë se çfarë të bëjmë, të pezullt, midis bukurisë dhe territ, të mirës dhe të keqes nuk gjenden udhë të drejta, endemi rrugës së gabuar në një shteg shkëmbor pa shenja ajo që dëshirojmë është në pritje diku nëpër ëndrra por nuk dimë si t'i gjejmë ato, ëndrra që duken shumë të largëta mendja e penguar fashit pëshpëritjet e zemrës dhe të pazotë biem në dëshpërim në kërkim të lumturisë, që ia mbath gjithmonë

### PERJETËSI

Do doja të ishe këtu pranë meje për një moment përjetësie për një frymëmarrje, një vështrim përpara se të hedhësh në ajës zemrën time të lodhur lulon në këtë dritë mallëngjyese të pranverës të të prekësh do të thotë spektër në skajin e misterit fshehur brenda në shtatë vello të së vërtetës ngjyrat, parfumi dhe muzika diellore dhe mund të fluturosh si një zog edhe pse je thjesht një iluzion

### MIRËSEVJEN DITË

më vje shumë keq për gjithë personat e mbyllur në kafazin e jetës së përditshme jo të vetëdijshm për të patur krahë

diku në largësi era është duke kaluar mbi ishuj varur në të kaltrën e mjellmët

kur toka u përkiste të gjithëve jotja ishte gjithçka që të rrokte syri dhe sot ti thjesht ke falsifikuar ilizionin e realitetit në një suprinë xhami

ke nënë, babë, nipa, punë detyrimet, rrogat, argëtimet dhe kështu me radhë deri në pështirosje nuk ke kohë për asgjë por koha është vetëm një mënyrë të menduari

mirësevjen ditë oqeani i lumturisë flakërimë e shpresës mos lejo të të mbyllin në kafaz e lirë qysh në regëtimën e parë të natës

# Copa nate që ushqejnë demonët

Ese nga Fatbardh Amursi

Nëse s`do të kishim asnjë të dhënë për autoren e librit me titull “Në anën tjetër të shpirtit”, veç një foto familjare: gjyshja-vajza-mbesat dhe, të na kërkohej të gjenim se cila prej tyre i ka shkruar poezitë, zor se e gjenim autorësinë me të parën, pasi, mungesa e thinjave, rrudhave, nostalgjisë, na çojnë në anën tjetër të moshës. Është shpirti që i zhduk kufijtë e viteve dhe jo se autorja, Tatiana Konomi, nëna e një vajze dhe gjyshja e dy mbesave, trukon me veten, bën “ndërhyrje plastike”, lifti. Më shfaqet vajza e dikurshme, që binte në sy në qytetin tonë të vogël. Është i njohur protagonizmi i të bukurave, të cilat, për kurorë misesh njihnin lulet të kaluara në një fill. Shpesh objekt frymëzimi, kur ky atribut i njihej partisë. Në atë kohë s`kishte selfie, por, në bllokun e shënimeve apo në fletoren e ditarit shfaqej romantizmi i moshës me çudirat e veta. Një bllok të tillë ia rrëmbejnë Tatianës në orën e mësimit. Më shumë se sa intimiteteve të moshës ajo i trëmbej problemeve, që mund t`i hapnin mendimet me rrezik. U desh ndërhyrja dashamirëse e një mësuesi tjetër, që ajo t`i shpëtonte ndonjë telashi të mundshëm. Tatiana edhe tani e ruan të qeshurën e atëhershme, duke mos qenë ndër ato, që e përkëdheli jeta. Nëse do ta njohësh, shikoji dhe anën tjetër të shpirtit, që shpaloset në faqet e librit me poezi. Ftesa për të parë anën tjetër, si të kërkoshe se çfarë fshihet përtej horizontit, përkundër anës tjetër të medaljes, ku pas një heroi mund të fshihet dhe një tradhëtar. Është pikërisht kjo ana tjetër, që zgjon interes, ndoshta dhe arsyeja pse ajo boton një libër, që, për shumë kënd: mund të duket i vonuar. Nuk ka për qëllim të fitojë kohën e humbur, por për të mos humbur atë që ka mbajtur gjallë ndër vite përmes vargjeve, shpirtin poetik. Mos kujto se e ke të lehtë për të kaluar në anën tjetër të shpirtit, nëse lexon vargje si këto: “Në kujtimet e mia s`ka rrugë./Hapat shkulen me zor./Si në muze ku të gjitha veprat u vodhën.” Nuk është se po t`i bllokun rrugët, apo të ankohet se ia kanë vjedhur stolitë e shpirtit, por, të shtyn të kuptosh midis rreshtave, që një zonje i takon t`i thotë me takt. Ndjenjat e mëdha s`janë për ata, që, nuk rrezikojnë, që i përtojnë aventurës alla Magelan. Është fjala për eksploruesin dhe jo për aventurierin,

për atë që do të dije se ç`ndodh në anën tjetër të shpirtit.

A duhet ta besojmë autoren kur shkruan se: “Thua se na kanë lindur perënditë,/kur ato ndjejnë vetmi.”? E thotë shumë nga që i referohet perëndive antike greke, se zoti është vetëm një. Zoti duke qenë i vetëm është dhe i vetmuar. Në letërsinë antike është i njohur flirti i qiellorëve me tokësorët. Për të larguar vetminë, Zeusi, pasi vinte në gjumë të shoqen, Herën, zbriste në tokë, shpesh në formën e kalit dhe bënte dashuri, bie fjala me Helenën, si më e hedhura ndër shoqet, së cilës i dukej si Paridi dhe, duke larguar vetminë hyjnizonte botën njerëzore. Nëse zotat ia dalin ta largojnë vetminë, heroina e poezisë ngre zërin në kupë të qiellit, që ta dëgjojnë dhe zotat lart: “Lërmë dhe një çikë të uluras,/Përpara se të mbytem në vetmi.” Pra, në “vrimën e zezë” të vetmisë. Kur një vajzë e qeshur ulëret, të ka treguar dhe anën tjetër të shpirtit. Jo me ndihmën e perëndisë, por të poezisë së saj, që dallohet për sinqeritet dhe një figuracion, që i jep fuqi ndikuese fjalës. Merreni dhe si një rrëfim para vajzës dhe mbesave.

Por, dhe brenga e heroinës së poezisë nuk ndryshon shumë nga ajo e hyjve: “Ku të të mbaj, o jetë,/Këtu ka veç shkretëtirë?!", ngaqë çdo gjë që të mbjellësh të shkon dëm. Ke frikë të ushqesh dikë me dashuri se të kthehet në vuajtje. Në brigjet Joniane nuk gjen djerina e jo më shkretëtira, po ku duhet ta kërkojmë shkretimin? “Mërgo larg brigjeve të vështrimeve,/Aty ku mbyten vështrimeve të botës, poeti popullor gjen shpetim në “mesin e pyllit ku bota s`i sheh”, ndërsa heroina e poezisë kërkon t`i largohet rrezikut në kërkim të një realiteti ku s`ndodh asgjë. Është më mirë, kur ikën vetë se sa kur të përzënë. Dhe vjen një pyetje, që përgjigjen s`u takon ta japin prindërit. “Ku janë pranverat/Që më premtove, baba?” Në anën tjetër të pranverës është dimri. “Në qerpiqë pishash qan dimri”. I drejtohet babait dhe jo nënës, se ai e kishte njollën në biografi, atë “copë nate” që ushqente demonët e regjimit, por që taksën e pagoi vajza e qeshur. “Nata gëlltit mendimet e fundit për ty./Dhe pështyn yje.” Vargje të ndeshur rrallë këto, krejt në kontrast me demonët që ushqehen me copa nate, pasi

një natë erotike mund ta kthejë zjarrllëkun e çastit, kur ngjizet jeta, në yje. Po demonit, keqbërësit, a i duhet vënë emër?

U ngula gozhdë në murin e zemërimit, Duke ushqyer mërinë e verbër Me gjakun e lëndimeve të mia. Ndërsa shqyeja më thellë plagët Për t`i gjetur një emër “Hasmit” të jetës time.

Sa e sa vriten pa e ditur se kush i vret, është një nga thëniet e shkrimtares ruso-amerikane Ayn Rand, që unë e përsëris shpesh, përherë deri në mërzi, pasi, në të gjitha rastet i shërben kontekstit ku e përdor. Ndoshta ngaqë dhe unë s`po e gjej dot “hasmin” e jetës sime? Arsyeja e mosgjetjes së “hasmit” e bën autoren të shpërthejë në indinjatë:

Dikur më trëmbi fluturimi, Tani e di-nga burgu, shpirti im s`doli kurrë.

Se duart që godisnin Gjer në poshtërim, qenë të vërteta. Nuk është e lehtë të përballesh me një realitet, që të ka ndëshkuar me privime, duke t`i mbyllur shtigjet e së nesërme. Dhe një nga ndëshkimet që ajo mori nga koha e burgeve, ishte trëmbja për të fluturuar, për të ndjekur ëndrrat e moshës. Pak njerëz ngjiten në këtë botë pa nevojën e një tjetri, pa një dorë të zgjatur. “Ne që u rritëm me qiellin në sy/...lakmuam gjithmonë fluturimin.” Por, në anë tjetër të shpirtit nëse shfaqet interesi, nëse ia beh më parë i rëndomti dhe jo dashamirësi, dëshira për fluturim mund të çojë gabimisht në anën e padëshiruar, atë të gjunjëzimit para fatit. Në këtë mëdyshje na duhet pohimi i saj. Dhe ajo shkruan vargjet: “Unë krahët i kisha/Ti më kujtove/Sa i bukur/Është fluturimi.”

Shihni se ç`intensitet emocional krijojnë këto vargje drithërues, dalë nga një zemër e plagosur, por që nuk i dorëzohet dëshpërimit: “Shira pendese nga qiejt e mallit mos prit./Tempullin ku fjeta me ty, braktise!” Përfytyroni një tempull, që braktiset nga ata që ishin bashkë në të, duke marrë ndoshta dhe bekimin e zotave dhe, nga qiejt e mallit s`bien shira pendese! Se tempullin s`e përlyen pafajsia e dëshirave, veçse vesi i delirëve: “Ku të gjitha ngjyrat hazdisen,/Diku ende sëmbon/Zhgënjimi i parë.” Zhgënjimi i parë ngjan me ilaçet që kanë efekte prapavepruese. “Sytë e tu që kërkonin me ngulm/Një gënjeshtër të fortë.” Por, nëse: “Qielli i mëngjesit sytë e tua merr hua”, paralajmërohet një stinë tjetër ndjenjash, natyrisht pozitive. Ja pse duhet parë dhe ana tjetër e shpirtit. “Ka më shumë se një rrugë/Për të arritur tek vetja.”-shkruan ajo dhe, nëse ti i ndjek këto rrugë që të shpjen në anën tjetër të shpirtit, arrin të skicosh karakterin poetik të autores. Dhe në fund të udhëtimit: “S`mbeti më gjë për të bërë,/I bukur qe veç ëndërrimi”, i cili plotësohet duke kaluar në anën tjetër, ku shtrihet jeta e autores.

Kundrejt mësuesit, që i mori bllokun dhe mund t`i hapte telashe dhe u gjend një i dytë ta shpëtonte, duke u alternuar keqbërësi dhe dashamirësi në jetët tona, rasti e solli, që libri me poezi i Tatiana Konomit të bënte rrugë deri sa të vinte tek unë me një autograf ku shkruhej: “Për Bardhin”. Nuk e përmenda më kot historinë e dëgjuar për Bllokun e intimiteteve, sigurisht edhe me poezi, që shkollarja s`deshte t`ia lexonte kush, tani ajo boton një libër, duke dashur që ta lexojnë të gjithë. Një libër, ku dhe në ato vargje që citova, ma do mendje se gjendet e gjithë jeta e saj. Dhe jo vetëm e saja. Duke shkruar për librin e Tatiana Konomit, nuk dua të marr pozitën e një bamirësi, përderisa nuk jam ai që i mësova artin e fluturimit, në kohën kur të shkulinin krahët, apo t`i këpusnin ato. Qyteti i ka një borxh poeteshës që prej vitesh të tëra i mbeti harrimit, e kam fjalën për rrugët e mbyllura të shkollës së lartë, përderisa ajo shkëlqente në shkollë dhe këtë borxh mora përsipër ta shlyej unë në emër të Pegasit.



Është një mur tashmë që ka emrin e Visar Zhitit në një qytet në Itali, në Salerno. Pse, si ndodhi, ku pikërisht? Mos ndokush që kaloi andej, nxori ngjyrat që mund të ketë patur me vete, spërkati murin, la një grafiti dhe iku? Po e rrëfej se si është.

Në fillim dy fjalë për Salernon e bukur, gjendet në jug të Italisë, në bregun perëndimor të Gjirit me të njëjtin emër, në Kampania, rreth 50 km larg Napolit. Edhe Salerno njihet për peizazhet e tij mesdhetare, të mrekullueshme, për kulturën dhe historinë që në kohët e perandorisë romake. Aty është themeluar Shkolla Salernitana, më e vjetra në Europë.

Qyteti sheh me fytyrën nga deti Tirren, i kaltër dhe i thellë, që duket sikur sjell me dallgët dhe erërat rrëfime të lashta, këngë të marinarëve mesdhetarë dhe frymë dashurie që ngjiten në rrugicat e ngushta e në muret e vjetra.

Këtu do të ndalim. Sa shumë poezi ka nëpër ato mure, vargje dhe ngjyra gjithkund. Është një projekt magjepsës i qytetit, - do të thosha, - i mbështetur nga Fondacioni “Alfonso Gatti”, i poetit të tyre, ndër më të rëndësishmit në poezinë italiane të shekullit XX, zë kryesor i hermetizmitI dhe projekti quhet “Muri d’Autore” 2025, Mure autorësh 2025, një bashkëjetesë mes artit urban dhe poezisë.

Muret e qytetit janë shndërruar në faqe librash të hapura. Poezia është bërë pjesë e jetës së përditshme. Ti ecën rrugëve dhe rrugicave të Salernos dhe lexon poezi mureve, duke u krijuar kështu një dialog mes fjalës dhe figurës, kujtesës dhe së tashmes.

Mure që flasin. Na kujton ato grafitet spontane, me bojëra të shpejta dhe të trazuara, shenja anonime si e folura me ngut, fryma e rrugës, një klithmë rinore si nga instinkti, nga protesta, nga dashuria e fshehur që do të shpërthejë mbi gurë, një energji e lirë, e pasistemuar, që shpesh përpiqet të lërë gjurmë në një botë ku gjithçka fshihet shpejt.

Po diçka duhet ruajtur.

Dhe doli nisma “Muri d’Autore 2025”. Një komitet i përbërë nga poetë, artistë dhe anëtarë të Fondacionit, duke u bazuar në rëndësinë e veprave dhe lidhjeve të mundshme me qytetin e Salernos bën përzgjedhjen. Poetë si Ungaretti e Montale dhe patjetër shoku i tyre Alfonso Gatto, por dhe Alda Merini, Italo Calvino, Nazım Hikmet, Pier Paolo Pasolini, Pablo Neruda, Pino Daniele, Francesco De Gregori dhe Rocco Hunt, etj, janë aty për të pasqyruar tematika universale si dashuria, natyra, identiteti dhe kujtimet, duke i dhënë një dimension të ri hapësirave urbane. Kështu, qyteti shndërrohet në një ekspozitë të hapur. Çdo kalimtar bëhet lexues. Çdo mur një poezi. Lagjia – antologji...

Është piktori me emër arti *Pinogreen*, që e sheh kudo me furça dhe penelë e kovat me bojëra, ndanë muresh, skelave, shkallëve, më gjunjë, i shtrirë, që punon pa u ndalur, i njohur tashmë për stilin e tij unik dhe teknikën e pikturës me letra dhe ngjyra të forta, të ndritshme për të krijuar kompozita që bashkojnë tekstin poetik me elemente vizuale të natyrës dhe jetës së përditshme. Një shembull i veçantë është murali “Occhiveri”, i realizuar me përdorimin e qelqit të ricikluar, që pasqyron angazhimin për mjedisin dhe bukurinë e thjeshtë të jetës.

Ai vizaton vargjet duke krijuar një lidhje të ngushtë mes fjalës dhe vizualitetit. që kanë pasuruar jetën artistike të qytetit. Poezia në Salerno ka dalë nga faqet e librave dhe është shndërruar në një pjesë të gjallë të peizazhit urban. E mbetur përherë mureve...

# NJË MUR PËR POEZINË DHE NJË POEZI PËR MURIN...

Nga Eda Zhiti

## MURI I VISARIT

Në qendrën historike të Salernos në “Rione Fornelle” është Muri i Visar Zhitit. Aty kanë qenë shkruar vargjet e tij

*Ty prapë  
të erdhi koha të mendosh,  
o zemër!*

Në italisht:

*E daccapo  
e’ giunta l’epoca di pensare  
o cuore!*

Gjendet në librat me poezi të Visarit, të botuara në Itali, dy gjuhësh, shqip dhe italisht, të përkthyer mjeshtërisht nga Prof. Elio Miracco, “Confessione senza altari”/ “Rrëfim pa altare”, “Diana Edizioni” 2012 dhe në “Strade che scorrono dalle mie mani”/ Rugë që rrjedhin nga duart e mia”, botuar vitin që shkoi, në 2024 nga “puntoacapo” dhe libri mori çmimin e njohur për poezi “Camaioire”.

Nga një perspektivë letrare, ky varg i Zhitit pasqyron një gjuhë të thjeshtë por të fuqishme, ku emocionet e mëdha përshkohen me një intensitet të përmbledhur. Aty bashkohen elegancën poetike me një angazhim qytetar dhe artistic, sipas kritikëve, një manifestim i së bukurës që del jashtë librit dhe bëhet pjesë e përditshmërisë urbane.

Poezia në mur herën e parë kishte formën e një dallge, me shkronjat e dorës me zbukurime lulësh, gjethe e arabeska.

Kur ngjisje shkallët e asaj shtëpie në Salerno, vargjet e Visari përballë kangjelave të hekurta të dukej sikur donin të çonin dhe më lart.

Tani është shkruar me të kuqe si gjaku dhe poezia ka formën e zemrës.

Stilistikisht përdorimi i harqeve dhe vijave të rrjedhshme të shkronjave krijojnë një ndjesi pulsimi dhe pasioni, duke i dhënë vargut një energji vizuale që harmonizohet me temën e zemrës dhe të mendimit me zemër.

Në sfond, dritat dhe hijet e shkallëve dhe bimët e vendosura shtojnë një ndjesi intime dhe mikpritëse, aq karakteristike në lagjet e brendshme italiane.



Zemra e vizatuar me vargun e Visar Zhitit, rreh në të njëjtën kohë me rrahjen e detit mbi breg. Është si të thuash: poezia dhe deti janë dy gjuhë të ndryshme të së njëjtës ndjesi, njëra shkruhet me fjalë e ngjyra, tjetra me ujë dhe shkumë.

Valët sjellin e marrin njerëz, kujtime, mall dhe plagë. Në këtë kuptim, poezia e Visar Zhitit merr një rezonancë të veçantë mbi murin e qytetit mesdhetar: ajo bëhet një zë i mërgimit, por edhe i kthimit përmes artit.

Zemra e vizatuar me vargun brenda dhe me emrin Visar Zhiti në anë si kapilar:e të kuq, është shenjë dhe lidhje dashurie, që rreh njëkohësisht në dy vende, në atdhe dhe ku mund të ndodhet nëpër botë. . Për kalimtarin e zakonshëm zemra është një kujtesë e thellë e copëtimit dhe e bashkimit të brendshëm, një “homeland” që bartet brenda vetes.

Poezia muret i bën të ndjejnë, ndërsa muret e zemrave t’i mbushë me mendim. Po edhe mendimi ka gjak...

Mure e Salernos duket kështu sikur kanë zemër dhe e kthejnë poezinë në një regëtimë që nuk njeh kohë.

## DHE NJË POEZI PËR VISARIN

Prapë në një tjetër mur, por në atë të FB. Një poer amerikan ka shkruar një poezi për Visarun. Na erdhi si një befasi e bukur dhe emocionuese,

Është Jeff Weddle,

. Gjej që është autor i disa librave me poezi e fitues i çmimeve të ndryshme letrare. Jeton në Tuscaloosa - Alabama në SHBA dhe jep mësim në Departamentin e studimeve të Bibliotekave dhe Informacionit në Universitetin e Alabamës.

Nuk jane takuar ndonjëherë e as nuk njiheshin me njëri tjetrin. Poezi u bë shkak. Ajo ka rrugët e veta të mistershme, nuk njeh kufij, siç dhe thuhet dhe vjen një ditë sikur hakmerret për pengesat e mëparshme nga të tjerë e miqtë e rremë.

Një ditë poeti amerikan lexoi librin me poezi të Visarit “The condemned apple”, - kështu del, - i botuar këtë vit në SHBA nga “Green Integer”. Ia kishte dhuruar një mikja e tij amerikane. Dhe ai, teksa priste në një



servis makinash, lexonte Visarin.

Nëse makinës i duhen ndërruar vaji e rrotat, edhe njeriu ka nevojë për një vaj tjetër, atë shpirtër, i duhet makina, por edhe flatra ëndrrë dhe ato t’i jep poezia.

Dhe ai shkroi një poezi, kushtuar Visarit. Tipike amerikane me duket, e sotme, me të përditshmen që të rrëmben e të mërzit shpesh, hekura, angazhime dhe ndaj tyre, por është: libri që mbron, tempull i mendjes dhe i zemrës. Poezia pra...

Dhe e përktheva:

## ME VISAR ZHITIN NË SERVISIN E TOYOTËS

Nga Jeff Weddle

Duke ndenjur në sallonin e konçesionarit së makinave, pres që ekipi të mbarojë ndërrimin e vajit dhe të gomave.

Vende të tilla se si më përthajnë, por dua t’u jem mirënjohës, se sdo të mundja ta bëja vetë atë që këta njerëz bëjnë për mua. Për fat, kam poezitë e Visar Zhitit, që flet hapur, më bën shoqëri.

Bukur është të mendoj që edhe Zhiti ndërkaq po lexon poezitë e mia diku, por pak gjasa ka, edhe pse përpiqem të them dhe unë aq drejt siç ndoshta do t’i pëlqente dhe atij. Zhiti është shoqëri e mirë, ndërsa shokë të tjerë që di, mbeten si pengje në heshtje me telefonat e tyre, ndërsa poezitë e tij e bëjnë orën të ecë më shpejt.

Së shpejti do t’i kthehem sërish kësaj bote, ku zogjtë fluturojnë, insektet ndërrehen dhe fëmijët humbasin nëpër shkollat që prej kohësh kanë hequr dorë nga mësimi i çdo gjëje të rëndësishme.

Visar Zhiti do të bëjë ato që bën.

Toka do të thahet në Tuscaloosa pas këtij shiu të beftë.

Chicago, shtator 2025



diku fryn në udhëkryqet e botës

me një palë flokë prej dëborës së detit  
u ngjita malit guaskë e stërmadhe  
në krahë mbaja të lidhur  
një fjongo prej jodi  
t'i fashoja plagët nga hapat e mi

nga ku s'e pikas dot një këngë myezini  
tregon se edhe zoti diku rron

dhe s'ndalem të ngjitem si të ngjaja altar i flatruar  
me veten ngre miliona pikëpyetje aq sa miliona  
hapa

lodhja lëkundet si një flakë qiriri që shtrihet  
në sipërfaqen e tavolinës sime të poezisë  
dhe sheh si tretemi të dy

s'ndalem të ngjitem në atë mal prej guaske  
gjigande  
diku në udhëkryqet e asaj bote fryjnë erërat e  
serta  
që ballin ma ftohin edhe mua  
edhe ty poezia ime vetmitare

detit andrrën

vajzërore bardhësia shkurmë  
fjongëzohet flokëzave të tij

thellësinë ndrin deri në rënie të yjeve

detit andrrën jo peng  
ditë të re zgjuar n'breg  
jeta mbet ajo si vikamë

e lashtë kjo andërr vajzuke  
n'tokën e lirë të detit e atme

e mandej ulem gjunjazi fëmijërore  
një grusht rërë flladi shndërron hi

ndërsa andrrën e detit e fsheh si kollën  
e mesnatës të rrijë heshturake në poezi

kompozitë e dhembjes  
ose një shkartisje rimash

në ajrin tënd edhe krishtin e kryqëzuan dhe  
s'patën dhembje për të  
edhe ajrin e kryqëzuan

në pengun tënd e rritën një rrënjë krizantemë  
s'pat dhembje të shkulej si eshtër luftëtarësh

atje në zemërimin tënd e ngroh një lot timin  
me të rris varg që të mbetet përjetë  
në vegjëli u ngjiza rimëçartur

në shtratin tënd e fsheh dashurinë det  
atë që s'duket dhe përhumbet dallgëve  
atë që në ajrin tënd kutërbon dhembje

atje në portat e tua shkruaj këto vargje  
rrëmbej një trastë nga hëna të të gostit me yje  
se dhembja prej teje më bën një gjysmë njeriu  
dhe në ajrin e dhomës sime bluaj melhemin  
tënd

Itaka më pret

në agun e një prag-vjeshte  
vajakënga e një bilbili  
mëmësi hap krahët

ag-nënshtirim-nën-shtrat  
zoti s'mund ta falë detin  
madhësthtinë sakrilegj  
përjetësia si mbi kokat tona merimangat  
thurin të përditshmen

ki mëshirë hyj mëshiroma dashurinë  
hapurkrahë Itaka më pret

I harruari detërave

pllaqurisin duart dallgët  
netëve bëhet se ngjizen  
kuajt e Patroklit  
ky det mbrëmësor  
më fal trishtim e var krahut  
një pishe që zbardh gjoks  
në odën prej uji



REIF. HODO

Kënga e Qefalonisë

Cikël me poezi

në mes t'tryezës tënde është qiriri i fatit  
mban ende gishtërinjtë që rrojnë nimfë

kjo hënë mbrëmësore këtu n'ishullin e fshehur  
prej erërave  
zbardhet si shtrati i harresës  
i harruari detërave mbledh eshtra kujtimesh  
i harruari i detërave eh ç'ngazëllim  
të presësh të shohësh një trastë  
që të grumbullojë eshtrat e Tua

në mes t'tryezës tënde është qiriri i fatit  
far dhembshurak

në shtigje humbas bashkë me errësirën  
të lakmoj veten apo madhësthtinë e detit

i harruari detërave që erërat  
i trazon në gjumin e mesnatës besnike  
pret të dëgjojë edhe një herë kuajt e Patroklit

unë qeshë në Itakë

dhe agu zbardhte si ditët që flenë e zgjohen  
me rregullin e njerëzve  
mbjell luspa erëmirë mbi kokat tona guaska  
udhës i hedh krahëve një petk dielli me rërë

e ndërsa hiqnim udhë diç të pëshpëritën jugat  
tek ty rrija si mbi supet e tim eti kërthi  
zemërimi rrëmbimthi ta fshehu buzëndritjen  
në pupilat e tij bënte mot trazimtar e aty  
aty mu trishtove det hodhe mbi mua  
zemërimin dallgë  
s'kish si të ish pjella para frymës atërore  
e mandej bie skena e parë

në ato hapësira ku njerëzishëm qarkullonte  
koha  
angushti e sertë m'tret frymëmarrjen  
ngushëlluese  
më shfaqen para syve rripa toke të zhveshur  
më bëhen si kariatidet e lashtësisë

ama në Itakë zemra iu thye si të qe përzhitur  
edhe para njëmijë vjetëve  
te këmbët më holli miliona rrjeta të thururua  
qetësi

i rrëfeva diç se si ajo pëlhurë jam shndërruar  
si prej asaj që i jep jetë  
kam rendur në supet e një pegasi  
prej ranoreve të Adriatikut për të parë në sy

e trazimi si të mos qe lindur u bë shpirtmadhësi  
tek ati u rikthye i biri  
hyra në të si atëherë në pije  
në motin e dashurisë a të bie ndërmend

dhe furishëm një rremë të sertë ia lashë tek  
pragu  
e mandej bie skena e dytë

sytë s'më mbeteshin duke të gjetur duke të  
humbur  
ati është një kalë i hazdisur që s'mban kapistall  
veç era në ia dënoftë jelet  
m'u shfaqe ashtu përbindshëm këmbym duart  
e ndërsa në të ikur më hodhe dy eshtra kujtim  
në prapun e asaj traste ku zhvisheshin në ephs  
vargje  
i përhimtë m'u zhduke mandej e fjalën të ta  
ktheja s'bëhej punë

të mund të lundroja tallazeve me një tibia prej  
teje  
të mund të shkarravisja vargje duke parë si  
luhatet  
në anën tjetër një klavikul hijeshore  
e mandej bie skena e tretë

por përsëri një peng më rron ende në kraharos  
si Itakën të pres vetveten  
një pëlhurë që endet me pe prej erërave të jugut

kënga e Qefalonisë

përtej të gjithëve aty më priste shën Gjasimi  
të vetmet eshtra që frymonin ende si jetën  
ta kishin ndër duar pafundësisht

asgjë s'mbetej pas atyre syve të mëdhenj plot  
dritë

dhe zbres në tokën e tij si të gëzoja se kish  
lindur Odiseu  
me një djep ku përkund vargje të lidhura me  
shamia të bardha

dhe zbres në trupin tënd prej shenjtorësh  
e mbështjell djepin e rëndë me flokë dallgësh  
të kripura  
mbi hi fshattrash të djegur eci me këmbët  
ranosur në këtë tokë  
ku puthja dhe dashuria në hijen e Shën  
Gjasimit  
është më i thelli rrëfim se ç'do predikim i ditëve  
të qeta

oh e shenjtë Qefaloni ti trup i dritës dhe epshit  
që shpirti të dremit në barkun e një gruaje  
lagur nga nata  
shtrihesh mbi gurët e ftohtë të manastirëve  
ndërsa pret  
pret në tokën ku edhe dhembja zgjohet një  
lutje

ku erosi shkruan një ungjill të tijin  
dhe psherëtin si edhe Penelopa për një çast

oh Odiseu im  
ç'kanë ikonat të na vështrojnë me gjykim  
ti i kthyeri i betejave të lëvduara  
ti i thyeri i luftës mes trupit dhe shpirtit  
që të pres me kofshët e hapura si udhët e Itakës  
edhe psherëtin si edhe Penelopa e për një tjetër  
çast

por unë strukem edhe më në brigjet e tua  
Qefalonia

si hëna ndoshta as-shumë nuk pashë  
yjet dallova të skuqen prej turpit xheloz  
thellë të rrëmbeu në barkun e saj Penelopa si ti  
Itakën Odise

gjithçka qe vetëm ringjallje  
rrëshket si shi i profetëve shkretëtirave  
dora e tij mbi gjinjtë altarë zjarrosur  
dhe në tempullin e saj mbërrin si ritmi i detit  
që brigje thyen

ah zbulesë e re lëkundje e kurmit si e një  
oktapodi në agoni

dhe më tej unë rri të përshkruaj ç'ka ndodh në  
dhomën e ikonave  
sikur të qenë hapur portat e parajsës

gjithë ç'ka u bë qe një ungjill i ri  
shkruar me bërryla që nguleshin gurëve  
lotët e një kënaqësie të zhveshur  
dhe me çdo shtytje që bëhej një psalm i gjuhës  
së lashtë

Fjalët

rreshkur - na janë - fjalët  
rrëshirë e rënë këmbëve të një pishe plakë

rënë atje në frymëdhënien e fundit të ditës  
se pengu i fjalës rëndon si një aureolë

në fillim lexova diku se fjala kish vdekur  
në kallje tretur jetime mbetur  
andaj e fsheha n'perëndorinë e njomësisë  
se moti qe sertësi për të gjallët

fishkur - na janë - fjalët  
guralecë ndenjur këmbëve të pathënësisë

në tavernat e peshkatarëve

në to trokita si të isha një  
luspë gjigande  
një peshk budalla trupeshk  
që shkoja i gëzuar në trekëmbëshin e tyre prej  
greti

në taverna të peshkatarëve  
edhe vargjet ranë në rrjeta  
në grep mbeti  
edhe ai i heshturi i tavernave  
trupeshku poeti

një legjende krahë t'i fal

në udhë më fliste fjala  
legjendat s'rrojnë veç pa detarë  
mbi rrema dashuronte vala  
dhe detarët  
sqenë veçse të marrë  
legjendat s'rrojnë pa valë e detarë

prag ag...

në ç'vetmi të bind veten të fle në një Itakë  
metaforën e qullur nga lotët -shi- të qiellit  
ta vjetëroj nënkresë kryeve të mi

në gji të brigjeve të vallëzoi hijen rrënuar  
vargje sa mijëra mbetur në luspa peshqish  
në prag t'agut shfaqet nj'kopsht trishtilash  
flladin ia lë si apoteozë në ballin e rrudhur  
rimën gjifyrë e tret e një dallgë rreckamane  
ajme ku shkretohen itakat  
atje n'portën e dhimbjes të mbështes duart  
si pragje t'poezive ku ngazëllehët frymëzim  
ta plak dhembjen nënkresë syve të mi

Ka libra që i lexon shpejt, i mbyll dhe i vendos në raft, por ka edhe nga ata që bëhen pjesë e jotja dhe nuk mbarojnë me faqen e fundit. Romani i Jente Posthuma-s, “Çfarë do të doja të mos e mendoja” është një nga këta të fundit. Nuk është një libër që e lexon vetëm me sy, por e ndien në lëkurë, të ngulitet në zemër dhe të fton në një proces të dhimbshëm, por edhe shërues, të përballjes me humbjen.

### Marrëdhënia vëlla-motër, një lidhje e pathyeshme dhe e pashpjegueshme

Në qendër të romanit nuk ka asgjë të jashtëzakonshme dhe të padëgjuar më parë: një grua që humb binjakun e saj; jo vetëm vëllanë, por njeriun që i jepte formë identitetit të saj, gjysmën e pasqyrës ku ajo shihte veten. Një lidhje që nuk ndjek logjikën e zakonshme të dashurisë, por një përzierje intime mes pasqyrimit, varësisë dhe pavarësisë së pamundur. Ky fakt i thjeshtë, por shkatërrues, bëhet boshti i një rrëfimi që nuk njuh kufij linearë. Nuk kemi asgjë tjetër, përveçse kujtimeve, pengjeve, dilemave që motra vuan pas vdekjes së vëllait shumë të dashur. Posthuma e përshkruan këtë marrëdhënie si një univers të mbyllur më vete, ku dy individë janë gjithmonë të ndërlidhur, edhe përtej kufijve të jetës. Motra nuk e sheh veten si një qenie të plotë pa praninë e vëllait; ai është alfa dhe omega e ekzistencës së saj. Humbja e tij nuk gjen pikëllim edhe pasi ka kaluar kohë, edhe pasi ajo ka nisur një jetë të re në apartamentin e tij, duke krijuar kështu një lloj çarje kozmike në identitetin e saj. Pikërisht ky dimension i veçantë i jep romanit një forcë të papërballueshme emocionale dhe e shndërron humbjen nga një përvojë personale, në një reflektim universal mbi atë që do të thotë të ekzistosh “me tjetrin”.

### Vetëvrastja dhe enigma e zgjedhjes

Një nga shtyllat më të vështira për t'u kapërdirë në roman është vetëvrastja e vëllait, i cili vuante nga depresioni. Nuk jepet një shpjegim i prerë dhe i saktë, sepse ndoshta nuk ka një të tillë. Për të mbijetuar, njeriu përpiqet të gjejë kuptime, kudo që të jetë, por vetëvrastja shpesh lë vetëm boshllëk. Përmes rrëfimit, lexuesi e sheh motrën duke u luhatur mes fajit, inatit, dëshirës për ta kuptuar dhe nevojës për ta lënë misterin të qëndrojë ashtu siç është. Ajo nuk përqendrohet tërësisht te akti i vetëvrastjes, jep elemente tek-tuk të humorit të tij të zi, mendimeve të errëta, luftës me depresionit, detaje të vogla nga dita e qametit, por pikërisht këto pika janë më të fuqishmet e ngjarjes, sepse të fton të mendosh jo vetëm për aktin e kobshëm, por për mënyrën se si shoqëria dhe individët përballen me të: a është një zgjedhje e lirë, një sëmundje e padukshme, një thyerje e padurueshme e shpirtit? Nga ana tjetër, ç'ndodh kur një person i zemrës i jep fund jetës dhe të lë të jetosh me plagën që nuk mbyllet kurrë?

Kujtesa dhe pesha e harresës

Në këtë roman, kujtesa nuk është veç një hapësirë e ëmbël kujtimesh, por një terren i minuar, ku çdo hap mund të sjellë shpërthime emocionale. Për motrën, kujtimet e binjakut janë njëkohësisht strehë dhe kurth. Nga njëra anë janë vendi i vetëm ku ai ekziston ende, ndërsa nga ana tjetër janë pengesa më e madhe për ta ecur përpara. Posthuma na fton të reflektojmë për këtë kontradiktë universale: a e mbajmë të gjallë të dashurin e humbur duke e kujtuar, apo e zhytim veten në një cikël të pafund dhimbjeje? Kujtesa është e copëzuar, e papritur, e çrregullt, pikërisht ashtu siç

Jente Posthuma, “Çfarë do të doja të mos e mendoja”

# Kur kujtimet bëhen plagë dhe shërim – Jente Posthuma

Nga Xhoina Salaj

përjetohet, ku një aromë, një tingull apo një vend i harruar mund të rikthejnë menjëherë një botë të humbur. Po bashkë me kujtesën lind edhe pyetja e frikshme e harresës: çfarë ndodh kur fytyra fillon të zbehet, kur zëri nuk tingëllon më i qartë, kur dhimbja shndërrohet në një lloj qetësie? Këto dilema që Posthuma i shtron në mënyrë të heshtur dhe pa përgjigje të drejtpërdrejtë, e bëjnë romanin një reflektim të mekanizmave njerëzorë të kujtesës dhe harresës, mënyrën se si ndërtojmë identitetin mbi kujtime që nuk mund t'i mbajmë gjithmonë të gjalla.

### Titulli si pasqyrë e dhimbjes

“Çfarë do të doja të mos e mendoja” është një titull që duket i thjeshtë në lexim të parë, por mbart një paradoks të fuqishëm dhe ftues. Ai përmbledh të gjithë romanin në një

fjalë të vetme: dëshirën për t'i ikur dhimbjes dhe pamundësinë për ta shmangur atë. Në titull fshihet edhe loja ironike e pikëllimit: sa më shumë të përpiqesh të mos mendosh për humbjen, aq më e pranishme bëhet ajo. Është një frazë e përditshme, gati naive, por e mbushur me peshë filozofike, sepse flet për natyrën e vetë kujtesës njerëzore; mendimet që duam t'i largojmë janë pikërisht ato që na përndjekin më fort. Titulli merr formën e një pasqyre të brishtësisë njerëzore: nuk të ofron zgjidhje, nuk premtton harresë, por thjesht pranon ekzistencën e një dhimbjeje që nuk ndalemi së mbajturi me vete.

### Zëri i rrëfimit dhe ironia e hidhur

Një nga pikat më të forta të librit është gjuha: një zë i drejtpërdrejtë, shpesh i



zhveshur, herë-herë ironik deri në cinizëm. Posthuma përdor një stil të dyfishtë: herë të ftohtë dhe të qartë si një raport klinik, e herë të brishtë, të ngrohtë dhe të përmalluar, si një kujtim që nuk gjen dot strehë. Kjo luhetje i jep zë të gjitha fazave të pikëllimit, që nga mpirja, deri te dhimbja e zhveshur dhe dëshira për t'u rikthyer në një normalitet, që zor se e gjen më. Ajo nuk bën moral e nuk ofron receta të gatshme për të përballuar dhimbjen; thjesht rrëfen, dhe në atë rrëfim lexuesi gjen një pasqyrë ku reflekton humbjet dhe frikërat e veta. E shpërfill sentimentalizmin, edhe pse flet për një nga tematikat më emocionale që mund të haset njeriu. Ironia e hidhur e bën tekstin të durueshëm e familjar, duke e balancuar peshën e dhimbjes me një dozë absurdi dhe sarkazmi. Motra nuk fshihet pas klisheve të pikëllimit; përkundrazi ajo e shtron humbjen sa gjerë e gjatë në tryezë, me gjithë papastërtitë dhe thyerjet e saj, duke bërë këdo bashkudhëtar në një proces që është njëkohësisht i dhimbshëm dhe çuditërisht i qartë. Të gjitha këto elemente e shndërrojnë romanin në një përvojë unike letrare, ku dashur pa dashur, para syve të kalojnë të gjitha ato frikëra që nuk do t'i kalosh nëpër mend, por që për fat të keq, herët a vonë do të ta zënë derën.

### Ndërtimi fragmentar dhe kujtesa e copëzuar

Struktura e romanit është krejt ndryshe nga shumica e librave që na bien në duar. Ajo ndërtohet nga fragmente, kujtime, episode të vogla që krijojnë një mozaik të përvojës së pikëllimit. Ky lloj ndërtimi pasqyron mënyrën se si kujtesa funksionon në realitet: nuk është një vijë e drejtë, por një kthim i vazhdueshëm në çaste të veçanta e të ngarkuara emocionalisht. Ajo arrin të ndërthurë episode të përditshmërisë me kujtime intime, duke e bërë rrëfimin të duket njëkohësisht i çrregullt dhe i vërtetë. Ky fragmentarizëm pasqyron pikërisht copëzimin e shpirtit të motrës, e cila mundohet të rindërtojë jetën e saj pa binjakun: një jetë që gjithmonë do të mbetet e ndarë në “para” dhe “pas”. Mendimet për dikë që ka ndërruar jetë gjithmonë vijnë kuturu, të ngatërruara, herë të lumtura, e herë të trishta, herë si kujtime të veçanta, e herë si thika që shkojnë gjer në kockë, ndaj gjetja e autores për ta sjellë këtë proces pikëllimi pikërisht në këtë formë, e bën edhe më kuptimplotë e shpresëdhënëse për dikë që gjendet në rrethana të njëjta, si një afirmim që nuk po “e tepron” me vuajtjen e vet.

### Përvoja universale e pikëllimit

Edhe pse libri vjen si një histori shumë intime, ai sërish ngrihet në një nivel universal. Çdokush që ka humbur një të dashur do të gjejë veten në këtë vorbull.

## JENTE POSTHUMA

Libër finalist i Booker Prize International 2024



Çfarë do të doja të mos e mendoja

Onufri



Posthuma arrin ta përshkruajë pikëllimin si një gjendje ekzistenciale, jo vetëm emocionale: një ndryshim në mënyrën se si sheh botën, në mënyrën se si e ndien kohën, apo raportin me kujtimet.

Leximi i këtij libri është një proces i dyfishtë: dhimbje dhe çlirim, plagë dhe shërim. Ai të fut në mendjen e një të mbijetuar që jeton pa gjysmën e vet, por njëkohësisht të kthen drejt vetes. Ndalesh, kujton humbjet e tua, ose përgatitesh për ato që i druheni të gjithëve. Sepse ky është edhe thelbi i romanit: të kujton se një ditë, qoftë e afërt apo e largët, të gjithë do të përballemi me boshllëkun e atyre që duam.

Edhe pse e pakët në fjalë, Posthuma arrin të thotë diçka thelbësore: brishtësia nuk është dështim, por shenjë e pastër e të qenit njeri. Përmes kujtimeve, pengjeve dhe dhimbjes së një gruaje, na fton të pranojmë se dashuria dhe humbja janë dy anë të së njëjtës monedhë: *grief is the price we pay for love*.

Ky roman nuk është një histori intime për humbjen e binjakut, por një meditim për vetë natyrën e pikëllimit dhe mënyrën se si ai ndërtohet në gjuhë, në kujtesë, në frymëmarrje. Është një libër që nuk të jep luksin e distancës, por të kap dorën dhe të çon drejt vendeve më të errëta e më të ndriçuara të shpirtit njerëzor. Një përvojë letrare e pazakontë, që nuk mbaron me faqen e fundit.

### Pse ky roman për zinë është ndryshe nga të tjerët

Unë harxhoja gjithë ato orë duke pritur në apartamentin e tim vëllai. Jo për të - të vdekurit nuk është se thjesht shfaqen, ato nuk

janë të vërtetë, vetëm vdekja është - por për çastin kur jeta ime do të vazhdonte serish. Në *"Kur gratë janë mikesha"*, dramë nga Hannah van Wieringen, njëra prej dy personazheve thotë se nuk ka mjaftueshëm histori se si t'ia dalësh ta vazhdosh pas një vdekjeje. Për shembull, di gjithçka rreth mënyrës se si një nënë mund te vrasë fëmijën e saj, thotë ajo, por asgjë se çfarë ndodh pastaj, me fjalë të tjera, se si vijon jeta, se si njerëzit ia dalin ta tejkalojnë së bashku këtë. Kur ka shumë më shumë gjasa të jete kjo ajo çka përjetojmë. Teknikisht, ka shumë më shume pasdite te martash kur nuk ndodh asgjë. Në jetën e një njeriu, e kam fjalën.

Ky fragment i shkëputur nga libri, na e përplas të vërtetën e vdekjes në fytyrë: si i bëhet me jetën "pa ata"? Njeriu rrëmon në skutat e shpirtit për një forcë të paimagjinueshme dhe ç'është e vërteta, e gjen. Edhe nëse nuk e gjen, do ta nxjerrë nga askundi, sepse nuk ka zgjidhje tjetër. Dhe në çastin kur e pranon, ka raste që e përjeton njësoj si personazhi ynë. Përumbet mes atyre që mund të kishin qenë ndryshe, herë e kujton rrallë, e herë e kujton për mall, një katrahurë emocionesh ku një ditë nuk i ngjan tjetrës. Ndoshta i tillë është procesi i dhimbshëm i pikëllimit, por mund të jemi hasur shpesh me fasada "të fortësh që e kanë hedhur pas". Një plagë e tillë assesi nuk mund të lihet në të shkuarën dhe nëse shmangim gjithë filozofitë e teoritë pozitive, një kalvar i tillë nuk tregon asgjë më shumë përveçse përurimit të dashurisë së motrës ndaj vëllait. Një fjali nga romani "Lumi i vdekur" i Jakov Xoxas shpreh qartë gjithë rrokopujën e romanit: *gurin e rëndë të varrit të vdekurit ia vënë, por i gjalli e mban*.

## DIJA DHE BANIMI NË GJUHË

Nga Erlind Sulko

Në esenë "...poetikisht njeriu banon...", kushtuar Hëlderlini, Hajdegeri shqyrton ndërlidhjen ndërmjet poezisë dhe banimit. Poezia, më shumë se gjithçka, na lejon të banojmë brenda gjuhës. Por ky banim brenda gjuhës nuk është një përsëritje e përdorimit mekanik të saj: kur ne banojmë poetikisht, vetë gjuha flet.

E përmend këtë ese të Hajdegerit, pasi dua të bëj një dallim midis njohjes mekanike të gjuhës dhe banimit në gjuhë. Në një kuptim, banimi në gjuhë është një njohje e gjallë e saj: gjuha si një bashkëudhëtare e njeriut. Gjuha e përdor njeriun, por edhe njeriu e përdor gjuhën: gjuha e udhëzon njeriun të flasë në një mënyrë të caktuar, por edhe njeriu e gdhend gjuhën me këngët e tij. Gjuha të mëson të lëvizësh gjuhën e gojës, por edhe gjuha e gojës drithëron vetë gjuhën me jetë.

Të njohësh gjuhën do të thotë të njohësh për thelbin e saj po aq sa edhe për vetë njohësin: pasi nëse gjuha është, në thelb, një përmbledhje e gjatë rregullash, atëherë edhe njohja e saj është thjesht një kujtesë mekanike e këtyre rregullave. Por nëse gjuha është një botëkuptim, një mënyrë jetese, një mënyrë e lidhjes me gjithçka, atëherë edhe njohja e saj është një zhytje brenda saj, një banim më shumë sesa një përsëritje mekanike e rregullave.

Nëse gjuha është thjesht një listë e gjatë rregullash, atëherë të gjitha sistemet e inteligjencës artificiale e njohin gjuhën më mirë se ne, pasi ato nuk janë gjë tjetër veçse zbatimi i përkryer i rregullave gjuhësore. Në këtë kuptim, shumë njerëz mund të joshen nga mendimi se vetë ChatGPT e njeh gjuhën më mirë se një fshatar që e flet dhe e shkruan mbushur me gabime drejtshkrimore. Por pavarësisht se sa gabime bën fshatari kur flet apo shkruan gjuhën, ka diçka që ai di për të: një mënyrë të banuarit në gjuhë, një liri për t'i zbatuar rregullat e për t'i prishur. Ka një përjetim të gjuhës që ChatGPT dhe të gjitha sistemet e mëvonshme të inteligjencës artificiale nuk mund ta njohin kurrë. Pavarësisht përkryerjes mekanike të inteligjencës artificiale, ekziston diçka e fshehtë, diçka që shkon deri në thelbin e mistershëm të jetës, që ajo kurrë nuk do mund ta prekë.

Sistemet e inteligjencës artificiale mund ta njohin gjuhën, por nuk mund ta jetojnë atë. Kjo mund të duket si një gjë e vogël, por nuk është aspak e tillë, pasi gjuha e inteligjencës është një sistem i mbyllur dhe i ngurtësuar, ndërsa gjuha e njeriut është e gjallë dhe ndryshon vazhdimisht. Një shaka, një këngë, një vajtim mjafton për të ndryshuar tërë gjuhën e njeriut. Por gjuhën e inteligjencës artificiale nuk e ndryshon përjetimi, por programimi i paracaktuar.

Sigurisht e vërteta, si gjithmonë, është një paradoks i mahnitshëm. Ajo nuk gjendet as në njërin, as në tjetrën nga këto dy pikëpamje që duken në kundërshtim me njëra-tjetrën, por në një ngërthim të të dyjave: gjuha është, njëkohësisht, edhe një bashkëveprim mekanik rregullash, edhe një shprehje e lirisë dhe përjetësisë. Pasi, pas mësimit fillestar mekanik të rregullave të gjuhës, papritur vetë gjuha, ashtu si pas mësimit të ngarjes së biçikletës, të jep lirinë të udhëtosh e të përjetosh botën. Njeriu mëson rregullat e gjuhës veç për t'i thyer ato duke shkruar poezi. Por poezia nuk është shkatërrimi i gjuhës, pavarësisht se sa rregulla gjuhësore mund të thyjë: poezia është lulëzimi i saj i epërm dhe i hijshëm – një gonxhe e çelur në kërcellin e gjuhës.

Prandaj inteligenca artificiale nuk mund të shkruajë poezi, pasi njohja e saj për gjuhën është thjesht një përsëritje mekanike, dhe jo një banim në të – jo një përjetim i pafundësisë, një zhytje në botëkuptimin e gjuhës. Gjuha e inteligjencës artificiale është e vdekur, ndërsa gjuha e fshatarit që shkruan plot gabime drejtshkrimore është e gjallë: asgjë nuk e provon më shumë jetën e saj sesa vetë gabimet. Sepse një lule e gjallë mund të rritet edhe në anën e gabuar, por një lule artificiale, sado e përkryer të jetë, qëndron vetëm aty ku është vendosur.



Miti i Orfeut dhe i Euridikës është një tregim i lashtë që ka marrë, në kohë, forma të ndryshme letrare: është treguar nga Virgjili te “Gjeorgjikat” dhe në vazhdim është rimarrë nga Ovidi te “Metamorfozat”. E shohim më në detaje historinë në variantin e saj, analogjitë dhe diferencat mes versionit ovidian e atij virgjilian deri sa mbërrimë në interpretimet artistike më moderne në poezitë e Rilkes e të Cvetaevës.

Miti i Orfeut ka origjina greke, që i paraprijnë versionit latin dhe humbin në lakadredhat e errëta të mitologjisë. Në fakt Orfeu shenjonte poetin e shkëlqyer, birin e muzës Kaliopi e të Apollit, ishte konsideruar si shpikësi i qestes (lloj lire) dhe paraardhës i Homerit dhe i Hesiodit. Shfaqet edhe te legjenda e Argonautëve ku, falë këngës së tij, mbërrin të zbutë sirenat e frikshme, duke lejuar pesëdhjetë heronjtë të vazhdojnë udhëtimin e tyre. Orfeu, në Greqinë e lashtë, bëhet një figurë e njohur, aq sa rreth tij zhvillohet një fe e vërtetë: orfeizmi, një lloj kulti i mistershëm në të cilin mbështetjet çlirimi i shpirtit nga trupi përmes procesit të metempsikozës (apo të rimishërimit të shpirttrave).

Orfeizmi ishte i lidhur me konceptin e pavdekësisë dhe të krenimit të Mbretërisë së Nëntokës, pikërisht sepse miti i Orfeut ishte një nga të parat rrëfime antike që trajtonte konceptin e botës së përtejme përmes udhëtimit të përtejvarrit: një nga episodet më tërheqëse të mitit ishte *katabaza*, ose zbritja e shpirtit të Orfeut në përtejvarr për të shpëtuar të shoqen Euridikën. Gjithsesi, historia romantike mes Orfeut dhe Euridikës, imazhi i tij që kthehet duke e humbur përgjithmonë, nuk është përmendur kurrë në mitin klasik grek: shfaqet për herë të parë në versionin e Virgjilit në librin IV të “Gjeorgjikave”, kur bariu Aristeu flet për vdekjen në masë të bletëve të tij dhe zbulon se e kishte shkakuar pa dashje vetë ai duke u dashuruar me Euridikën. Në vazhdim historia rikthehet e treguar nga Ovidi në librin X të “Metamorfozave” ku tregohet një version i ngjashëm, por edhe i ndryshëm i mitit: në versionin ovidian eliminohet krejt personazhi i Aristeut dhe shkaku i vdekjes së Euridikës, është në fakt një fatalitet tragjik.

Shohim më në detaje historinë analoge dhe diferencat mes versionit virgjilian e atij ovidian.

### Miti i Orfeut dhe Euridikës te Virgjili

“*Orpheu, quis tantus furor?*”. Në librin IV të “Gjeorgjikave” flitet për një çmenduri që kaplon “të dashurin e pakujdesshëm”. Miti i Orfeut gjen shprehjen maksimale dhe pikën më të ngritur të pathosit në çastin kur Orfeu kthehet dhe humb Euridikën përgjithmonë.

Dhe Euridika, teksa kthehej, shkonte duke e ndjekur nga mbrapa- në fakt Prosperina ia kishte vënë atë kusht- kur një çmenduri e papritur e kapi të dashurin e pakujdesshëm- një çmenduri për t’u falur natyrisht, nëse duart do të dinin të falnin.

Veprimi i Orfeut përkufizohet nga Virgjili “çmenduri”, madje, i pafalshëm. Virgjili na tregon se këngëtarin theu marrëveshjen me sovranët e nëntokës, Plutonin e Prosperinën, sipas së cilës nuk duhej ta kthente kokën pas për të parë nëse po e ndiqte Euridika. Tamam në çastin e fundit, Orfeu kthehet, duke thyer kështu paktin dhe duke bërë Euridikën të zhdukej mes hijeve. Shkelja e Orfeut ndjek skemën klasike të përrallave popullore, ose ndalimin e shkeljes, sipas të cilit protagonistit i vjen ndëshkimi.

Drama, që konsumohet në pak çaste, rrëfëhet nga këndvështrimi i vetë Euridikës, që e pyet zemërlëshuar: “*Orpheu, quis tantus furor?*” (Orfe, ç’është gjithë kjo marrëzi?) Nuk ka përgjigje kjo pyetje, mbetet pezull si një enigmë, që vargjet e Virgjilit e lënë ndoshta me qëllim, të pazgjidhur.

Ja sërish fatet e egra më thërrasin dhe një gjumë po varros sytë që lëkunden. Tani lamtumirë: po tërhiqem pasi jam rrethuar nga një natë e thellë.

Ngjarja e Orfeut dhe e Euridikës futet nga Virgjili brenda “Gjeorgjikave” me një mjet letrar: tregim brenda tregimit. Historia në fakt fut brenda ngjarjen e bariut Aristeu, një bletërritës i brengosur nga vdekja e bletëve të tij. Do të jetë plaku Prote që ia zbulon Aristeut shkaku në shfarosjes së bletëve: ka shkakuar zemërimin e një zoti. Zoti në fjalë është Orfeu, që s’ka qetësi nga humbja e Euridikës së tij.

# Miti i Orfeut dhe Euridikës: nga Virgjili tek Ovidi, te Rilke e te Cvetaeva

Nga Zija Vukaj

Sipas versionit virgjilian të mitit, në fakt ka qenë vetë Aristeu që ka shkakuar vdekjen e gruas së re. Ndërsa bariu i dashuruar pas saj e ndiqte nëpër pyje, Euridika rrëzohet dhe kafshohet nga një gjarpër, që me helmin e tij, ajo, pohon Virgjili, “që e dënuar të vdiste”.

Të ndjek zemërimi i një zoti; e jo i paaftë, do paguash një gabim të rëndë që ke kryer: Orfeu, i palumtur pa faj, do të t’i shkaktojë këto dënime

Në versionin virgjilian përveç kësaj personazhi i Orfeut e i Aristeut shfaqen mendues dhe njëkohësisht të kundërt duke u mpleksur në një lojë të ndërlikuar ngjashmërisht: Orfeu dështon, sepse shkel ndalimin e vendosur nga zotat; ndërsa Aristeu shpërblehet mbasi ndjek udhëzimet e shortarit Prote, sakrifikon një bual për zotat dhe kështu arrin atë çfarë ka humbur.

Fati i Orfeut është tragjik në tregimin e Virgjilit, teksa është i dënuar të endet pa ngushëllim në trishtimin e tij e në fund vritet nga Bakantet që, të dalldisura, e copëtojnë dhe e përpijnë.

*“Asnjë dashuri, asnjë martesë e re nuk e përkuli zemrën e Orfeut: shkonte vetëm, akujve të veriut... duke rënkuar për Euridikën -”*

### Miti i Orfeut dhe Euridikës te Ovidi

Ka një ndryshim themelor mes rrëfimit virgjilian dhe atij ovidian: te Ovidi Euridika është memece, bën hije dhe jo prani. Gjithë ajo që Ovidi thotë për të është se “nuk pati fjalë qortimi për të shoqin” dhe atëherë shprehu “lamtumirën e fundit” të saj që mezi “mbërriti në veshët e tij”.

Edhe në rrëfimin ovidian të mitit Orfeu kthehet, duke shkelur ndalimin; por në ndryshim nga sa ndodh te Virgjili, këtu gjesti i Orfeut shpjegohet. Me të gjitha arsyet e botës, Orfeu kthen kokën pas nga dashuria e tepërt, sepse ka frikë se e humb e, njëkohësisht, digjet nga dëshira ta shohë.

Nuk ishin larg nga sipërfaqja e tokës; dhe këtu Orfeu, nga dashuria, teksa trembej se nuk do të vinte dhe lakmia ta shihte, ktheu sytë pas; dhe ajo menjëherë rrëshqiti prapa e duke shtrirë krahët për t’u kapur, kapi vetëm ajrin e butë.

Edhe në variantin ovidian drama konsumohet në pak çaste dhe është e pandreqshme: por këtu ka një shpjegim dhe në fund një kthesë të ndryshme e të papritur. Një herë, i kthyer në Trakë, Orfeu “përzë çdo dashuri gruajë” sepse e tija ka përfunduar keq dhe vendos të ngushëllohet me “dashuri meshkujsh”. Në trajtimin ovidian historia e Orfeut ka një kthesë homoerotike, ndërsa në variantin e Virgjilit- si nga tradita- Orfeu endet i pangushëlluar dhe refuzon çdo dashuri gruajë; për këtë shkak vritet e copëtohet nga Bakantet e zemëruara.

Miti i Orfeut dhe Euridikës rrëfyer nga Rilke: “*Ajo aq e dashur*”

Një variant të shkëlqyer modern të mitit na ka dhënë Rainer Maria Rilke me poezinë e tij kushtuar Orfeut dhe Euridikës me titull “**Orfe, Euridikë, Hermes**” (1904): risia e punuar nga Rilke qëndron në futjen mes dy të martuarve të një figure tjetër, të Hermesit, “zotit të udhëtarëve e të lajmeve”. Në variantin e poetit gjerman me origjinë boheme, Hermes ecën qetësisht në krah të Orfeut, bashkë me

Euridikën. E veçantë paraqitja që Rilke bën për Euridikën: nuk e ravijëzoi në fakt si prani më vete, por si objekt dashurie.

Ajo që bën për Euridikën është fakti se poeti e përshkruan me një epitete të veçantë “*Aq e Dashur*” “*Ajo kaq e dashura*”. Rilke vendos të na e paraqesë Euridikën pa ia përmendur emrin, duke përdorur fjalët e këngës që Orfeu kishte shkruar për të e me të cilën shpresonte ta risillte në jetë:

*Ajo- kaq e dashur- që një lirë e vetme qau më shumë se një mijë gra në zi; dhe gjithë bota që në vaj, pyje e lugina, rrugë e fshatra, fusha, lumenj e kafshë; përreth kësaj bote në vaj si përreth një toke tjetër*

*ktheheshin* në heshtje dielli e qielli plot yje, qiell vaji dhe yje të shformuar- *ajo, kaq e dashur.*

Na është paraqitur si një qenie e pafrymë, tashmë e përfunduar plotësisht në vdekje: qenia e saj e vdekur e mbushte si një plotësi. E humbur në vdekje Euridika- që nuk përmendet kurrë nga Rilke me emrin e saj të vërtetë- nuk ishte më ajo, nuk ishte më flokëverdha e kënduar nga Orfeu, prania erëmirë që ai kishte marrë në “shtratin e gjerë”. Euridika e vërtetë shfaqet vetëm në finale, kur formulon një pyetje zemërlëshuar, pra bën të dëgjohet zëri i saj kur thotë “*Kush?*”. Pyetja e Euridikës kristalizohet dhimbjen duke bërë prej saj protagonistin. Nëse varianti virgjilian vendoste në qendër Orfeun që kthehej duke bërë një “*topos*”, ja që Rilke i jep Euridikës- *ajo kaq e dashur*- fjalën e fundit që është një frymë e jehonës së pavdekshme. Në atë “*Kush?*” të shqiptuar nga Euridika ngrihet gjithë misteri zemërlëshuar i vdekjes: masa e humbjes së pandreqshme, dhimbja e panatyrshme.

*“E kur zoti ashpërsisht e ndaloi, me zërin e dhimbjes thirr:*

*Po është kthyer- ajo nuk kuptoi dhe me një frymë pyeti: Kush?”*

### Miti i Orfeut dhe Euridikës në artin e pikturës, muzikës, letërsisë.

Tema e Orfeut që kthehet, inauguruar te “Gjeorgjikat” virgjiliane, do të kishte një ndjekje të madhe dhe do të rimerrej nga artet piktorike, letrare e muzikore. Orfeu dhe Euridika kthehen në operën e Gluck e të Monteverdit, në skulpturën e Kanovës e të Rodin, në pikturat e Ticianit, Shagallit, Bruegelit e Corot. Ndoshta artistët nuk i ka rrimbyer vetëm ngjarja tragjike në vetvete, por numri i madh i tematikave që ajo përmban: dashuri dhe vdekje, triumf e dështim, kërkim i bukurisë dhe i absolutes. Rijeton përjetësisht përralla e trishtuar e Orfeut që, edhe duke e arritur të dashurën e tij, vendos të kapërcejë kufijtë e përtejvarrit për ta sjellë pas, por tradhtohet nga dashuria e tij e tepërt dhe kthehet duke e bërë atë një hije. Do të jetë pikërisht gjesti i Orfeut- që tradhton pritshmëritë dhe pengon fundin e lumtur që pritet- për të tërhequr vëmendjen e letrarëve, artistëve, poetëve: mbasi është drama pa justifikim, pyetja që rri pezull, njya e pazgjidhur kurrë. Pse Orfeu kthehet? Nuk ka përgjigje të vërteta për këtë pyetje, vetëm hipoteza të shumta: ka që mendojnë se Orfeu është kthyer sepse nuk dëgjonte hapat e Euridikës pas vetes dhe ka që besojnë se e ka



bërë thjesht se nuk mund të bënte më pak. Në “Dialogje me Leukon”, tregim kushtuar mitit me titull “I pangushëllueshmi”, Çezare Paveze hedh hipotezën se Orfeu është kthyer sepse në fund e mendon kthimin e Euridikës të pamundur, ashtu siç është e pamundur për një njeri të kthejë rininë.

Euridikën e qaj, ishte një stinë e jetës. Unë kërkoja tjetër gjë përtej dashurisë së saj. Kërkoja një të kaluar që Euridika nuk e di.

Paveze kërkon një kuptim të gjestit të Orfeut- që kaq shumë i ka mundur lexuesit e mitit- e më në fund e justifikon kështu, përmes dialogut me Bakën:

*Orfeu: Ç’hyn fati. Fati im nuk tradhton. Qesharake që pas atij udhëtimi pasi e kam parë në fytyrë asgjënë, unë kthehem gabimisht apo për tekë.*

*Baka: Këtu thuhet se që nga dashuria.*

*Orfeu: Nuk dashurohet kush ka vdekur.*

Në tekstin e kushtuar nga kantautori Roberto Vekioni me titull “Euridika”, gruaja e dashur e Orfeut lihet në përtejbotë, sepse tashmë ka vdekur dhe aty është vendi i saj: vdekja është e pandreqshme, *Euridika është bërë hije.*

*E do të kthehem sepse ti do vyshkesh*

*Do të kthehem sepse ti do të zhdukesh*

*Do të kthehem sepse tashmë nuk je.*

*Dhe do të flesh përgjithmonë.*

Në variantin më bashkëkohor të historisë- nga Cvetaeva te Yorcenari, nga Kalvino te Rushdie- fokusi zhvendoset mbi këndvështrimin e Euridikës, bëhet ajo protagonistja e vërtetë në një perspektivë të përmbysur, të regjistrit feminist: ajo që nuk ka fjalë thirret për të treguar historinë e vet dhe- përkundër versionit ovidian e qorton të shoqin që nuk e kishte shpëtuar. Në këtë perspektivë të përmbysur Orfeu nuk paraqitet si një i dashuruar tragjik, por si një burrë që kërkon të kapërcejë kufijtë mes hyjnës e njerëzores, duke mashtruar nusen e vet të vdekur me premtime false të ringjalljes. Në poezinë “Euridika Orfeu” (1923) të Marina Cvetaevës, e merr fjalën vetë gruaja që nuk do të jetë e shpëtuar, sepse e di që nuk është më grua dhe i lutet të dashurit të saj: “*Harromë dhe më braktis!*”

*Meqë në këtë shtëpi të rreme ti i gjallë je fantazmë, dhe e vërteta unë, e vdekur... Çfarë mund të të them- përveç: “Harromë dhe braktismë!”*

*S’do të arrish t’më turbullosh! Nuk do ta mbaj!*

*Nuk kam as duar! As buzë të vendos! Nga kafshimi i nëpërkës së pavdekësisë pasioni i gruas merr fund.*

Cvetaeva vë theksin mbi një çështje jo shumë të ndryshme nga ajo që ka pranuar Rilke: poeti gjerman përmes ndarjes së parë të Euridikës, duke përsëritur se ajo që e bën të pranishme është dashuria që i ka kushtuar në jetë, “*Ajo kaq e dashur*”; tani poetja ruse- që me Rilken pati një korrespondencë të apasionuar- shkon më thellë, duke kapërdirë vizionin e mentorit të saj të dashur. Ndërsa Rilke vëren se tashmë Euridika është hije, por ndërmend se ka qenë e gjallë vetëm kur Hermesi vëren: “Është kthyer”, duke iu referuar Orfeut, përkundrazi Cvetaeva na tregon Euridikën e vdekur që e ka pranuar krejtësisht gjendjen e saj. Në këtë vizion të ri të gjërave, akti i kryer nga Orfeu nuk është një tentativë shpëtimi, por një ndërhyrje, një dhunë, sepse mbretëria e të gjallëve dhe ajo e të vdekurve janë të ndara dhe nuk mund të komunikojnë më në asnjë mënyrë. Thirrja e Euridikës drejtuar Orfeut është pra që ai të vazhdojë të jetojë dhe të mos merret me hijet. “*Harromë dhe braktismë!*”

Një ndër enigmat më të shquara të literaturës angleze është dhe do të mbetet ajo e djalit misterioz të soneteve të Shekspirit. Ende sot, mbi katërqind vite pas shkrimit të tyre, dedikimi i vitit 1609 nga botuesi i soneteve Thomas Thorpe:

*“TO. THE. ONLIE. BEGETTER. OF  
THESE. INSUING. SONNETS.  
MR. W.H. ALL.HAPPINESSE....*

(Përkthimi i përafërt: “Për të vetmin burim krijues të këtyre sonetëve, zoti W.H, gjithë lumturia...”)

mbetet i pazbërthyer. Kush mund të ketë qenë zoti W.H, ky djalë misterioz i cili magjepsi Shekspirin? Me këtë çështje janë marrë qindra akademikë dhe studiues, një ndër ta edhe shkrimtari i famshëm Oscar Wilde. Brenda veprës së tij “Portreti i zotit W.H”, zotëria besohet të ketë qenë William “Willie” Hughes, një aktor i ri i kompanisë së Shekspirit. Emri i së cilit qëndronte i fshehur pas disa lojërave fjalësh brenda sonetëve. Si në sonetin 20, ku Shekspiri shpreh:

“A man in hew, all Hews in his controwling”

Këtu, fjalët “hue” dhe “Hews” (sipas Wilde) nuk janë përdorur në mënyrë rastësore. I gjithë vargu mendohet (sipas Wilde) të ketë qenë një aludim për mbiemrin “Hughes” të aktorit (për ta kuptuar vëreni ngjashmëritë në shqiptimin e fjalëve “hue”, “hews” dhe “Hughes”) . Lojëra të ngjashme gjithashtu vërehen në sonetin 38 (“*the tenth Muse, ten times more in worth*”) ose në sonetet 135 dhe 142 të cilat bëjnë një lojë të ngjashme me “Will” (“Whoever hath her wish, thou hast thy Will”) . Kjo “lojë” bëhet aq e domosdoshme në zbërthimin e kuptimit të sonetëve, sa shkollari Cyril Graham brenda veprës deklaroi se vargjet e Shekspirit marrin kuptimin e tyre të plotë vetëm nëse emri i të dedikuarit merret si Willie Hughes. Për shembull në vargjet e sonetit 38:

*“How can my Muse want subject to invent,  
/ While thou dost breathe, that pour’st into my verse”*

ai jo vetëm është duke e lavduar të dashurin e tij si muza e dhjetë, por edhe është duke luajtur me mbiemrin e tij (përdorime të ngjashme të fjalës “Muse” gjenden edhe në sonete të tjera).

Një çështje thelbësore në diskutimin rreth figurës së Willie Hughes është ajo e mënyrës se si ai mund të ketë hyrë në orbitën e Shekspirit dhe çfarë roli mund të ketë luajtur në krijimtarinë e poetit. Për ta kuptuar këtë, është e domosdoshme të kemi parasysh kontekstin e teatrit elizabetian. Në kohën e Shekspirit, ligjet dhe zakonet e teatrit ndalonin ngjitjen e grave në skenë, për këto arsye rolet femërore interpretoheshin kryesisht nga djem të rinj (në rastin e veprave të Shekspirit prej aktorëve si Willie Hughes). Këta aktorë, të quajtur “*boy actors*”, mishëronin brenda tyre një dyzim tërheqës: femëroren në skenë dhe mashkulloren jashtë saj. Kjo shprehet më së miri në vargjet e sonetit 20:

*“...steals all men’s eyes and women’s souls amazeth”* (Përkthyer: Vjedh sytë e të gjithë burrave dhe shpirtrat e grave mahnit).

Një paradoks i tillë aktorësh e vendose në rrezik teatrin si institucion. Në njërën anë, ai ishte i kontrolluar rreptësisht nga autoritetet e larta (nëpërmjet censurës). Ndërsa në anën tjetër, brenda kufijve të skenës lejoheshin lojëra identiteti të cilat në jetën e përditshme do të kishin qenë të papranueshme. Një djalë i cili vishej si vajzë tashmë mund të admirohej publikisht për bukurinë e tij. I tillë u bë personazhi i Violës

# Djali i fshehur pas soneteve të Shekspirit dhe Oscar Wilde mes tyre

## Nga Orin Maxhari

nga “Nata e dymbëdhjetë”. Ajo maskohet si një burrë (Cesario) për të mbijetuar në tokë të huaj, ndërsa Hughes për aq kohë sa luante rolin e saj brenda trupës së Shekspirit, maskohej qëllimisht për t’u dashuruar hapur prej tij.

Një dramë në atë kohë gjithashtu mund të trajtonte dashuri të ndaluara duke i veshur ato me “kostumin e fantazisë”, si në rastin e veprës “Romeo dhe Zhulietta”. Ajo nuk është thjesht historia e dy të rinjëve nga Verona, por një vepër e cila brenda saj përmbledh tensionin e dashurisë së ndaluar të vetë Shekspirit. Pengesa për të dy çiftet është po e njëjta, ajo e urrejtjes. Prej saj buroi jo vetëm dënimi me vdekje për homoseksualët nga koha e Shekspirit, por edhe rivaliteti mes familjeve Montag dhe Kapulet. Kështu, të dy çiftet u gjendën në një situatë ku dashuria e tyre ishte e sinqertë dhe pasionante, por e pamundur për t’u jetuar hapur.


Në Sonetin 36, poeti shkruan:

*“I may not evermore acknowledge thee,  
Lest my bewailed guilt should do thee shame.”*  
(Përkthyer: Nuk mund të të njoh më kurrë, që faji im i vajtuar të mos të turpërojë.)

Këtu, poeti pranon se largimi dhe fshehja nuk burojnë nga mungesa e dashurisë, por nga rreziku që një pranim i ndjenjave do të sillte për të dashurin e tij. Ky varg është i njëjtë në frymë me dëshpërimin e Romeos në aktin e tretë, kur thotë:

*“Në qofsha internuar nga Verona,  
Jam internuar nga e gjithë bota,  
Dhe një internim i tillë është vdekje.”*

Për Romeon, ashtu si për Shekspirin, bota bëhet e padurueshme sapo dashuria ndalohet e shtrydhet nga jashtë. Në këtë dritë, edhe Zhulietta merr një dimension krejt tjetër. Ajo nuk është më thjesht vajza e brishtë e cila guxon të sfidojë prindërit, por bëhet njëkohësisht heroína e dashurisë,



dhe maska e ligjshme përmes së cilës Willie Hughes mund të derdhte ndjenjën e tij mbi skenë. Në çdo fjalë të saj, në çdo betim të dridhshëm, tingëllon zëri i aktorit i cili, fshehur nën vellon e personazhit, arrin të dashurojë hapur për herë të parë. Nga këtu buron edhe guximi i Zhulietës për ta ndjekur Romeon deri në fundin fatal. Dramaturgu që shkruan dhe aktori që shpreh, duke ditur se luajnë brenda një skene të përkohshme, vendosin të ngrenë një monument të përjetshëm, ku dashuria e tyre të mos shuhet kurrë.

(Kujtoni vargjet e sonetit 18: “*...S’do krenohet vdekja se ti rend mes hijesh, Kur në vargun tim përjetësia të pret...*”)

\*\*\*

Nëse ne do ta merrnim këtë teori të aktorit të ri si të mirëqenë, ende do të na mungonte shpjegimi për thujtë gjysmën e sonetave. Nëse Willie Hughes ka qenë “Fair Youth” i sonetave 1-126 dhe 153-154, kush ishte gruaja e errët “Dark Lady” e soneteve 127-152? Çfarë roli mund të ketë pasur ajo mes tyre? Në “Portreti i zotit W.H” rreth rolit të mundshëm të saj na thuhet:

*“...Mars 1601, Manningham shpreh se kishte dëgjuar nga një anëtar i kompanisë së Shekspirit që gruaja e një qytetari të caktuar, gjatë kohës që kishte qenë tek teatri “Globus” kishte rënë në dashuri me njërin prej aktorëve, aq shumë sa “i kishte kërkuar të vinte mbi të”...Shekspiri, duke e dëgjuar... “shkoi i pari dhe u kënaq”... Mua këtu më dukej se kishim përpara një version të thjeshtë por edhe të shtrembëruar të asaj që ndodh brenda sonetëve, historia e dashurisë së gruas së errët për Willie Hughes, dhe tentativa e marrë e Shekspirit për ta bërë gruan të bjerë në dashuri me të në vend të shokut të tij...”*

Nga këtu kuptojmë më mirë arsyet për shkrimin e sonetëve dedikuar



zonjës së errët, të cilat për njëfarë kohe shpërqëndruan nga dashuria e tij e vërtetë. Ajo kërkonte të vidhte dashurinë nga duart e tij, dhe e vetmja gjë që poeti mund të bënte ishte të “shtirej” si i dashuruar ndaj saj për ta larguar atë nga Willie Hughes. Kjo mungesë e ndjenjave të sinqerta përzierë me xhelozinë dhe inatin prodhuan një gjuhë më “të egër” dhe “me tipare shtazore”. Më qartë se kudo tjetër kjo shihet në vargjet e sonetit 130:

“My mistress’ eyes are nothing like the sun;  
Coral is far more red than her lips’ red;  
If snow be white, why then her breasts are dun;  
If hairs be wires, black wires grow on her head...”

(Përkthyer: Sytë e mikes time nuk janë aspak si dielli;  
Korali është më i kuq se i kuqi i buzëve të saj;  
Nëse dëbora është e bardhë, gjithë e saj janë gri e turbullt;  
Nëse flokët janë tela, tela të zinj rriten në kokën e saj...)”

\*\*\*

Megjithatë, emri i plotë William Hughes nuk shfaqet askund. Asnjë dokument arkivor, asnjë dëshmi konkrete nuk e përmend (me emër) një William Hughes që të ketë qenë pjesë e trupës së Shekspirit. Cyril Graham, e kishte kuptuar tashmë se pa prova të prekshme teoria e tij do të shembej. Kështu ai shkon drejt mashtrimit. Dhe, pasi kjo tetnativë e dëshpëruar dështon, dhe portreti i tij zbulohet si i rremë, ai kryen vetëvrasje. Wilde për të shkruajti se: “*Ai kishte vënë gjithë shpirtin e tij në rrezik për vërtetësinë e teorisë, dhe kur teoria u shemb, shpirti i tij u duk sikur u thye po ashtu.*”

Por përse vallë një shkrimtar si Oscar Wilde do të zgjidhte ti dedikohej një teorie kaq të pasigurtë? Përse do t’i linte personazhet e tij të shkonin drejt vetëvrasjes, vetëm sepse nuk mund ta mbanin gjallë besimin e tyre? E gjitha lidhet me faktin se edhe vetë ai nuk mund të mbijetonte pa këtë besim. Nëse Shekspiri nuk do të kishte dashur një burrë, atëherë Wilde do të mbetej i vetëm në dhimbjen dhe dëshirën e tij. Teoria e Willie Hughes nuk ishte thjesht një spekulim filologjik. Ai do të bëhej vetëmbrojtja e Oscar Wilde përballë shoqërisë viktoriane. Në këtë kuptim, “Portreti i zotit W.H” nuk është një ese për sonetet e Shekspirit. Në të, ai nuk kërkon të provojë një të vërtetë historike. Synimi i tij ishte shpikja e një të vërtete estetike dhe morale e cila mund t’i jepte kuptim qenies së tij. Ai priste prej Shekspirit atë që nuk do ta merrte kurrë nga shoqëria e tij. Një vizitë prej poetit të madh në burgun e Reading ku ai mund t’i shprehte se nuk ishte i vetëm në ndjenjat e tij.

Amor vincit omnia. G.

**“Edukatë ruse”**

“Kur Elena Sergejevna hynte në Ksallon, zonjat tronditeshin dhe nxitonin për të shpërqendruar vëmendjen e burrave të tyre”, - këto fjalë të njërit prej të njohurve të Elenës i sjell në shkrimin e saj shkrimtarja Serafima Çebotar.

Gruaja e tretë e Mihail Bulgakovit ishte me të vërtetë një grua e shkëlqyer. Qysh në rini, Elena Nurenberg (ky ishte mbiemri i saj i vajzërisë) konsiderohej si një nga bukuritë e pranuar të Moskës. Inteligjenca, pamja e ndritshme, talentet e shumanshme; të njohurit nuk dyshonin se këtë grua e priste një fat i jashtëzakonshëm.

Babai i vajzës ishte Sergej Njurenberg, një hebre i pagëzuar, i cili për një kohë punoi si mësues, pastaj u mor me gazetari dhe botonte shkrime në gazeta. Nuk përjashtohet që pikërisht prej tij vajza të ketë trashëguar interesin për letërsinë. Atmosfera ruse, në të cilën u rrit Elena, ndikoi si në edukatën e saj, ashtu edhe në pikëpamjet e saj për jetën. Vetën gjithmonë e konsideronte si një ruse të lindur.

Një episod interesant ndodhi kur Elena mbushi nëntëmbëdhjetë vjeç. Atëherë, në vitin 1912, te vajza kërkoi dorën togeri Bokshanski. I riu ishte i pashëm dhe i këndshëm në shoqëri, megjithatë Elena filloi ta bindte që të martohej me motrën e saj të madhe, Olgën. Pa dyshim, vajza kishte dhuntinë e bindjes, sepse së shpejti u bë dasma dhe Olga Sergejevna u bë zonjë e martuar.

Siç kujtonte pas shumë vitesh nipi i Elenës, ajo ishte një adhuruese e zjarrtë e teatrit. Në rini, së bashku me motrën, vajza madje u përpoq të punësohej në teatër, por pranuan vetëm Olgën, ndërsa Elena për një kohë kreu detyrën e sekretares tek i ati.

Pavarësisht numrit të madh të adhuruesve dhe pretendentëve për martesë, Elena Sergejevna hyri në martesën e saj të parë vetëm në vitin 1918. I zgjedhuri i saj ishte Jurij Nejolov, djali i një aktori të njohur. Bashkëshorti i Elenës shërbente në Ushtrinë e Kuqe, ku mbante postin e ndihmësit të komandantit të ushtrisë. Bashkimi me Nejolovin doli jetëshkurtër dhe nuk solli lumturi për asnjërin prej bashkëshortëve.

Vendimtare u bë njohja e Nejolovëve me oficerin e Ushtrisë së Kuqe, Jevgenij Shilovski. Bashkëkohësit e përshkruanin atë si një burrë të pashëm, me pamje fisnike dhe me karakter të butë. E magjepsur nga Shilovski, Elena Sergejevna e kuptoi se nuk mund të jetonte më me Nejolovin. Që në vitin 1920 martesë u shpërbë, dhe së shpejti gruaja u martua me Jevgenij Aleksandroviçin.

Duke u bërë bashkëshortja e një komandanti të nderuar të Ushtrisë së Kuqe, Elena dukej se kishte tërhequr një “biletë fatlume”. Në shtëpinë e saj kishte shërbëtorë, dy djemtë e lindur nga kjo martesë kishin një dado gjermane që merrej me edukimin e tyre. Elena Sergejevna mund t’ia lejonte vetes ato gjëra, për të cilat shumë gra në atë kohë vetëm mund të ëndërronin.

Ajo kishte flokë të mrekullueshme, bizhuteri, përdorte parfume franceze dhe mund të shfaqej në shoqëri me veshje nga më të rafinuarat. Si te Margarita e Bulgakovit, ajo i kishte të gjitha, përveç lumturisë.

Në një letër drejtuar motrës së saj, ajo

# Gruaja e tretë Bulgakovit

## Fati i Elenës, asaj që ishte “Margarita”

*Përktheu Bujar Hudhri*

Një fjalë e urtë ruse thotë se gruaja e parë i jepet burrit nga Zoti, e dyta, nga njerëzit, ndërsa e treta, nga djalli. Por Mihail Afanasieviç Bulgakov me siguri do të kishte kundërshtuar këtë. Elena Shilovskaja, e cila u bë gruaja e tij e tretë, dukej sikur ishte dërguar nga vetë Zoti. Pikërisht ajo u bë prototipi i Margaritës së Bulgakovit në romanin e famshëm; falë saj u ruajt arkivi i paçmuar i shkrimtarit.

Pra, çfarë gruaje ishte ajo? Si u njoh me shkrimtarin? Dhe si e mbajti premtimin më të madh që i dha bashkëshortit në grahamat e fundit.

pranonte se shpesh në mbrëmje zhytet në mendime, ndjen një masë forcash e energjie të pashfrytëzuara. Pa parë as kuptim, as ndonjë qëllim, ajo endej e vetmuar nëpër rrugë, duke menduar për jetën e saj dhe pa gjetur përgjigje për pyetjet që e shqetësonin.

### Takimi me Bulgakovin

Gruaja sikur ndiente se ishte krijuar për diçka më të madhe sesa thashethemet mondane mes “zonjave të vogla” apo mërzia e vetmisë. Pikërisht atëherë, kur ajo nuk e dinte ç’të bënte dhe nga t’ia mbante më tej në jetë, u shfaq Bulgakovi.

Rreth njohjes së tyre ekzistojnë disa versione. Sipas më të përhapurit, ata u takuan për herë të parë tek të njohurit gjatë festës së Maslenicës. Siç kujtonte Elena Sergejevna,



**Elena Sergejevna Shilovskaja me bashkëshortin e saj Jevgenij Aleksandroviçin**



**Elena Shilovskaja në vitin 1928**

ajo rrinte në tryezë pranë Bulgakovit, dhe papritur iu zgjidhën lidhëset e mëngës.

Ajo i kërkoi fqinjit të saj t’ia lidhte, dhe Mihail Afanasjeviçi më pas shpesh e përmendte këtë episod, duke bërë shaka se Shilovskaja e kishte “lidhur me magji”. Ky takim ia përmbysi gjithë jetën Elena Sergejevnas:

“Ishte një dashuri e shpejtë, jashtëzakonisht e shpejtë, të paktën nga ana ime, dashuri për gjithë jetën”.

Romanca mes tyre nisi vrullshëm dhe madje disi papritur për të dy. Elena Sergejevna dhe Mihail Afanasjeviç kishin familjet e tyre; as ai, as ajo nuk kishin ndërmend të largoheshin nga bashkëshortët.

Por nëse në jetën e Shilovskajës gjithçka shkonte për mbarë, tek Bulgakovi kjo periudhë ishte errësuar nga ndalimet për botimin e dramave të tij. Nuk e botonin, ia refuzonin punën. Ai ishte praktikisht i varfër, dhe lidhja me një zonjë luksoze në rastin e tij dukej si një çmenduri që nuk mund të kishte vazhdim.

### Kur zemra është më e fortë se arsyeja

Dy vjet më vonë, për romancën e gruas së tij me shkrimtarin mësoi Jevgenij Shilovski. Pas një bisede serioze me Bulgakovin, ai kërkoi që ky ta linte të qetë Elena Sergejevnan. Së shpejti, në ditarin e Mihail Afanasjeviçit u shfaq një shënim i dhimbshëm:

“Fatkeqësia ndodhi më 25.II.1931”.

Pikërisht atë ditë të kobshme ai dhe Elena i premtuan njëri-tjetrit të mos shiheshin më kurrë. Të dashuruarit u ndanë, të bindur se ky ishte takimi i tyre i fundit.

Shilovskaja përpigjej të mos dilte vetëm nga shtëpia, nuk kërkonte takime me Mihailin, dhe me përlësi luante rolin e zakonshëm të bashkëshortes së dashur dhe të nënës. Me Bulgakovin ajo nuk u pa gati dy vjet, por një takim i papritur në restorantin “Metropol” ndryshoi gjithçka.

Duke marrë me ngut fëmijët dhe duke u larguar në Lebedjan, Elena Sergejevna i shkroi një letër burrit duke i kërkuar divorc. Mihail Afanasjeviçi gjithashtu i dërgoi Shilovskit një mesazh me një thirrje të zjarrtë: “Kaloni pranë lumturisë sonë”.

Këtu duhet t’i japim të drejtë Jevgenij Aleksandroviçit. Ai me të vërtetë nuk iu vu peng ndjenjave të bashkëshortes së tij. Për më tepër, ai u dërgoi prindërve të saj një letër, në të cilën shkruante se për asgjë nuk e fajësonte Elena Sergejevnën, dhe se martesë me të i kishte dhuruar shumë vite të lumtura.

Megjithatë, divorci rezultoi i dhimbshëm për Elenën. Ish-bashkëshortët “ndanë” edhe fëmijët: Jevgenij mbeti me të atin, ndërsa Sergej së bashku me të ëmën u shpërngulën në shtëpinë e Bulgakovit. Në tetor të vitit 1932 Mihail Afanasjeviçi u divorcua nga gruaja e tij e dytë, dhe një muaj më vonë u martua me Shilovskajën.

### Shoqja besnike

Jeta e re e Elena Sergejevnas ndryshonte në mënyrë rrënjësore nga ajo e mëparshmja. Tani asaj i duhej të harronte sobolat dhe parfumet e shtrenjta, veshjet luksoze dhe mbrëmjet mondane.

Por vështirë se gjëra të tilla të vogla e shqetësonin gruan. Ajo ishte pranë njeriut që dashuronte, e shndërruar në ndihmësen e tij, muzën e tij, mbështetjen e tij të sigurt. Elena redaktonte dorëshkrimet e Bulgakovit, i shtypte në makinë shkrimi, i jepte këshilla Mihail Afanasjeviçit, komunikonte me botuesit dhe teatrot.

Pas një viti martese, Elena Bulgakova, me këmbënguljen e burrit të saj, filloi të mbante ditar, i cili në të ardhmen u bë një burim me vlerë të paçmuar për biografët.

Kur në vitin 1934 Mihail Afanasjeviçi më në fund mori një apartament, mysafirë të çiftit u bënë personalitete të njohura të artit të kohës. Tek Bulgakovët shpesh vinin Kaçallovi, Ranevskaja, Ahmatova. Në shtëpinë e tyre gjithmonë mbretëronte gëzim, liri dhe ngrohtësi. Nuk ishte e rrallë që mysafirët të shpërndareshin vetëm në agim.

### Vdekja e shkrimtarit

Dashamirës i shakave, Mihail Afanasjeviçi shpesh u thoshte të pranishmëve: “Ju do të jetoni, por unë do të vdes së shpejti”. Por askush nuk i merrte seriozisht këto fjalë, pasi shkrimtari dukej i shëndetshëm dhe plot energji.

Megjithatë, Bulgakovi nuk ishte vetëm letrar, por edhe mjek i mirë. Në vitin 1939 ai u sëmur nga nefroskleroza. Ai e dinte se pas simptomave fillestare do të pasonin humbja e shikimit, e të folurit dhe vdekja e shpejtë. Mjekët thoshin se ai do të jetonte vetëm disa ditë, por Bulgakovi duroi gjashtë muaj. Shuarja e tij ishte e gjatë dhe e mundimshme.

Gjatë gjithë kësaj kohe pranë tij ishte Elena Sergejevna. Pak para vdekjes, pothuajse i privuar nga aftësia për të folur, Mihail Afanasjeviçi nisi t’i tregonte me gjeiste gruas së tij, duke i kërkuar të sillte diçka.

Ajo i afroi një gotë ujë, por jo; i vdekuri tregonte drejt dorëshkrimit të *Mjeshtrit dhe Margaritës*. Duke gjetur



Bulgakov Mihail Afanasjeviç dhe Bulgakova Elena Sergejevna, prill 1935 / Muzeu i M.A. Bulgakovit, Moskë

me vështirësi forcën për të shqiptuar disa fjalë, Bulgakovi tha: “Që ta dinë...”. Elena Sergejevna iu betua bashkëshortit se veprat e tij patjetër do të botoheshin. Ajo e mbajti fjalën e dhënë.

### Ruajtësja e dorëshkrimeve

Nëse gjatë jetës së Bulgakovit gruaja e tij ishte ndihmëse dhe sekretare

e shkrimtarit, pas vdekjes së tij Elena u shndërrua në ruajtësen e arkivave të paçmuara të Bulgakovit. Në një nga letrat e saj, drejtuar vëllait, gruaja pranonte:

“Unë bëj gjithçka që është në fuqinë time, në mënyrë që të mos humbasë asnjë rresht i shkruar prej tij, që të mos mbetet i panjohur personaliteti i tij i jashtëzakonshëm... Ky është qëllimi, kuptimi i jetës sime”.


Në vitet e fundit të jetës Elena Bulgakova jetoi në varfëri. Ajo bënte përkthime, zhvillonte bisedime me botuesit dhe jepte gjithë forcat e saj që veprat e Mihail Afanasjeviçit të mos mbeteshin të harruara.

Duke kujtuar jetën e saj të shkurtër bashkëshortore me Bulgakovin (ata jetuan së bashku shtatë vjet), ajo thoshte se në atë kohë nuk kishte grua më të lumtur në gjithë botën. Elena Sergejevna, në kujtim të kësaj dashurie të përjetshme, e pavdekësoi trashëgiminë e Mihail Afanasjeviçit, duke ruajtur dorëshkrimet e tij dhe duke bërë një punë të madhe që ato më në fund të shihnin dritën.

Nipi i Elena Sergejevnas, Sergej Shilovski, kujtonte se ajo kurrë nuk pushoi së besuari në lidhjen e veçantë, madje edhe me Bulgakovin e ndjerë. Ajo “komunikonte” me të çdo mbrëmje, duke i treguar çfarë kishte ndodhur gjatë ditës, për punën dhe mendimet e saj.

Me nismën e vejushës së shkrimtarit, mbi varrin e tij u vendos një golgotë, e cila më parë kishte qëndruar mbi varrin e Gogolit (atë e hoqën për t’i ngritur një monument Nikolaj Vasiljeviçit).

Vetë Elena Sergejevna vdiq në moshën shtatëdhjeteshtatëvjeçare. Ajo u varros pranë burrit të saj, nën të njëjtën golgotë, dhe kjo do të thoshte se i madhërishti “Mjeshtër” dhe “Margarita” e tij ishin sërish bashkë – tani tashmë në qiell.



*Karikaturë nga Arben Mexsi*

